

HYRJE NË SINTAKSEN GJENERATIVE TË SHQIPES

GIUSEPPINA TURANO, kërkuese shkencore në fushën e gjuhës së dhe të letërsisë shqipe në Universitetin Ca' Foscari të Venecias, merret me gjuhësi shqipe dhe dialektologji arbëreshe. Është autore e disa monografive dhe artikujve që trajtojnë strukturat morfosintaksore të shqipes dhe dialekteve arbëreshe; autore e disa studimeve karhasuese lidhur me gjuhët në kontakt, me bilingvizmin dhe plurilingvizmin në hapësirën italo-shqiptare. Verprintaria e saj kërkimore-shkencore, krahës fushës së sintakses së shqipes dhe arbëritshës, shtrihet edhe në fushë të filologjisë; në çështje të ndryshme mbi metodat e përkthimit të letërsisë shqipe në gjuhën italiane e, në mënyrë të vegantë, në lidhjen mes kulturës arbëreshe dhe asaj italiane.

• • •

FLORA KOLECI është anëtare e departamentit të gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës që prej vitit 2002, ku vazhdon të japtë lëndën e Sintaksës shqipe, fushë në të cilën ka përqendruar interesat e saj kërkimore-shkencore. Në vitin 2006 ka mbrojtur disertacionin me temë "Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist" pranë Universitetit të Kalabrisë, në të cilin ka punuar për katër vjet (2007–2010) si lektore e gjuhës shqipe. Krahë studimeve në fushën e sintakses, është marrë edhe me probleme të ndryshme që paraqet mësimi i gjuhëve të huaja në distancë. Gjithashtu ka kryer studimet universitare për drejtësi.


F. KOLECI - G. TURANO

HYRJE NË SINTAKSEN GJENERATIVE TË SHQIPES

FLORA KOLECI · GIUSEPPINA TURANO

HYRJE NË SINTAKSE GJENERATIVE TË SHQIPES

ISBN 978-99927-0-609-1



FLORA KOLECI

GIUSEPPINA TURANO

HYRJE

NË SINTAKSËN GJENERATIVE
TË SHQIPES

SHTËPIA BOTUËSE E LIBRIT UNIVERSITAR
TIRANË, 2011

Këshilli botues i ShBLU-së

Kryetare: Lirika Çoçoli

Anëtarë: Klara Shoshi, Nirvana Lazi, Valbona Gjergo

Spartak Kumbaro, Marjeta Pengo

Redaktore përgjegjëse: Nirvana Lazi

Arti grafik: Nirvana Lazi

Kopertina: Klara Shoshi

Recensues: Prof. dr. Shezai Rrokaj
Prof. dr. Rami Memushaj

© Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2011.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishtimi
me çdo mjet apo formë pa lejen me shkrim të botuesit.

Adresa:
Shtëpia Botuese e Librit Universitar
Rruga e Kavajës, Nr. 116, Tiranë, Shqipëri
T: + 355 4 22225659

ISBN 978-99927-0-609-1

Shtypur në Republikën e Shqipërisë
Shtypshkronja "Dajti 2000", Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë
Tirazhi 1000 kopje

Parathenie

Qellimi i këtij teksti është të parashinjojë dhe të trajtojë disa prej aspektive të sintaksës së shapjes duke përdorur madelin teorik të zhvilluar në kuadrin e gramatikës gjenerative të amerikan Noam Chomsky, diku mës iu rrethe '80 iu shek. XX, e njohur si Teoria e Parimeve dhe Parametraue.

Pershkrimi i të dhënave do të mështetet gjithashitë në avilitjet më të konsoliduarë të Programit Minimalist propozuar nga Chomsky (1993) dhe shijelluar e analizuar më tej nga një gamë e gjerë studimesish mbi të dhëna e qinuë të ndryshme anekend hastes.

Edhe në lëmin e shapjes janë bërë përpjekje të konsiderueshme për ta sielle, rastimë rïshenazi, në vëmendjen e studiuesit këtë punje dhjetëra vjezare të gramatikës gjenerative. Per t'u përmendur është padyshtim punc pionieristikë, mund të themi, e prof. Rami Memushaj (2008) por edhe e një sëri studiuesish të tjerë brenda dhe jashtë vendit.

Rolet tematike dhe ndarja e fjaleve në argumente dhe adjunktië
në variësi të funksionit të tyre në frazë, i paraprinë analizën së
regullare dhe kufizimeve për formimin e përkësues dhe
paraqites së strukturës së detajuar të tyre duke përfshirë këtu
edhe lëvizjet e mundshme në frazë. Kësaj të fundit i është
kushuar vëmendje kryesishët në halleat e formimit dhe të
shtipellimit të fjaleve.

Per analizën e frazave me fjali të nennitura jemi mështetur
në modelin e propozuar nga Rizzi (1995), i cili u jep përgjigje të
kenaqshme strukturare të artikuluarës këndore
komplementues.

Këshiu, fjala me folje në lidhore, por edhe ndërtimet me forma
follore të pasqyellura, kugesisht pasqyore, frazat kushtore dhe
ata relativë analizohen hollësishët në bazë të këtij modeli. Në
fund analizohen edhe frazat me bashkërenditje.

Duke qenë punë e dy autoreve, tek pasqyrat e lëndës pëncaktorët
disiplinat e tjera, si gjendër e ndërligjës mes tyre.

Das hyrjes, teksti zë fill me analizën e regullave sintaksore të
bashkimit të fjaleve për formimin e njësive minimale, të
redukturave tashmë në vetëm dy, sipas Programit Minimalist
(shkruj-merge dhe leuit-movë).

Do ashtu, vëmendje e vegantë i kushtohet valencës së fjaleve,
kugesisht asaj follore:

Në tej ndalojmë në analizën konkrete të strukturës së përkësues
apo sintagmave duke u mbështetur dhe zbatuar Teorinë \mathcal{L} , për
të ujuar në të njëjtin kulli me analizën e strukturës së brendshme
të frazës, dallimin e kategorive leksikore prej atyre funksionale,
mënyrat e realizimit të kenyefjalës në një gjukë si shqipia që, jo
rigorozisti, e kërkon shprehjen e saj.

Sidofisi, shtrakej me ngut nevoja për një tekst të simakesës, ku
të qjenin trajtim koncepte bazë të kësaj teorie gjuhësore, dhe
analiza konkrete e të dhënat që ofron shqipja, duke filluar që
nga njësitetë minime të organizimit të fjaleve e deni tek struktura
më të ndërlikuara.

Kështu, tremkëdhjetë kapitujt që përbëjnë këtë tekst, paraprihen
nga një hyrje që ka në fokus qasjen fillostarte ndaj gjuhës nënë,
mekanizmat e përvetësimit të kësaj gjuhe, duke i shkuar kësij
procesi në zanafillën e veti, në atë që Chomsky quan Gramatikën
Universale, për të ujuar më pas me koncepte të tjera si Parime
dhe Parametra, që që e shtrin analizën nga gjatha e parë
(amtare) drejt gjuhës së dytë (të huaj).

Vend të vegantë zë qithashiu, raporti që vendos sintaksen me
disciplinat e tjera, si gjendër e ndërligjës mes tyre.

Das hyrjes, teksti zë fill me analizën e regullave sintaksore të
bashkimit të fjaleve për formimin e njësive minimale, të
redukturave tashmë në vetëm dy, sipas Programit Minimalist
(shkruj-merge dhe leuit-movë).

Do ashtu, vëmendje e vegantë i kushtohet valencës së fjaleve,
kugesisht asaj follore:

Në tej ndalojmë në analizën konkrete të strukturës së përkësues
apo sintagmave duke u mbështetur dhe zbatuar Teorinë \mathcal{L} , për
të ujuar në të njëjtin kulli me analizën e strukturës së brendshme
të frazës, dallimin e kategorive leksikore prej atyre funksionale,
mënyrat e realizimit të kenyefjalës në një gjukë si shqipia që, jo
rigorozisti, e kërkon shprehjen e saj.

Refe orsyje qao verepe apo sugerum do te ushtre veze ne te minet te punes dhe te përmirësimit te cilësisë se këtij teksti.

Ky lliber u shërben studentëve te degjave te gjithas dhe Letërsisë, te Gjuhës së Shqipës, te Mësuesisë, por edhe të gjuhës atyre që kanë interesat te vëzanta në fushë të gjithësisë.

Së fundi, falendenjimë kolegët tanë për sugjerimet dhe këshillat miqaf te ulëshme e, në mënyrë të vegantë, recensuesit e tekstit:
prof. Shezai Rrokaj dhe prof. Rami Memushaj e krahas tyne edhe prof.as.dr. Alpida Jukani për mëleshjeten që i dhane këtu botimi.

Autoret

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET DHE SIMBOLET

HYRJE NË GRAMATIKËN GJENERATIVE (F.KOLECI)	13
0.0. Aftësia përtë folur si njohje e pavetëdijshme e njeriut	13
0.1. Të nxënët e gjuhës	14
0.1.1. C'dimë ne kur themi se njohim një gjuhë?	14
0.1.2. Gramatika si njohje e brendshme e njeriut	16
0.1.3. Varfëria e stimulit	18
0.2. Gramatika universale	20
0.3. Parametrit dhe parametrat	21
0.4. Nivelet e paraqites	23
KREU 1 (F. KOLECI)	
RREGULLA SINTAKSORE TË BASHKIMIT TË FJALËVE	25
1.0. Përbërësit e frazës	25
1.1. Kriteret përdallimin e përbërësve	26
1.1.1. Fraza e copëzuar	26
1.1.2. Morpërfshirja	27
1.1.3. Izolimi	28
1.1.4. Zëvendësimi	29
1.1.5. Bashkërenditja	29
1.1.6. Elipsa	30
1.1.7. Përbërës dhe dykupitëmësi	31
1.2. Valenca	32
1.2.1. Valenca e foljes	32
1.2.2. Valenca tek ffalët e tjera	33

KREU 2 (F. KOLECI)	69
TEORIAX'	71
2.0. Struktura e përbërësve	72
2.1. Struktura e sintagnës emëtore	74
2.2. Struktura e sintagnës foljore	80
2.3. Struktura e sintagnës parafallore	82
2.4. Struktura e sintagnës mbiemëtore	82
KREU 3 (G. TURANO)	35
STRUKTURA E FRAZËS	43
3.0. Struktura e brendshme e frazës	43
3.1. Fleksioni, kategori funksionale e frazës	44
3.2. Kohë (<i>Tense</i>) e Përshtatje (<i>Agreement</i>)	46
3.3. Realizimi i kryefjalës	47
3.4. Komplementuesi, kategori funksionale e frazës	49
KREU 4 (F. KOLECI)	41
ROLET TEMATIKE, ARGUMENTET DHE ADJUNKTËT	51
4.0. Hyrje	51
4.1. Argumentet e brendshëm dhe të jashtëm	51
4.2. Foljet ditranxitive	53
4.3. Adjunktët	54
KREU 5 (G. TURANO)	57
RREGULLA DHE KUFIZIME PËR FORMIMIN E PËRBËRËSVE	57
5.0. Shkrij (Merge) e Lëviz (Move)	57
5.1. Kufizime mbi lëvizjen e përbërësve në frazë	59
5.2. Llojet e ndryshme të lëvizjes	60
KREU 6 (G. TURANO)	63
STRUKTURA E BRENDSHME E SINTAGMËS EMËRORE DHE MBIEMËRORE	63
6.0. Sintagma determinante	63
6.1. Analizë e sintagnës determinante	65
6.2. Sintagma kuantifikatore QP	67
KREU 7 (F. KOLECI)	85
KLITIKËT: ANALİZË E STRUKTURAVE KU SHEAQËN ATA	85
7.0. Klitikët, vendi dhe roli i tyre në frazë	85
7.1. Zhvendosja e klitikëve në frazë	86
7.2. Klitikët dhe pozicioni i tyre argumentor në frazë	87
7.3. Sintagma klitike	88
7.4. Proklizë, enklizë, endoklizë	89
7.4.1. Klitikët në pozicion pasfoljor	89
7.4.2. Klitikët në mes të folijes	90
KREU 8 (G. TURANO)	90
FJALIA PYETËSE	91
8.0. Hyrje	91
8.1. Pyetëset WH	91
8.2. Periferia e majtë e frazës	92
8.3. Analizë e përbërësve brenda fjalisë pyetëse	94
8.4. Struktura e fjalisë pyetëse PO/JO	98
KREU 9 (G. TURANO)	98
FJALIA ME FOLJE NË MËNYRËN LIDHORE	107
9.0. Fjali të varurë dhe të pavarur me folje në lidhore	107
9.1. Struktura e fjalisë me folje në lidhore	110
9.2. Fjali të me folje në lidhore pa komplementues	112
9.3. Fraza kauzative	114
9.4. Fraza me folje modale	115
KREU 10 (G. TURANO)	115
FRAZA KUSHTORE	119
10.0. Mjetet lidhëse në frazat kushtore	119
10.1. Struktura e frazës kushtore	121

KREU 11 (F. KOLECI)
PASKAJORJA DHE NDËRTIMET E TJERA FOLJORE
TË PASHTJELLUARA

11.0. Ndërtimë të varura formash foljore të pashtjelluara	129
11.1. Përqasje ndërtimesh mes paskajores standarde dhe asaj gege	130
11.2. Ndërtimë të tjera formash foljore të pashtjelluara	131
11.3. Analizë strukturore e formave foljore të pashtjelluara	133

KREU 12 (F. KOLECI)

FRAZA RELATIVE	139
12.0. Mbi konceptimin e frazës relative	139
12.1. Dy aspektet themelore lidhur me studimin e frazave relative	140
12.1.1. Çëshja e procesit të lidhjes	141
12.1.2. Çëshja e procesit të modifikimit	142
12.2. Fraza relative kufizuese	143
12.3. Analizë e frazave relative kufizuuese	144
12.3.1. Relativet kufizuese me komplementesin ‘që’	144
12.3.2. Determinanti i prin kokës relative	145
12.3.3. Determinanti ndjek kokën relative	147
12.4. Fraza relative shtuese	150
12.5. Analiza e frazave me shtuese relative shtuese	151
12.5.1. Relativet shtuese me përemra lidhorë	152
12.5.2. Relativet shtuese me ndajfolje lidhorë	154
12.6. Frazat relative të lira	157
12.6.1. Determinanti dhe koka relative	157
12.6.2. Koka relative XP apo X ⁰	159
12.7. Analizë e frazave relative të lira	160
12.7.1. Ndërtimi pa parafralë	161
12.7.2. Ndërtimi me parafralë	144

KREU 13 (G.TURANO)

STRUKTURA SINTAKSORE E SINTAGMAVE	165
DHE FRAZAVE ME BASHKËRENDETITJE	165
13.0. Nënrenditje përkundër bashkërenditje	165
13.1. Bashkërendija e sintagmave	166
13.2. Struktura e sintagmave të bashkërenditura	167
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	173

A	Mbiemër (<i>Adjective</i>)
AGR	Përshtatje (<i>Agreement</i>)
AgrP	Sintagnë e përshtatjes (<i>Agreement Phrase</i>)
AP	Sintagnë mbiemërore (<i>Adjective Phrase</i>)
C / COMP	Komplementues (<i>Complementizer</i>)
Cl	Klitik (<i>Clitic</i>)
CIP	Sintagnë klitike (<i>Clitic Phrase</i>)
Coord	Bashkërenditje (<i>Coordination</i>)
CoordP	Sintagnë e bashkërenditjes (<i>Coordination Phrase</i>)
CP	Sintagnë komplementuese (<i>Complementizer Phrase</i>)
D	Determinant (<i>Determiner</i>)
D_{Adj}	Determinant i mbiemrit (<i>Adjective Determiner</i>)
D_{Op}	Sintagnë e operatorit (<i>Operator Phrase</i>)
DP	Sintagnë determinante (<i>Determiner Phrase</i>)
DP_{Adj}	Sintagnë determinante e mbiemrit (<i>Adjectival DP</i>)
DP_{OP}	Sintagnë determinante e operatorit (<i>Operator DP</i>)
DP_{Poss}	Sintagnë determinante e pronorit (<i>Possessive DP</i>)
Fin	Shqetësimi (<i>Finity</i>)
FinP	Sintagnë e shqetësimit (<i>Finiteness Phrase</i>)
FocP	Sintagnë e fokusit (<i>Focus Phrase</i>)
Force	Forcë
ForceP	Sintagnë e forcës (<i>Force Phrase</i>)
GU	Gramatikë universale (<i>Universal Grammar</i>)
i	Indeks (<i>Reference indice</i>)
I / INFL	Fleksion (<i>Inflection</i>)
IP	Sintagnë fleksionale (<i>Inflection Phrase</i>)
CompL	Komplement

L1	Gjuha e parë / Gjuha aritare
L2	Gjuha e dytë
M / Mood	Mënyrë (Mood)
MP	Sintagmë e mënyrës (Mood Phrase)
N	Emër (Noun)
NP	Sintagmë emrëre (Noun Phrase)
O	Kundrinor (Object)
P	Paraçjalë (Preposition)
Poss	Pronor (Possessive)
PossP	Sintagmë pronore (Possessive Phrase)
PP	Sintagmë Paraçjalore (Preposition Phrase)
Pro	Përemër bosh (Silent Pronoun)
Q	Kuantifikues (Quantifier)
QP	Sintagmë kuantifikuese (Quantifier Phrase)
S	Kryesfalë (Subject)
Spec	Specifikues (Specifier)
SpecXP	Specifikues i XP-së (Sintagmë e paemërtuar) (Specifier of XP)
t	Gjurmë (trace)
T / Tense	Kohë (Tense)
Top / Topic	Topik (Topic)
TopP	Sintagmë e topikut (Topic Phrase)
TP	Sintagmë e kohës (Tense Phrase)
V	Folje (Verb)
VP	Sintagmë foliore (Verb Phrase)
Wh	Element/tipar pyetës (Interrogative element/feature)
X	Variabël
YP, ZP	Sintagma të paemërtuara (Unspecifies Phrases)
° (X°)	projekioni zero (X)
‘ (X’)	projekioni i ndërmjetëm
“ (X”)	projekioni maksimal (XP)
Ø	Posicion bosh (Empty position)
?	fjali gjysmëgramatikore
*	fjali jogramatikore
+, :, =	simbole primitive

HYRJE NË GRAMATIKËN

GJENERATIVE

0.0. Aftësia për të folur si njohje e pavetëdijshme e njeriut

Ka forma të ndryshme me anë të të cilave njëzet shprehin mendimet, ndjenjat, emocionet e çdo gjë tjetër që ka të bëjë me natyrën njerëzore. Shpeshherë kjo mënyrë të shprehuri njesohet me komunikimin, këshut që mund të flitet për forma të shprehuri nëpërmjet muzikës, kinemasë, artit në terësi, modës, minikës, trupit etj.

Sigurisht, të folurit edhe pse trajtohet si një kod komunikimi, i tejkalon caqet që përcaktojnë përmasat e elementeve të sipërpërmendura. Mjafton të kujtojmë dallimin e madh mes gjuhës natyrore dhe asaj artificiale (shenjat rrugore etj). Po ashtu, kujtojmë faktin që edhe procesi i të menduarit në verville mund të kuptohet veçse si një formulim gjuhësor (pavarësisht përdorimit apo jo të zërit).

Sic dihet, të folurit, për vetë natyrën që e karakterizon, nuk mund të shihet i shkëputur nga një sërë aspektesh shoqërore, kulturore, psikologjike, gjografike, politike etj. Por të gjitha këto janë objekt studimi i disiplinave përkatëse, ndërsa sintaksa, kriesisht ajo gjenerative, synon ta zhvleshë procesin e të folurit prej të gjitha këtyre dhei ta shohë gjuhën jo si një dukuri të illojt historik e shoqëror, por të lidhur ngushtë me aftësimë e lindur të njeriut për të folur, që ka e dallon

atë nga të gjitha speciet e tjera të gjalla. Noam Chomsky shpreh idenë se gjuhësia duhet t'u japë përgjigje disa pyetjeve themelore si: Ku konsiston njohja e gjuhës? Si realizohet procesi i përvetësimit të një gjuhe? Ç'dimë kur themi se njohim një gjuhë? Disa nga përgjigjet që u janë dhënë këtyre pyetjeve dhe mjaft të tjerave si këto nga studime të ndryshme, jepen në vijim, duke analizuar të dhënat që ofron shqipja

0.1. Të nxënët e gjuhës

0.1.1. Ç'dimë kur themi se njohim një gjuhë

Së pari, duhet bërë dallimi mes gjuhës së nënës dhe një gjuhe çfarëdo të dyti që folësi e mëson në një moshë që nuk është ajo e fëmijërisë. Procesi i mësimit të këtyre dy gjuhëve është i ndryshëm. Gjenerativistët i kushtojnë vëmendje të vecantë përvetësimit të gjuhës së parë (L1), të ashtuquajtur gjuha e nënës. Kjo, sipas tyre, ‘ritet’ me fëmijën ashtu siç riten, bie fjala, dhëmbët.

Themri se fëmijës po i dalin dhëmbët (jashtë vullnetit të tij) dhe jo fëmija po rrit dhëmbët. Po ashtu qëndron puna me gjuhën, të cilën e merr natyrshëm dhe në mënyrë spontane. Nuk mund të thuhet e njëjtë gjë kur, bie fjala, ai fillon të mësojë gjeografinë, apo edhe ndonjë konkrektisht tek frazat:

- (1) *Treni do niset pas pak*
- (2) *Treni do të niset pas pak*
- (3) *U thashë të primit*
- (4) *Ju thashë të primit*

Normal e gjuhës shqipe na diktojnë se frazat (1) dhe (3) nuk janë të ndërtuara drejt, pra kemi të bëjmë me fraza jokorreke, edhe pse hasen dendur në përdorimin e përditshëm të shqipfolësve. Ndërsa ndërtimet (2) dhe (4) i respektojnë këto norma, prandaj mund të quhen fraza korakte. Por, pavarësisht këtij dallimi mes tyre, folësit dhe dégjuesit, në rrëthana të caktuara, janin dhe marrin me njëri-tjetrin si me njërin variant ashtu dhe me tjetrin, pa hasur vështirësi në komunikim dhe

sidomos pa u kushtuar vëmendje normave të paracaktuara për drejtshtërimin, drejtshqiptimin apo formulinin e drejtë të frazave. Kjo, sidqofofe, nuk mund të thuhet përfrazen (5), e cila do t'i viste veshin që folësi që ka si gjuhë antare shqipen, apo e njeh mirë atë.

(5) *Fëmija dhuroi një lule nënës¹

(6) *Fëmija i dhuroi një lule nënës*

Dallimi mes frazave (5) dhe (6) qëndron, në dukje, në një detaj të vogël, në rimirjen apo jo të kundrinoxit të zhdrojë me anë të trajtës së shkurtër, e megjithatë, një folës shqiptar nuk do të ndërtonte një frazë si (5) dhe nuk do ta mirëpriste atë. Pra, dallimi mes frazave (1-3) dhe (5) sido që asnjëra nuk i respekton normat e shqipes, është i dukshëm. Dy të parat shihen si të gabuara, duke u bazuar në atë normë që përcakton rregulla të caktuara përfshiqpen, ndërsa fraza (5) ‘nuk tingëllon mirë’ përfshiqpfolësit. Nëse të parat (1-3) janë fraza jo korakte, kjo e fundit (5) është një frazë *jogramatikore*.

Lind pyetja: ku bazohet ky perceptim i pavetëdijshëm (një pjesë e tyre as që kanë dégjuar të flitet përfshiqpen, ndërsa pse i përdorin ato pa asnjë vështirësi) që ka folës-dëgjuesi rrëthë këtij ndryshimi dhe pse folësi që e ka shqipen si gjuhë të dytë, sidon që me një punë të gjatë e sistematike përmësimin e saj, e ka të vështirë dhe thuaje të pamundur përfshiqpen atë.

Dhe risjellim një ndër pyetjet e parashtruara më lart: Cfarë dimë kur njohim një gjuhë, gjuhën amitare? Si shpjegohet fakti që një fëmijë, në rrëthana të zakonshme, e nxë gjuhën e nënës natyrshëm qysh në moshë të hershme, ndërsa të riturit, i cili vendos të mësojë një gjuhë, i lipset kohë dhe mund të kënaqet me një njojeje të pjesës së sidoqofte jo të nivelit të gjuhës amitare?

Moro (1997), me synimin përfshiqjet e shtron krahas saj pyetjen analoge duke u kuptueshme kësaj pyetjeje, shtron krahas saj pyetjen analoge duke u hedhur në një disiplinë tjeter: Ç'dimë ne kur themi se e njohim aritmëtikën? Aritmetika mund të shihet së paku në dy mënyra të ndryshme, ose si tërësi e të gjitha mbledhjeve, zbrijeve, shumëzimeve apo pjesëtimëve me të gjithë numrat e mundshëm, ose si tërësi rregullash që na mundësojnë kombinimin e simboleve primitive (+, -,

¹ Yllihi (*) këtë e tuje do të përdoret në krye të atyre frazave që nuk janë të ndërtuara drejt.

; = ..) me të gjithë numrat natyrorë. Sigurisht, me njohje të aritmetikës nënkuptohet kjo e dyta, pra njohja e mënyrave se si kombinoinjnë gjithësinë e numrave. Në këtë prizëm duhet ta kërkojmë përgjigjen rreth njohjes sonë mbi gjuhën.

0.1.2. Gramatika si njohje e brendshme e njjeriut

Chomsky (1980) synon të hedhë dritë mbi mënyrën se si duhet bërë ndarja mes njohjes dhe realizimit konkret, përdorimit të gjuhës. Madje ai e thellon këtë ndarje deri aty sa shquan gjuhën e brendshme *Internal Language* (që ka të bëjë me afërsinë e kombinimit të fjalëve në fraza, të morfemave në fjalë etj.) nga gjuha e jashtme *External Language* (që ka si objekt studimi tërësinë e frazave të realizuara në një gjuhë të caktuar, pra një korpus konkret të dhëna). Të bësh dallimin mes gjuhës së brendshme dhe asaj të jashtme nuk është aq e thjeshtë sa q'mund të ngjajë aty për aty.

Për ta sjellë më afér mendsh, le t'i referohemi shërbimini që na ofron navigatori i instaluar në makinën tonë. Nuk është aq e vështirë të kuptohet se pëse me një saktësi prej makinerie ai na heq rrugën me fraza të tilla, si: *pas 1 km kthehu djalitas, kthesë pas 500 metash* etj. Sigurisht, ka një sistem ku janë instaluar një numër i kufizuar frazash, të cilat përzgjidhen në bazë të disa rregullave po ashtu të instaluara. Pra, nga navigatori duhet të presim të na thotë as më shumë e as më pak se aq fraza sa ka në kujtesën e vet.

Ndryshe qëndron puna me një fëmijë që sapo ka zënë të flasë gjuhën e nënës së vet. Askush nuk mund ta çojë nepër mend që ky fëmijë të ketë në trurin e tij një listë të kufizuar frazash të cilat i përdor sistematikisht në kontekste të caktuara. Jo, përkundrazi, të gjithë jemi dëshmitarë që fëmijët na habitin dhe na mrekullojnë me thënë që nuk pritnë t'i dëgjonim nga goja e tyre. Ata janë në gjendje të formulojnë fraza që nuk i kanë thënë e as i dëgjuar më parë, qofshin të nevojshme apo jo, të vërteta apo gënjeshtra, të arsyeshme apo jo. Kjo do të thotë se mendja e fëmijës zotëron disa rregulla që i bëjnë të mundur të ndërtojë (dhe të kuptojë) një listë të gjatë e të pafund frazash. Për folësine e gjuhës amtare, këto rregulla dhe kjo njohje janë të lindura, të trashëguara dhe jo të mësuara (si në rastin e një gjuhe të

dytë – L2), prandaj detyra e gramatikës gjenerative është të zbulojë dhe të bëjë eksplicite gjithë këtë njohje implicate. Të shpjegojë se si në bazë të këtyre rregullave folës-dëgjuesi është në gjendje të kuptojë se gabimi që haset në ndërtimet (1) dhe (3) nuk është i njëjtë me gabimin në (5), shembuj që po i rishellim këtu përkatesisht si (7 a,b,c):

- (7) (a. *Treni do niset pas pak*
 b. *U thashi të primit*
 c. **Fëmija dhuroi nënës një lule*

Këto ndërtime, edhe pse jogramatikore, nuk janë të pakuptimta, ashtu siç nuk është e thënë që çdo frazë gramatikore të jetë me kuptim:

- (8) **Treni po ha drekë*
 (9) **Lulja i dhuroi fëmijës një nënë*

Frazat (8) dhe (9) janë ndërtimë gramatikore, por natyrish të pakuptimta, përvëçse në ndonjë kontekst metaforik, ashtu siç mund të ishin njëkohësisht të pakuptimta dhe jogramatikore:

- (10) **Treni po hamë drekë*
 (11) **Lulja i dhuruam fëmijës një nënë*

Në vargun e njohjeve implicate, të brendshme, intuitive që zoteron folësi i një gjuhe amtare, mund të renditen një sërë shembujsh që ai është në gjendje t'i ndërtojë apo t'i shkoqitë kuptimin e tyre pa vështirësinë që mund të hasë gjatë studimit të një gjuhe L2. Mund t'u referohemi këtu ndërtimëve pësore:

- (12) *Tregtarët rritiën qmimet*

(13) *Qmimet u rritiën nga tregtarët*

Të gjithë mund ta marrim me mend përpjekjen që kërkohet nga një i huaj për të mësuar hap pas hapi kalimin nga ndërtimi vepor në atë pësor, edhe pse teorikisht mund ta ketë shumë të qartë, në mos tjetër duke iu referuar gjuhës së vet amtare, ashtu siç mund të kemi natyrshëm një përdorim të përsosur nga një folës shqiptar i cili mund të mos jetë interesuar kurirë përfaktë të tillë gjuhësore. Po ashtu, mund të sjellim mjaft shembuj të tjera, si rasti i lidhjes së menjëherëshme apo në distancë mes fjalëve të ndryshme:

- (14) *Iliri flet me vete*

- (15) *Gjyshja e llirit flet me vete*
- (16) *Ilirin e pa gjyshja të flasë me vete*
- (17) *Ilirin e pa gjyshja tek fliste me vete*

Si folës të shqipes, nuk ka qenë e nevojshme të na shpiegohej dallimi mes ndërtimeve të mësipërme (14-17), ashtu siç është e panevojshme të shpriegohet sinonimia mes frazave (12)-(13), sepse, kur kemi nxënë shqipen si gjuhë amtare, është zhvilluar në ne një aftesi që qëndron në themel të këtyre perceptimeve intuitive (Chomsky 1980). Në këtë këndvështrim, gramatikës gjenerative i dalin përballë dy detyra të rëndësishme: së pari, siç u tha më lart, ajo duhet të shkoqitë të bëjë eksplikite këtë njohje të brendshme, si aftesi e lindur e njeriut, dhe, së dyti, të shpjegojë mënyrën se si përftohet kjo aftesi.

Chomsky i ka kushtuar një vëmendje të veçantë dallimit mes kësaj njohjeje dhe fakteve, realizimeve konkrete gjuhësore. Kjo ka bërë që termi gramatikë të shihet në dykuptimësinë e vet: si aftesi e mendjes njerëzore dhe si teori gjuhësore (Chomsky 1986). Ky këndvështrim i ri e dallon gramatikën gjenerative nga gramatika tradicionale.

0.1.3. Varfëria e stimullit

Deri para viteve '50 të shekullit XX, procesi i të folurit shihej më shumë si një lloj sjelljeje njerëzore sesa si njohje e brendshme e tij. Ky qëndrim kishte zënë vend në traditën gjuhësore strukturaliste të përfaqësuar në mënyrë të veçantë nga gjuhëtari i mirënjohur L.Bloomfield. Chomsky i kundërvihet kësaj teorie bilenjoriste të propozuar dhe të argumentuar më hollësisht nga B. F. Skinner (1957). Sipas këtij të fundit, procesi i të folurit nuk duhet parë si diçka e brendshme e aparatit njerëzor, por duhet shpieguar duke u nisur nga kushte të jashtrme që e rrethojnë folësin. Kështu, procesi i të folurit përcaktohet nga *stimujt* që vijnë nga jashtë, nga *reagimet*, përgjigjet që janë rrjedhë e këtyre stimujve dhe, së fundi, nga miratimi, *përforcimi*. Po risjellim një shembull të këtij autorit. Nëse fëmija shikon një kakkull, ky fakt do të shërbejë si stimul që e shtyn fëmijën të reagojë, t'i përgjigjet këtij stimuli duke shqiptuar fjalen 'kukull'. I rituri (prindi, dadoja etj) do ta miratojë dhe përforcojë (të lumtë, përsëritë etj.) këtë hap që hedh

fëmija në procesin e ligjërimit. Kështu sillët fëmija kur thotë 'ujë', 'bulë' etj (duke iu përgjigjur stimuje të brendshëm si etje, urtë etj) dhe shëh që i rritura i jep të pije apo e ushqen. Pra, sipas Skinner-it miratimi, përforcimi është një detaj po aq i rëndësishëm sa stimuli dhe reagimi gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës.

Në kundërshtim me këtë, Chomsky (1957) sjell një sërë argumentesh për të provuar pamjaftueshmërinë e stimujve të jashtëm gjatë procesit të nxënies së gjuhës. Një nga ata është *kreativiteti* apo aftësia krijuese. Ne mund të prodhojmë fraza dhe thënë që nuk i kemi dëgjuar kurrë më parë. Si mund të kontrollohet një sjellje e tillë nëpërmjet stimujve? Po ashtu, për të sjellë një shembull të përdorur nga vëtë Chomsky, nuk është e nevojshme ta kemi përfjetuar nga afër një situatë reale për të formuluar një frazë të tillë, si: *Vullkani sa vjen e fugizohet*. Stimuli nuk duhet parë aq i 'kulluar' dhe i thjeshtë në reagimet që mund të shkaktojë, sepse shpeshtësia është i paparashikueshëm. P.sh. përbalë perëndimit të diellit, bashkëfolësít mund të reagojnë me fraza nga më të ndryshmet, si: *Sa do në doja të isha në det tan!* A të *kujtohet mësuesi i geografsë?* *Poradecin do ta lexoja e rilexoja qindra herë etj.*

Rreth varfërisë së stimulit për përvetësimin e gjuhës nga fëmija është thënë mjaft, dhe këtu po sjellim vëtëm disa fakte shumë të thjeshta. Fëmija, ndryshe nga i tritturi që vendos të mësojë një gjuhë, nuk ka asnjë plan apo parashikim për këtë proces gjuhësor. Në qoftë se i rituri, për mësimin e gjuhës së dytë L2, programon kohën, metodat, përzgjedh shkollën apo programet (mjafton të sjellim ndërmend studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja apo një sërë kursesh të ngritisura për këtë qëllim), ai nuk mund të kujtojë asnjë lloj përpjekjeje përmes gjuhës së parë L1, por di që e zoteron atë mjaft mirë, pikërisht së mund të fitet gjuhha e nënës. Koha gjatë së cilës e ka gjuhë të dytë, për të mos folur pastaj për rezultatet që jo gjithnjë e shpërblejnë mundin e bërë. Sipas Cook-ut (1991) varfëria e stimulit shpjegohet nëpërmjet këtyre katër fazave:

- A. *Një folës i lindur i gjarëdo gjinhe një aspekt të caktuar të sintaksës.*

Si pikë nisje shërben njohja që zotëron paraprakisht folësi i lindur. Kështu, ai ka aftësinë që të kuptojë se një ndërtim i tillë si në (18) nuk është i saktë, edhe pse mund të mos dijë të shpjegojë arsyet se pse:

(18) **Makina që trenin mora, rrëzova*

- B. *Kjo pjesë e njohjes së sintaksës nuk mund të përfiohet nga të dhënat gjuhësore me të cilat përballet fillimi i një fëmije.*
Nëpërmjet kësaj faze dëshmohet që të dhënët fillestare gjuhësore janë të pamjaftueshme për zotërimin e këtij aspekti sintaksor, pra materiali gjuhësor me të cilin fëmija vihet fillimish në kontakt është i pamjaftueshëm. Atij më së shumti i jepen modele të saktë dhe i korrigohen gabime të natyrës së moshës së vet.

- C. *Kjo njohje e sintaksës nuk mund të merret nga konteksti i jashtëm.*
Kjo do të thotë që fëmija e zotëron këtë njohje në mendjen e vet dhe nuk mund të kërkohet jashtë saj.
D. *Ky aspekt i sintaksës është një element i lindur i mendjes njerëzore.*

0.2. Gramatika universale

Duke qenë se fëmija në rrethana të zakonshme mund të nxërë çdo lloj gjuhe, kjo sipas Chomsky-t nënkuption se të gjitha gjuhët natyrore kanë disa tipare të përbashkëta, me fjalë të tjera, gjuhët duhet të jenë të ngjashme në një nivel abstrakt të tyre, edhe pse në dukje ato dallojnë diku më shumë e diku më pak njëra prej tjetrës. Pra, çdo njieri (përveç rasteve të ndryshme patologjike) lind me aftësinë për të folur dhe ky është një tipar që e dallon atë nga speciet e tjera (zogjtë janë të predispozuar të fluturojnë, peshqit të notojnë, të tjerë të zvarriten e këshfu me radhë). Por kjo aftësi e lindur e njeriut nuk e përcaktion llojin e gjuhës mëmë që do të mësojë një individ.

Gjitha e përvetësuar nga fëmija është gjuhë e mjesdit të ku ai rritet, thënë ndryshe, një fëmijë i lindur nga prindër kinezë, por i bërësuar nga prindër shqiptarë, do të ketë si gjuhë amtare shqipen, sepse ai vihet së pari në kontakt me të dhënët që i ofron kjo gjuhë. Pra, fëmija zotëron në trurin e tij një njohje abstrakte, e cila përpunon ato të dhëna gjuhësore që i ofron ambienti ku ai rritet.

Kjo njohje e trashëguar gjenetikisht që zotëron folësi amtar në trurin e tij përbën atë që quhet Gramatikë Universale (GU). Lidhur me këtë gjitha gjuhët duhet të kenë disa veçori të përbashkëta mes tyre. Pra,

Chomsky (1981, fq.178) shkruan: *Gramatika universale mund të shihet si një teori rrëth mekanizmave të lindur, si një trashëgimi biologjike nëpërmjet së cilës zhvillohet të nxënët e gjuhës. [...] Parimet e gramatikës universale mund të konsiderohen si një shpjegim abstrakt dhe i pjesëshëm i programit gjenetik falë të cilit fëmija është në gjendje të përpunojë disa të dhëna si përvojë vetjake gjuhësore dhe të ndërtojë një sistem rrugullash dhe parimesh mbi bazën e kësaj përvije.*

Ky proces i përpunimit të dhënavë që mundëson kalimin nga gramatika universale drejt gjuhës amtare mund të paraqitet përmes një skemë të thjeshtëzuar e konvencionale (srrh: Cook, Nweson 1996:103). Procesi i përvetësimit të gjuhës amtare (L1) kalon përmes gramatikës universale, kësaj njohjeje që folësi trashëgon gjenetikisht, por po aq e rëndëssishme është qasja e tij ndaj të dhënavë të para gjuhësore.

Nëse nuk realizohet kjo, pra nëse fëmijës i mohohet kontakti me një mjesid të caktuar gjuhësor, atëherë gramatika universale që ai zotëron mbetet shterpë dhe ky fëmijë e ka të pamundur njohjen dhe përdorimin e një gjuhe. Siç ndodh rëndon, çdo fëmijë lind në varësi të rrethanave të ndryshme sociale, kulturore, ekonomike etj. mes përkujdesjesh të shumta për rrjeten dhe zhvillimin e tij normal. Në këtë proces të shumëfishtë, ai thua se në mënyrë të pavetëdijshme, kryen përvetësimin e gjuhës mëmë siç pasqyrohet në figurën (1).




Fig. 1. Modeli i përvetësimit të gjuhës amtare (L1)

0.3. Parametet dhe parametrat

Gramatika universale duhet parë e lidhur ngushtë me Konceptin e së ashuquajturës “gjuhë natyrore e mundshme”, që do të thotë që të gjitha gjuhët duhet të kenë disa veçori të përbashkëta mes tyre. Pra,

gjuhët, sado të ndryshme në dukje, nuk mund të janë krejtësisht të ndryshme prej njëratjetrës. Me këtë duhet kuptuar që gramatika universale, siç ë theksojnë shumë studiues, është një sistem i hapur, që mirëpret disa tipare të veganta të cilat nuk janë të lindura dhe të trashëgura gjenetikisht, por të fituara falë përvojës vetjake gjuhësore.

Këto tipare të veganta quhen parametra, ndërsa të përbashkëtët mes të gjitha gjuhëve quhen parime. Kështu, një ndër parimet më të përmendura është prania e kryefjalës në të gjitha gjuhët, ndërkohë që shprehja leksikore ose jo e saj në fjalë përbën një parametër që i dallojnë gjuhët mes tyre. Le t'u referohemi shembujve të mëposhtëm:

- (19)
- a. *Flas*
 - b. *Parlo* (it.)
 - c. *Hablo* (spanj.)
 - d. *(*I*) *speak* (engl.)
 - e. *(*Ich*) *spreche* (gjerm.)
 - f. *(*Je*) *parle* (frëngj.)

Shembujt e sjellë (a, b, c) përkatesisht në shqipe, italishtë dhe spanjishtë, na lënë të kuptojmë që kryefjala mund të mos jetë e shprehur leksikalish, pra mund të hiqet, ndërkohë që në grupin e dytë të gjuhëve (d, e, f), përkatesisht anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht, heqja e kryefjalës është e pamundur edhe pse gjuhë si gjermanishtja kanë një epitet posjor mjaft të zhvilluar.

Dukuria e përdorimit apo jo të kryefjalës në fjalë përbën një parametër që, në dukje, i bën të dallojnë këto gjuhë prej njëra-tjetrës edhe pse bashkëndajnë të njëjtin tipar (parim); të gjitha këto gjuhë kanë kryefjalë. Përbledhtazi i rikthehemë pohimit të Chomsky-t, sipas të cilët çdo qenie njerëzore trashëgon aftësinë për të folur dhe është gjenetikisht i predispozuar për përvetësimin e gjuhës.

Kjo aftësi e lindur, e quajtur edhe gramatikë universale, nuk është një sistem i mbyllur, pasi lë të hapur mundësinë e përzgjidhjes së disa tipareve të veganta për çdo gjuhë, të ashtuquajturi parametra. Nxënja e një gjuhe amtare realizohet falë përvetësimit të këtyre parametrave; kështu mund të flasim për *gjuhë të vecanta* si: shqipja, frëngjishtja, kinezishja etj., krahas të përbashkëtës përtë gjithë, *gramatisës universale*.

0.4. Nivelet e paraqitjes

Modeli teorik i propozuar nga Chomsky që në vitet '50 të shekullit XX, është rishikuar dhe modifikuar në rrijedhë të kohës deri në ditët e sotme si nga vetë autorri, ashtu dhe nga një sëri studiuesish që i përbahen modelit të tij gjenerativist. Përbledhtazi po jepim një pasqyrim të shpejtë të arritjeve më të fundit të modelit gjenerativist (Programit Minimalist), rrëth konceptimit të regullave dhe organizimit të elementeve gjuehësore. Sipas gramatikës gjenerative gjueha formohet prej dy përbërësve themelorë, që janë leksikoni dhe sistemi llogaritës.

Leksikoni përbën të gjitha fjalët e një gjuehe së bashku me informacionin që mbartin ato. Kështu, foljet *eci*, *takoj* etj., përvëg kuptimit të tyre semantikor, përcjellin edhe informacionin rrëth të qenit të tyre kalimtare ose jokalimtare etj. Nga ana tjeter, sistemi llogaritës ka të bëjë me strukturën e frazës. Duhet pasur parasysh se, kur flasim për strukturë, përqendrohemë kryesisht të rendi hierarkik i njësive dhe jo aq të rendi linear i tyre. Kështu, kur ndërtojmë një frazë të tillë, si:

- (20) *Ana i dhuroi llirin e vet.*

rendi hierarkik është ai që mund të na i zbulojë lidhjet në frazë, çka do të thotë se lidhja midis fjalës *Ana* dhe anaforës *e* vet nuk përkon me rendin linear të këtyre fjalëve. Thënë shkurt, për të kuptuar ndërtimin e një fraze duhet të dëmë që njësiti leksikore që përzgjidhen nga leksikoni, sistemi llogaritës i bashkon dy e nga dy, pra në një lidhje gjithnjë binare². Sidoqoftë, lidhjet sintaksore nuk mund të shpjegohen vetëm nëpërmjet kësaj rrugulle bashkimi, pasi transformimet e ndryshme shpeshherë kërkojnë zbatimin e një irregullë tjetër, asaj të zhvendosjes së përbërësve në frazë, siç dëshmohet në (21):


- (21) *Cfarë i dhuroi Ana llirit?*

Dihet që rendi neutral i shqipes është kryefjalë-kallëzues-kundrinor, ndërsa në (21) ky rend është përbysur, falë lëvizjes së përbërsë, çka e ka sjellë kundrinorin e drejtë në krye të fjalisë. Pra, siç vihet re,

² Shih 1.4.

përfitimi i një fraze duhet parë si rezultat i zbatimit të dy rregullave kryesore, asaj të bashkimit të përbërësve në një lidhje binare dhe zhvendosjes së tyre sipas rregullave të caktuara në çdo gjuhë. Që në studimet e hershme të Chomsky-t ka zënë vend ideja se çdo shprehje gjuhësore ka nivelet e veta të paraqites. Para së gjithash, çdo shprehje duhet parë e lidhur me artikulimin e një sërë tingujsh dhe kjo përbën Formën Fonetike. Nga ana tjetër, një shprehje gjuhësore nuk mund të kuptohet pa mundësinë e interpretimit të saj logjiko-semantikor, qka përbën Formën Logjike.

Sintaksa zë vend mes këtyre dy niveleve, duke realizuar lidhjen mes dy sistemeve. E thënë ndryshe, sintaksa ndërfaqet si me Formën Fonetike dhe Formën Logjike nga njëra anë, ashtu dhe me leksikonin nga ana tjetër. Kjo lidhje mes përbërësve të ndryshëm gjuhësore paraqitet në skemën e nëposhtme:



RREGULLA SINTAKSORE TË BASHKIMIT TË FJALËVE

1.0. Përbërësit e frazës

Për ndërtimin e frazës shërbijnë një ose më shumë fjalë që lidhen me njëra-tjetrën në bazë të rregullave të përcaktuara qartë në çdo gjuhë. Nga bashkimi i tyre lindin njësi të ndryshme, ndër të cilat i ashtuquajturi *përbërës*, që është një njësi e ndërmjetme mes frazës dhe fjalëve që e përbëjnë këtë frazë. Folësi i gjuhës mëmë është i pajisur me një aftësi të lindur për të bërë dallimin mes përbërësit dhe rije grupi të çfarëdoshëm fjalësh, edhe pse mund të mos jetë i vetëdijshëm për këto njojohuri që zotëron. Le t'i referohemi konkretisht një fraze:

- (1) *Njëri prej gazetarëve e përcollit këtë lajm pa shtrembërimë*
Kjo është një frazë e rregullt si nga pikëpamja ndërtimore, ashtu dhe semantike dhe njohësi i shqipes është në gjendje t'i grupojë fjalët e

³ Sipas një propozimi të fundit, të ashtuquajtur ‘hipoteza leksikore’ (*lexiclist hypothesis*), leksikoni i përmban fjalët së bashku me fletisionin e tyre, pra që më përparrë ‘ndërrhyrjes sintaksore’.

saj, pavarësishët prej renditjes së tyre të njëpasnjëshme. Kështu, duke u nisur nga renditja lineare, mund ta ndajmë këtë frazë në këto grupe fjalësh: *njëri prej, gazetarëve e përcollit, lajm pa etj.* Megjithatë mund ta kuptojmë se kemi të bëjmë vetëm me segmente të rastësishme fjalësh, të cilat nuk kanë lidhje sintaksore mes tyre, për shkak se janë prerë pa ndonjë kriter prej frazës. Ndryshe qëndron puma me grupet e fjalëve: *njëri prej gazetarëve, këtë lajm dhe pa shtrëmbërimë.* Duke i krahasuar me të parat, vihet re se vetëm këtë të fundit mund të zhvendosen lirshëm duke zënë pozicione të ndryshme në frazë.

- (2) *E përcollit pa shtrëmbërimë këtë lajm njëri prej gazetarëve*
- (3) *Pa shtrëmbërimë e përcollit këtë lajm (vetëm) njëri prej gazetarëve*
- (4) *E përcollit pa shtrëmbërimë njëri prej gazetarëve këtë lajm (jo një tjetër)*

Në frazat (2-4) grupe të ndryshme fjalësh zhvendosen pa e prishur gramatikalitetin e frazës, por nëse provojmë të lëvizim segmente të rastësishme fjalësh si *njëri prej, gazetarëve e përcollit apo lajm pa* do të përfitonim ndërtimje gramatikore si në (5-7):

- (5) **Gazetarëve e përcollit këtë lajm pa shtrëmbërimë njëri prej*
- (6) **Njëri prej këtë lajm pa shtrëmbërimë gazetarëve e përcollit*
- (7) **Lajm pa njëri prej gazetarëve e përcollit këtë shtrëmbërimë*

Kjo do të thotë se vetëm përbërësit kanë vettinë që të zhvendosen lirshëm në frazë, por jo një grup i çfarëdoshëm fjalësh. Përveç kësaj, përbërësit gëzojnë edhe veit të tjera, të cilat po i rendisim në vijim, duke i zbuluar në formën e një testimini.

1.1. Kriteret për dallimin e përbërësve

1.1.1. Fraza e copëzuar

Aftësia për të ndërtuar fraza të copëzuara është e lidhur edhe me aftësinë për të njohur dhe dalluar përbërësit nga segmente të rastësishme fjalësh. Po që është një frazë e copëzuar? Për t'i dhënë

përgjigje sa më konkrete pyjetës së shtruar, le të shohim frazën e mëposhtme (8), të përfuar nga copëzimi i frazës (1):

- (8) *Qe njëri prej gazetarëve që e përcollit këtë lajm pa shtrëmbërimë*
Nga një frazë e thjeshtë (1), që ka në përbërje vetëm një kallëzues (*përcollit*), kemi përfuar një frazë të përbërë (8) duke shtuar foljen *jam dhe lidhëzën që.* Kështu, të krijohet përshtypja sikur fraza (1) është copëzuar në dy pjesë, ku grupi më i madh i fjalaëve (*e përcollit këtë lajm pa shtrëmbërimë*) ndjek lidhëzën *që*, ndërsa njëri nga përbërësit (*njëri prej gazetarëve*) ndjek foljen *jam.* Mund të themi se një grup fjalaësh që formon përbërës, mund të ndjekë foljen *jam*. Mund të provojmë ndërtimje gramatikore. Duke ndërtuar fraza të copëzuara, ne mund të arrimë të provojmë një grup fjalaësh formon apo jo një përbërës. Por lind pyjetja: a është po ashtu e vërtetë e anasjella e këtij pohimi, pra, nëse një grup fjalaësh nuk mund të ndjekë foljen *jam* në një frazë të copëzuar, atëherë nuk formon përbërës? Përgjigjja është negative, sepse edhe nëse një grup fjalaësh nuk është në gjendje të ndjekë foljen *jam* në një frazë të copëzuar, kjo nuk do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një përbërës. Pra, kjo është një provë e mjafueshme, por jo e vëtmja, prandaj duhet t'u referohemi edhe provave të tjera më bindëse.

1.1.2. Mospërfshirja

Dihet se brenda një fraze mund të furen edhe fjalë apo grupe fjalësh të reja, të cilat synojnë të zgjerojnë më tej informacionin që mbart kjo thënie. Aftësia e folësит katë bëjë edhe me sistemimin e këtij materiali të ri që duhet të zëre vend krahas të dhënave që kemi. Vazhdojmë të përdorim frazën (1), por duke e zgjeruar informacionin e saj në lidhje me kohën kur kryhet veprimi, duke shtuar grupin e fjalëve në *fundjavë.* Po ta vërejmë me kujdes, mund të pohojmë se ky grup fjalaësh është një përbërës, sepse, së paku mund ta zhvendosim lirshëm si në fillim (10), ashtu dhe në mes të frazës (11-13):

- (9) *Njëri prej gazetarëve e përcollit këtë lajm pa shtrëmbërimë në fundjavë*

- (10) *Në fundjavë, njëri prej gazetarëve e përcollit këtë lajm pa shtrembërime*
- (11) *Njëri prej gazetarëve e përcollit këtë lajm në fundjavë pa shtrembërime*
- (12) *Njëri prej gazetarëve e përcollit në fundjavë këtë lajm pa shtrembërime*
- (13) *Njëri prej gazetarëve, në fundjavë, e përcollit këtë lajm pa shtrembërime*

Shihet se përbërësi *në fundjavë* zë pozicione të ndryshme në frazë, por gjithnjë në kufi me përbërësit e tjérë, pavarësisht në i ndjek apo i paraprin ato, por asnjëherë nuk futet midis tyre. Një përbërës nuk mund të përfshijë brenda vetes apo të copëzohet nga një përbërës tjetër, se do të përftonim ndërtimje jogramatikore siç në këta shembuj:

- (14) **Njëri në fundjavë prej gazetarëve e përcollit këtë lajm pa shtrembërime*
- (15) **Njëri prej gazetarëve e përcollit këtë në fundjavë lajm pa shtrembërime*
- (16) **Njëri prej gazetarëve e përcollit këtë lajm pa në fundjavë shtrembërime*

Këto ndërtimje jogramatikore na bindin se një përbërës nuk mund të përfshihet brenda një përbërësi tjetër, se kjo do të prishte lidhjen që bashkon këto fjale në një njësi të veprime, prandaj pamundësia e përfshirjes shërbën si provë nëse një grup fjalesh formon apo jo përbërës.

1.1.3. Izolimi

Shpeshherë, gjatë ligjërimit, folësit i nënshtrohen asaj dukurie që quhet ekonomi gjuhësore, e cila ka të bëjë me përqendrimin tek e panjohura, duke përashtuar përsëritjen e së njoherës. Kështu, një grup fjalesh mund të izolohet nga tërësia e frazës dhe të dalë më vete si përgjigje e një pyetjeje, si për shembull: *njëri prej gazetarëve, në fundjavë, pa shtrembërime*. Natyrishët nuk mund të jipim përgjigje duke iu referuar grupeve të tillë, si: *lajm pa, prej gazetarëve etj:*

- (17) *Kush e përcollit këtë lajm pa shtrembërime? [Njëri prej gazetarëve]*

- (18) *Kur e përcollit njëri prej gazetarëve këtë lajm pa shtrembërime?*
Në fundjavë.
- (19) *Si e përcollit njëri prej gazetarëve këtë lajm? Pa shtrembërime.*

Vetia e shkëputjes nga fraza, për të dalë si thënie më vete, natyrishët e mbështetur në kontekstin e njoher të kësaj fraze, u përket vetëm përbërësve. Kjo shërben si një provë e mëtejshme nëse një grup fjalesh formon apo jo përbërës.

1.1.4. Zëvendësimi

Një veti tjetër që e dallon një përbërës nga një grup i çfarëdollojshëm fjalesh, është dhe aftësia e tij përtu imarrë nga një fjale e vetme, zakonisht nga këtikë. Këtu kemi parasysh rimirjen me anë të trajave të shkurtër përemërore të një fjalë apo një grupi fjalesh në funksionin e kundrinxhit:

- (20) *[Njëri prej gazetarëve] e përcollit pa shtrembërime [këtë lajm]*

Përbërësi *këtë lajm* ka funksionin e kundrinxhit të drejtë dhe rimerret, me anë të trajtës së shkurtër përemërore¹. Madje, kjo e fundit është në gjendje ta zëvendësojë praninë e grupit emëror, natyrishë kur kuptimi i saj bëhet i njoher nga konteksti:

- (21) *Ai e përcollit pa shtrembërime*
- Po ashtu, grupin e fjalëve *njëri prej gazetarëve*, mund ta zëvendësojme më një fjalë të vetme, me përemën vtor *ai*. Mundësia e zëvendësimit apo jo të një grupi fjalesh na ndihmon të kuptojmë nëse kemi të bëjmë apo jo me përbërës, por kjo nuk do të thotë se qdo përbërës mund të rimerret apo të zëvendësonet.

1.1.5. Bashkërenditja

Jo çdo grup i rastësishëm fjalesh mund të bashkërenditet me një tjetër, por këtë mund ta realizojnë vetëm ato grupe që formojnë një përbërës të një niveli më të lartë të frazës. Duke iu rikthyer frazës në shqyrtim, shohim se përbërësit e saj mund të bashkërenditen me përbërës mund të që mund t'i shtohen:

¹ Përmirren e kundrinxhitë shih ndër të tjera R. Pernaska (1984).

- (22) a. [Njëri prej gazetarëve] dhe [një dëshmitar] e përcollën këtë lajm pa shtrembërimë
 b. Njëri prej gazetarëve e përcollë këtë lajm [pa shtrembërimë]
 dhe [pa mëdyshe]

Grupet e fjalëve njëri prej gazetarëve dhe një dëshmitar si dhe *pa shtrembërimë* dhe *pa mëdyshe* bashkërenditen mes tyre, prandaj mund të themi se janë përbërës. Nëse do të bënim përpjekjet të bashkërendisnim segmente të rastësishme fjalësh, si: *gazetarëve e përcollën apo lajm pa me grupe të tjera fjalësh*, do të përftonin ndërtimne jogramatikore. Po ashtu, edhe sikur të bashkërenditum dy përbërës që nuk i përkasin të njëjtit lloj, si p.sh. *njëri prej gazetarëve dhe pa shtrembërimë*, nuk mund të kemi një frazë të pranueshme:

- (23) *[Njëri prej gazetarëve] dhe [pa shtrembërimë] e përcollë këtë lajm

Pra, grupet e fjalëve për t'u bashkërenditur nuk mjafton të janë vetëm përbërës, por t'i përkasin, të bashkëndajnë të njëjtat veçori, pra të janë që të dy grupe fjalësh emëtore apo parafajlore etj. Folësi i lindur i një gjuhe, edhe në mos pastë njohuri teorike mbi bazën e të cilave të bëjë dallimin mes këtyre grupe fjalësh, sidoqoftë ka aftësinë e lindur të bashkërendojoj se çdo fjalët në frazë.

1.1.6. Elipsa

Më parë folëm për ekonominë gjuhësore, pra për prijen që ka folësi për të shmangur përsëritjen e informacionit të njohur, pa e gjymtuar komunikimin. Duhet thënë se vetëm përbërësit mund të hiqen, siç mund të vërehet në frazën e mëposhtme:

- (24) Do të doja të dilia në pension, por edhe nuk do të doja të dilia në pension

Edhe pse fraza është gramatikisht e regullt, ajo ndien peshën e redondancës, të teprise. Është mirë që përsëritja e grupit të fjalëve të dilia në pension të shmanget në pjesën e dytë të frazës. Kjo jo vetëm që nuk e gjynton kuptimin e përgjithshëm, por bën që thënia të jetë më lakonike dhe më e pëlgjeshme për bashkëbiseduesit.

- (25) Do të doja të dilia në pension, por edhe nuk do të doja
 Nëse grupi i fjalëve që lëmë jashtë frazës nuk formon përbërës, nrezikojmë të përfitojmë ndërtimne jogramatikore si më poshtë:

- (26) *Do të doja të dilia në pension, por edhe nuk do të doja të dilia
 në Pra, nuk mund të ketë liri të pakufizuar në copëzimin e frazës, por duhen respektuar rrugëllat për njohjen e përbërësve të saj, në mënyrë që reduktimi të bëhet mbi bazën e kësaj njohjeje.

1.1.7. Përbërës dhe dykuptimi

Shpeshherë frazat mund të kenë interpretim të dyfishtë, në varësi të grupimit që u bëjmë fjalëve në përbërës. Po të kemi njohuritë e duhura rrëth kësaj njësie, do të jemi në gjendje të depërtojmë si në strukturën ashtu dhe në anën kuptimore të saj. Të shohim një shembull konkret:

- (27) Agimi e piu verën në shishe
 Kjo frazë është e dykuptimshme, të paktën në variantin e shkruar. Në ligjërim na vjen në ndihmë intonacioni me anë të cilit mund të transmetojmë më lehtësisht informacionin që duam të përcjellim. Kështu, nëse theksi bie mbi grupin e fjalëve *në shishe*, do të thotë se Agimi, në vend të gotës ka preferuar të përdorë shishen për të pirë verën, por nuk mund të pohojmë në e piu të gjithën apo jo. Përkundrazi, nëse theksi bie tek folja *piu*, kjo do të thotë se Agimi piu tërë verën që ishte në shishe, por nuk jemi në gjendje të përcaktojmë mënyrën se si e piu atë, pra në shishe, gotë etj. Në variantin e shkruar, nungesë të intonacionit, mund të na vijnë në ndihmë elemente të tjera si rendi i përbërësve:

- (28) [Në shishe] e piu [verën] Agimi (jo në gotë)

- (29) [Verën në shishe] piu Agimi (jo tjeter)

Në frazën (28) fjalët *në*, *shishe*, *verën* grupohen në dy përbërës *në shishe* dhe *verën*, ndërsa në (29), edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtit fjalë, përfitojmë një përbërës të vetëm, *verën në shishe*, pra vetëm çfarë ka brenda në shishe dhe asgjë tjeter.

1.2. Valenca

1.2.1. Valenca e foljes

Kryesisht folja, por edhe disa fjalë të tjera si p.sh. parafjala, emri, mbiemri, mbartin vëgori të tillë që i lejojnë të përcaktojnë llojet e lidhjeve që ata realizojnë në frazë. Analizojmë një grup foljesh, si:

- (30) a. *vëtëtin*
- b. *fle*
- c. *takoj*
- d. *dhuroj*

Nga analiza vëmë re se ato dallojnë mes tyre veç së tjerash edhe për mënyrën se si i realizojnë lidhjet me fjalët e tjera. Këshu, folja *vëtëtin* mund të shoqërohet me fjalë apo përbërës të ndryshëm, si:

- (31) *Vëtëtin fort/ çdo ditë/ në dimër*
por mund të qëndrojë dhe e vetme e të jetë kuptimi i strukturalisht e qëndrueshme, ndërkohë që folja *fle* ka nevojë ta ketë të përcaktuar kryefjalën (kush *fle*?), sido që mund të shoqërohet nga një varg fjalësh apo përbërësish jo të domosdoshëm për kuptimin dhe strukturën e saj:

(32) *Shpesh, Miri fle /herët/ në divan/ me televizor ndezur/*

Për kuptimin e foljes *fle* vëtëm emri *Miri* është i domosdoshëm, ndërsa përdorimi i fjalëve të tjera është fakultativ, ato mund t'i shthohen e t'i hiqen lidhjet foljes ndryshe nga kryefjala *Miri*.

(33) *Shpesh, *(Fëlli) fle /herët/ në divan/ me televizor ndezur/*

Folja *takoj*, ndryshe nga dy të parat, shtron njëkohësisht dy pyetje (kush takoi? kë takoi?), gjë që do të thotë se kërkon të ketë pranë saj dy fjalë apo grupe fjalësh, si në (34):

- (34) *Ana takoi Ilin*

Në këtë fjalë mund të shthohen edhe grupe të tjera fjalësh, si:

- (35) *Dje pasdite/ Ana takoi Ilin rastësisht/ në rrugë/*
por vëtëm fjalët *Ana* dhe *Ilin* përzgjidhen patjetër nga folja *takoi*; mungesa e tyre tregon mangësi në lidhjet që kërkon të realizojë folja si te (36):

- (36) a. **Ana takoi (kë?)*
- b. **Takoi Ilin (kush?)*

Kuptimi i fjalisë këtu del i cunguar, pasi nuk bëhet e qartë se cili është ai që takoi *Ilin*. Së fundi, le të themi se folja mund të kërkojë pranë vetes edhe tre elemente, si p.sh. folja *dhuroj*, e cila, nëse nuk e shohim të lidhur me një kontekst të caktuar, shtron tri pyetje të domosdoshme (kush? kujt? çfarë dhuron?) si në fjalinë e mëposhtme:

- (37) a. *Ilin i dhuroi një libër Anës*
- b. *i dhuroi një libër Anës (Gfarë?)*
- c. **Ilin i dhuroi Anës (Gfarë?)*
- d. **Ilin i dhuroi një libër (kujt?)*

Kjo nevojë që shprehin foljet për t'u plotësuar kuprimisht dhe strukturalisht me anë të fjalëve apo përbërësve që ato kërkojnë pranë vetes, quhet valencë. Termi valencë u përdor për herë të parë nga L. Tesnière (1959) si një huazim nga fjalori teknik i kimisë.

Duke e metaforizuar lidhjen e atomeve pér krijimin e molekulës (këshu, pér përfitimin e molekulës së ujut H₂O duhet të bashkohen një atom oksigjen me dy atome hidrogjen), ai shihet të njëjtën logjikë në përfitimin e frazave duke u nisur nga ‘valenca’ e foljes, pra nga përzgjedhja që realizon ajo.

Në varësi të nevojave dhe të përzgjedhjes së përbërësve, pra të valencës së tyre, foljet grupohen në katër grupe: zerovalentëshe (32), njëvalentëshe (33), dyvalentëshe (34) dhe trivalentëshe (37). Fjalët apo përbërësit që kërkohen nga folja, në varësi të valencës së saj quhen argumente, ndërsa elementet e tjera, prania e të cilëve është fakultative në frazë quhen adjunktitë, elemente shtesë. Pra, foljet me strukturë argumentore, kërkojnë t'i kenë të shpërhura argumentet e tyre.

1.2.2. Valenca tek fjalët e tjera

Edhe pse shihet më shpesh si veti e foljes, valenca nuk është një vëçori që i përket vëtëm asaj, por edhe fjalëve të tjera, si p.sh. parafjala. Parafjala shfaqet si njëvalentëshe, pasi realizimi i saj nuk mund të kuptohet pa pranimë e një fjalë të tjeter. Kështu, marrim:

- (38) a. *përballi teatrit*
 b. *mbi mal*
 c. *rreth shtëpisë*
 d. **në*

Në këta shembuj vihet re se parafjalët *përballi*, *mbi*, *rreth* janë të plotësuara kuptimisht dhe strukturalisht, ndërkojë që në (38d) parafjala *në* nuk e ka të shprehur valencën e saj, prandaj dhe kemi të bëjmë me një ndërtim të paplotë. Po ashtu, edhe emri ka valencat e veta. Mes emrave *dimër* dhe *rënie* ka një dallim jo të vogël lidhur me vlerën e valencës së tyre. Le të shohim shembujt e imposhtëm:

- (39) a. Edhe në mars bëri *dimër*.
 b. ?*Rënia* bllokoi rrugën

Nga fjalët e mësipërme vihet re që ato dallojnë nga njëra-tjetra lidhur me plotësinë kupimore të tyre. Nëse shprehja në (39a) arrin ta përcjellë mesazhim e folësit, në (39b) nuk ndodh këshu. Kjo ndodh sepse emri *rënia* nuk e ka të shprehur valencën e vet, qka do të thotë se struktura e tij argumentore nuk është e plotë. Kjo plotësohet vetëm në (40a) ku emri njëivalentësh përzgjedh argumentin e vet. Fjalët *zarr*, *gur*, *tërmët*, që mund të shërbejnë si argumente të fjalës *rënie*, dallojnë nga fjalët *i egër*, *i madh*, *i ftohë* që përaktojnë emrin *dimër*. Ky është një emër zerovalentësh, qka do të thotë se nuk ka strukturë argumentore, pra nuk mund të marrë argumente.

- (40) a. Rënia e *zjarrit/e gurëve/e tërmëtit/ bllokoi rrugën
 b. Edhe në mars bëri dimër (*i egëri/madh/i ftohë*)*

Emri mund të jetë edhe dyvalentësh, si në (41), ku fjalët *i gjakut*, *të sëmurëve*, plotësojnë strukturën dyvalentëshe të emrit *dhurimi*.

- (41) Dhurimi i *gjakut* të *sëmurëve* kërkon ndjeshmëri më të lartë Mbremi, po ashtu, mund të ketë strukturë argumentore:

- (42) a. i aftë për punë
 b. i lartë nga shpati
 c. i ardhur nga jashët

Në ndërtimet e mësipërme mund të dallohen mbiemrat njëvalentësh që përzgjedhin fjalët e tyre plotësuese.

2

TEORIA X'

2.0. Struktura e përbërësve

Siq e pamë deri këtu, fraza nuk është një bashkim i çfarëdoshëm fjalësh, por një organizim përbërësish. Vetë fraza nuk është gjë tjetër veçse një përbërës i rendit mië të lartë që përmban brenda vetes përbërës të tjerrë.


Pra, përbërësitet organizohen sipas një strukture ikursive (përsërësitet). Ata kanë një strukturë hierarkike të saktë. Teoria që studion strukturën e përbërësve quhet X' (X-bar) dhe është një teori universale, sepse mund të zbatohet në të gjitha gjithë natyrore. Sipas teorisë X-bar, qđo përbërës është projektimi i një koke.

Koka përfaqësion elementin qendror të përbërësit dhe i jep emrin këtij të fundit. Prandaj, nëse një përbërës ka si kokë një emër, ai do të

emëritohet Sintagmë Emërore ose NP¹; nëse koka është një folje, emëritimi do të jetë Sintagmë Foljore ose VP; kur koka është një mbiemiér, atëherë kemi Sintagmë Mbiemiérre, ose AP; nëse është parafalë, do të quhet Sintagmë Parafjallore ose PP.

Siq kemi thënë, koka e një sintagme është elementi qendor dhe i domosdoshëm për projektimin e kësaj sintagme. Çdo sintagmë ka përvèc kokes një komplement (Comp). Koka dhe komplementi i saj formojnë një përbërës që qëndron një nivel më lart, i cili paraprihet nga tjetër element, specifikuesi (Spec). Koka, komplementi dhe specifikuesi dalin gjithnjë në të njëjtin pozicion: specifikuesi i paraprin përbërësit të formuar nga koka dhe komplementi dhe ky i fundit zë vend pas kokës.


Projektimi i një sintagme bëhet gjithnjë nga poshtë lart. Koka përfaqëson nivelin bazë të projektimit, që shënohet me X° (X zero), variabël që mund të zëvendësohet me një Emër, Folje, Mbiemër a Parafalë. Njësia e formuar nga koka dhe nga komplementi etiketohet si X'. Njësia e formuar nga X' dhe specifikuesi etiketohet X'':



Në këtë skemë hierarkike universale, X (apo X°) është projektimi i nivelit zero, X' është projektimi i nivelit një, X'' është projektimi i nivelit dy, i quajtur ndryshe, projekzioni maksimal.

Projekzioni maksimal është paraqitura e plotë e sintagmës. Paraqitura e mësipërme është forma klasike e skenës X', por rendi në të cilin elementet shfaqen mund të ndryshojë nga një gjuhë në tjetër.

Mundësitet e ndryshme të strukturës në pëmë janë paraqitur në (2):



Teoria X', është në gjendje të përfaqësojë pjesën më të madhe të universaleve të studiuara nga J. Greenberg-u (1966).

Sipas të dhënave të mbledhura nga studimet tipologjike, gjuhët e ndryshme të botës shfrytëzojnë një nga zgjedhjet në (2). P.sh., gjuhët si shqipja, anglishtja, italishtja etj., që kanë kundrini pasfoliore dhe ku komplementi i emrit ndjek emrin, janë gjuhë që zgjedhin parametrin "koka paraprin komplementin", ndërsa gjuhët ku kundrinoi ka pozicion parafojor, si japonishtja dhe koreanishtja janë gjuhë që ndjekin parametrin "koka ndjek komplementin".

Në paragrafet në vijn do ta zëvendësojmë variablin X me secilën prej kokave leksikore: emrin, foljen, mbiemrin dhe parafjalën për të parë se si formohen sintagmat e ndryshme.

2.1. Struktura e sintagmës emërore

Siq e kemi pohuar tashmë, të gjitha llojet e sintagmave strukturohen në të njëjtën mënyrë. Kështu, sintagma emërore mund të analizohet në hulinë e teorisë X'. Le t'i referohemi sintagnës së mëposhtme:

¹ Në këtë punim, shëtimi i sintagmave bëhet mbi bazën e inicialeve të fjaleve përkatëse nga anglishtja. Konkrektisht për sintagmën emërore përdorim simbolin NP (Noun Phrase), për sintagmën foljore VP (Verb Phrase), për sintagmën mbiemiérre AP (Adjective Phrase), për sintagmën parafjallore PP (Preposition Phrase).

Ndërsa një emër i përvëçëm apo një përemër vëtor kanë një strukturë të tillë ku paraqitet vetëm koka N:

(6) N'' (= NP)



N'



N



Arbi/ai

2.2. Struktura e sintagmës foliore


Elementi qendror i sintagmës foliore është folja, për të cilën përdorim etiketën V nga anglishtja *Verb*.

Në brendësi të sintagmës, V përfaqëson kokën apo projekcionin zero. Nga bashkimi i foljes me komplementin formohet projekioni i ndërmjetëm V' dhe nga bashkimi i këtij të fundit me specifikuesin krijuhet projekioni maksimal V'', apo VP. Le t'i referohemi strukturës së mëposhtme:

(7) Djali lexoi librin

Në (7), *lexoi* përfaqëson kokën e sintagmës, apo elementin zero. Emri *librin* paraqet pozicionin e komplementit në sintagnë, ndërsa emri *djali* është specifikuesi. Pra, edhe sintagma foliore ka një strukturë të tillë që mund të paraqitet me anë të teorisë X':

(8)




- (3) Ai perëndim dielli
Kjo sintagmë formohet nga emri *perëndim* që është elementi kryesor i sintagmës, pra koka; nga përemi dëftor *ai* dhe nga komplementi i shprehur me emrin *dielli*.

Duke qenë se po analizojmë një sintagmë emërore, pra të projektuar nga një kokë leksikore emër, në vend të X-it në (1) mund të vendosim simbolin N si shkurtesë e fjalës *Noun*.

Duke iu përbajtur terminologjisë së huazuar nga anglishtja. N së bashku me komplementin e saj formon një projektim të ndërmjetëm N', i cili duke bashkëvepruar me një specifikues formon sintagmën e plotë N'' apo projekcionin maksimal NP.


(4)




I vetmi element i domosdoshëm është koka N.

Komplementi dhe specifikuesi jo gjithnjë janë të shprehur. Për shembull, sintagma emërore *kjo fotografi* formohet vetëm prej kokës dhe specifikuesit dhe mund të paraqitet kështu:


(5)



Nuk është e thënë që komplementin dhe specifikuesin t'i gjejmë gjithnjë të shprehur. Për shembull, foljet jokalimtare (njëivalentëshe) si *fle* etj. nuk marrin kundrinx të drejtë prandaj pozicioni i komplementit (Compl) nuk projektohet:



Foljet pavetore si *bubullin* etj. nuk kanë as pozicionin e specifikuesit dhe as atë të komplementit:




2.3. Struktura e sintagmës parafjalore

Edhe sintagma parafjalore ka tre nivele projektimi, në përshtatje me skemën X'. Ashtu si në ndërtimet e analizuara më lart, parafjala P, që paraqet nivelin zero, mund të bashkohet me një komplement për të formuar nivelin P'.

Projektimi maksimal P' apo PP (Prepositional Phrase) përfshohet nga bashkimi i P' me një specifikues. Le t'i referohemi sintagmës së mëposhtme:

(11) *mu në rrugë*

Parafjala *në* paraqet kokën e sintagmës. Emri *rrugë* shërben si komplement dhe *mu* si specifikues:




2.4. Struktura e sintagmës mbiemërore

Në sintagmën mbiemërore, pa dyshim që mbiemri paraqet elementin kolkë, pra nivelin zero të etiketuar si A nga anglishtja *Adjective*.

Duke u bashkuar me një komplement, projektohet niveli i ndërmjetërm A' i cili nga ana e tij mund të bashkohet me një specifikues për të formuar projekcionin maksimal A'' apo AP si në shembullin (13) struktura e të cilit paraqitet në (14):

(13) *pak i lartë nga shtati*




Siq e kemi përmendur tashmë, fjalët bashkohen së pari në njësi minimale dhe më pas, këto të fundit bashkohen në njësi më të mëdha,

si fjalia etj. Rregulla që zbatohet për bashkimin e tyre është gjithnjë një irregull binare, gjë që do të thotë se nuk mund të kemi më shumë se dy njësi që ndërveprojnë mes tyre.


Këshu shpjegohej edhe lidhja që realizohet mes kokës së sintagmës mbiemërore në (14) me komplementin e saj. Ky i fundit nuk shprehet me një fjalë të vetme, siç pamë rëndom në shembujt e mësipërm, por del si bashkim i fjalëve në një sintagmë parafajlore [nga+shtati] dhe hyn në lidhje me kokën e sintagmës mbiemërore si një njësi e vetme.

Në skemën (14), kemi përdorur shenjën e trekëndëshit për komplementin, me qëllimin për të vënë në dukje se kemi të bëjmë me një sintagmë, e cila natyrisht ka projektimin e vet si më poshtë:



Duke qenë qe kjo sintagmë shërben si komplement i kokës mbiemërore *i lartë*, atëherë lidhjen mes tyre mund ta paraqesim të plotë si në (16):

(16) A'' (= AP)



3.0. Struktura e brendshme e frazës

Le ta shtrijmë analizën tonë nga projektimi i sintagmave të thjeshta, siç pamë më lart, në projektimin e një fraze të tërë. Duke qenë se gjitha ka natyrë rikursive, fraza duhet konceptuar si një terti si projektimesh të skemave X-bar.

Pamë që kjo skemë projektohej dhe emërtohen në varësi të kategorive të ndryshme të cilat shërbejnë si koka të sintagmave, si folore, emërore etj. Vështirësia qëndron në përcaktimin e projeksimit maksimal të frazës.

Duke parë rëndësinë që fiton epitim (fleksioni) në frazë, është arriut në përfundimin se ai është shprehje e projeksimit më të lartë të frazës.

3.1. Fleksioni, kategorri funksionale e frazës

Fleksioni foljor shpreh dy tipa të ndryshëm informacionesh morfosintaksore: atë të kohës së veprimit të shprehur nga kallëzuesi dhe të përshtatjes, pra të lidhjes që realizohet mes kryefjalës dhe kallëzuesit. Këta të fundit përshtatjen gjithnjë mes tyre, çka do të thotë se kanë të njëjtitat tipare të vetës dhe numrit.


Mënyrat e shprehjes së fleksionit janë të ndryshme. Folja mund t'i shprehë kategoritë e saj gramatikore me anë të mbaresave të ndryshme të saj, si: *lexo-j/-va/-nie/-nin*, etj, ose me anë të foljeve ndihmëse: *kam/kemi/do* të *kem lexuar* etj. Fakti që të gjitha këto informacione jepen nëpërmjet fleksionit, përforcion idenë që pikërisht fleksioni është kokë e frazës.

Shënojmë me I (të madhe) ose Infl fleksionin¹, kështu që përsintagmën fleksionale që përfshohet përdorim etiketën IP (*Inflection Phrase*). Fleksioni është projekioni më i lartë i frazës. Le ti referohemi skremës së një fraze të caktuar, e cila na ndihmon të kuptojmë projektimin e kësaj sintagme:


(1) *Ana ka lexuar librin*

(2)

Në (3), kemi të bëjmë me një frazë, fleksioni i së cilës shprehet me anë të formave të ndryshme që merr vëtë folja. Ndryshe nga shembulli (1), ku folja e gjenieruar në pozicionin V° përkonte me pozicionin e saj në sintaksën e shfaqur, në (3) folja *lexoj* gjenerohet si kokë e sintagmës foljore VP, por e lë këtë pozicion për t'u ngritur në të majtë të frazës për të marrë fleksionin. Kështu, në sintaksën e shfaqur, atë e gjemjë në pozicionin kokë të sintagmës fleksionale IP:



Në (4), kemi parë një frazë, që përfshin pozicionin I° apo IP. Siç shihet, edhe struktura e frazës përpunhet me skemën e përgjithshme të teorisë X-bar. Duke qenë se fleksioni i foljes *lexoj* jetet me anë të foljes ndihmëse *ka*, kjo gjenerohet në pozicionin e kokës së sintagmës fleksionale dhe realizon përshtatjen në numër e vetë me emrin *Ana*, që zë pozicionin e specifikuesit të kësaj sintagme.



Skema e paraqitur më lart përbëhet nga koka I° dhe nga komplementi VP. Koka dhe komplementi formojnë nivelin I', i cili mund të bashkohet me një specifikues përfshinët nivelin maksimal I'' apo IP. Siç shihet, edhe struktura e frazës përpunhet me skemën e përgjithshme të teorisë X-bar. Duke qenë se fleksioni i foljes *lexoj* jetet me anë të foljes ndihmëse *ka*, kjo gjenerohet në pozicionin e kokës së sintagmës fleksionale dhe realizon përshtatjen në numër e vetë me emrin *Ana*, që zë pozicionin e specifikuesit të kësaj sintagme.

Kryefjala, para se të zërë pozicionin SpecIP, del filimi i specifikuesit të sintagmës foljore VP (siç kemi parë në 2.2). Ajo zhvendoset në SpecIP si rezultat i zhvendosjes sintaksore, ashtu siç ilustrohet me anë të shigjetës në skemën (2).

Folja ndihmëse është rrijë nga mënyrat e shprehjes së fleksionit, por folja mund ta realizojë atë edhe me anë të formave të ndryshme sintetike, siç u theksua më lart. Le ti referohemi një fraze të tillë:

(3) *Ana lexonte librin*

Në (3), kemi të bëjmë me një frazë, fleksioni i së cilës shprehet me anë të formave të ndryshme që merr vëtë folja. Ndryshe nga shembulli (1), ku folja e gjenieruar në pozicionin V° përkonte me pozicionin e saj në sintaksën e shfaqur, në (3) folja *lexoj* gjenerohet si kokë e sintagmës foljore VP, por e lë këtë pozicion për t'u ngritur në të majtë të frazës për të marrë fleksionin. Kështu, në sintaksën e shfaqur, atë e gjemjë në pozicionin kokë të sintagmës fleksionale IP.

¹ Duke iu përbajtur terminologjisë së huazuar nga anglishtja kemi përdorur termin e shkurtuar I (nga *Inflection*) me anë të cilët shënohet fleksioni, optimi.


3.2. Kohë (*Tense*) e Përshtatje (*Agreement*)

Fleksoni është pozicioni në të cilin kontrollohen si tiparet e kohës, ashtu dhe ato të përshtatjes së foljes.

Duke u nisur që nga propozimi i Pollock-ut (1989), tiparet e kohës u dalluan nga ato të përshtatjes, kështu që në strukturën e Fleksionit u shquan dy pozicione të ndryshme, **T(ense)** e **Agr(eement)**. *Tense* është koka më e ulët dhe aty realizohen tiparet e kohës, ndërsa *Agr* është koka më e lartë dhe aty realizohen tiparet e përshtatjes me kryefjalën.

Tense e *Agr* janë koka funksionale që projektojnë secila sintagmat përkatëse TP dhe AgrP: koka *Agr⁰* merr si komplement të saj TP, ndërsa koka T merr si komplement një sintagmë follore VP.

Koka leksikore gjenerohet si kokë V dhe më pas ngjitet në pozicionin kokë T për të marrë tiparet e kohës, duke vijuar të ngjitet sërisht drejt kokës Agr për të marrë tiparet e përshtatjes². Struktura e plotë e një sintagme IP është si më poshtë:




3.3. Realizimi i kryefjalës

Siq është thënë më lart, kryefjala gjenerohet në brendësi të sintagmës foliore VP, konkretisht në pozicionin e specifikuesit. Këtu folja i shënon asaj rolin tematik. Por, që të realizohet kontrolli i tipareve nëpërmjet fleksionit foljor, në një moment të caktuar të derivimit, ajo duhet të ngrihet në pozicionin e specifikuesit të IP/AgrP. Gjithësi si shqipja apo italishtja mund të mos e kenë të shprehur kryefjalën:

- (6) *lexova librin*

Në (6) kryefjala nuk është e shprehur, pra nuk është shprehur fonologjikisht, prandaj kemi të bëjmë me një kryefjalë zero. Simbolikisht, kjo kryefjalë e pashprehur shënohet me pro (nga *pronoun*) dhe lexohet “pro e vogël”. *Pro* zë pozicionin e specifikuesit të IP/AgrP në ato raste kur kryefjala nuk shprehet fonologjikisht:



Simboli *pro* te (7) përfaqëson një kryefjalë që fonetikisht është bosh, pra e përealizuar, por sidqotë me vlerë sintaksore. Ai është argument i foljes dhe krijon lidhje përshtatjeje me fleksionin. Nevoja e shtimit të një *pro*-je në strukturë rrijedh nga *Parimi i projektimit të zgjeruar* (angl. *Extended Projection Principle*) propozuar nga Chomsky (1986):

² AgrP përputhet me IP.

(8) *Parimi i projektimit të zgjernar*

Të gjitha fjalë duhet të kenë një kryefjalë, edhe nëse ajo nuk realizohet fonologjikisht.

Thënë ndryshe, parimi i shprehur në (8) thekson se pozicioni kryefjalë i një fjalie ne folje të shfjelluar është gjithnjë i pranishëm, edhe nëse kryefjala nuk shprehet. Përveç *pro-së së vogël*, pozicioni i kryefjalës në një fjal mund të zihet edhe nga ndonjë element tjeter bosh, *pro plotësuese* (it. *pro espletivo*³), që ka të bëjë me një kryefjalë bosh që nuk ka referues, nuk është argument i foljes, por shërben vëgse për të mbushur pozicionin strukturor të kryefjalës. Ajo realizohet në ato raste kur pozicionit të kryefjalës i mungon rolin tematik. Shembuj me *pro plotësuese* janë kryefjalët bosh të sjella në frazat e mëposhtme (9):

- (9) a. *qëlloi që mbreti vdiq*
- b. *bubullin*

Në (9a) folja *qëlloi* i shënon rolin tematik të gjithë frazës *që mbreti vdiq*, dhe vetëm kësaj, ndërsa në (9b) folja *bubullin* nuk shënon asnjë rolin tematik. Sipas *Extended Projection Principle*, në pozicionin strukturor të kryefjalës së këtyre foljeve gjëjmë përemirin plotësues, bosh. Kjo *pro plotësuese* realizohet edhe në ato raste kur kryefjala e fjalisë gjendet në pozicion pastfoljor si në (10):

- (10) *erdhì pranvera*

Është e dukshme që në (10) sintagma emërore *pranvera* nuk është ngritur në pozicionin e *Specifikuesit* të sintagnës fleksionale InfIP, por ndodhet në një pozicion më poshtë, brenda sintagnës foliore VP. Duke qenë se *Parimi i projektimit të zgjernar* kërkon që pozicioni strukturor i kryefjalës, pra SpecIP, të jetë i mbushur, atëherë ky kusht përbushet duke shuar brenda kësaj strukturre një *pro plotësuese*.

Kryefjala *pranvera* dne *pro-ja* plotësuese NP krijojnë një zinxhir ku *pro* është mbartës i rasës emërore, që i shënonet nga fleksioni Infl, ndërsa emri është mbartës i rolit tematik të shënuar nga folja.

3.4. Komplementuesi, kategori funksionale e frazës

Një kategori që luan rol mjaft të rëndësishëm në organizimin e frazës është dhe komplementuesi. Në këtë kategori bëjnë pjesë elemente të tilla si: *se*, *që*, *nëse* etj, të cilat shërbejnë për t'i paraprirë një fjalie të varur e cila luan rolin e një komplementi të fjalisë kryesore brenda një fraze të caktuar, p.sh.: *Tha se do kthehej shpejt apo U kthyesh që të na përshtendesë*.


Ashtr si fleksioni, edhe komplementuesi projekton një sintagnë, e cila do të quhet sintagnë komplementuese dhe shkurtimishët do të shënohet CP (*Complementizer Phrase*).

Pozicioni kokë C⁰ i kësaj sintagnë është ai i komplementuesit, ndërsa si komplement i saj shërben një sintagnë fleksionale IP/AgIP. Për të parë konkretisht vëgoritë që paraqesin këto ndërtimë, le t'i rikthehem i një fraze si më poshtë:

- (11) a. *Tha se do kthehej shpejt*
- b. *U kthyesh që të na përshtendesë*

Fraza (11a) (të njëjtat karakteristika me të paraqet dhe dhe 11b.) përbëhet nga dy fjalë *tha* dhe *do kthehej shpejt*, të cilat e realizojnë lidhjen mes tyre me anë të komplementuesit *se*. Ky i fundit projekton një sintagnë e cila merr si komplement të saj fjalinë e varur:

- (12)



³ Termi në italisht *espletivo* (angl. *expletive*) vjen nga latinishja *explere* që do të thotë 'mbush'/ 'plotësoj'. Nga këndëj trijed dhe emërtimi në italisht *pro espletivo* (që në shqip e përkthejmë *pro plotësuese*), për të dhënë funksionin që përbush elementi *pro* në strukturën e frazës në rastet e sipërpërmendura.

Në (12), është paraqitur me anë të një diagrame struktura e frazave (10a-b).

Vëmë re se sintagmati fleksionale që ndodhen në të majtë të skemës *do kthej shpejtë na përshtendeste janë projektuar si komplemente të sintagmës komplementuese. Në pozicionin kokë të kësaj të fundit janë projektuar komplementuesit *se/që*. Ky pozicion është një pikë e rëndësishme e strukturës së frazës, pasi realizon lidhjen mes fjalive përbërëse të saj.*

Komplementuesi ka edhe forma të tjera shprehëse, por në kuadrin e këtij teksti e shohim të mjaftueshme të ndalojmë në këtë pikë të realizimit të tij.

4

ROLET TEMATIKE, ARGUMENTET, ADJUNKTËT

4.0. Hyrje

Kur folëm për valencën në paragrafin 1.3, përmendëm shkurtimi i nticione të reja si argumentet dhe adjunktët. Në këtë pjesë të tekstit do të shohim realizimin konkret të tyre në frazë, si dhe dallimin që vjen nga lidhjet e realizuara prej tyre me foljen.

4.1. Argumentet e brendshme dhe të jashtme

Termi argument, siç shkruan A. Radford-i (1997), është huazuar nga filozofia për të përshtkuar funksionin e shprehjeve të ndryshme në strukturën semantike të frazës.

Le t'i referohemi shembullit të mëposhtëm ku jepet kombinimi i foljes *dëgjoj* me dy argumente:

(1) *Ana dëgjon muzikë*

Fjalët *Ana* dhe *muzikë* janë argumente të foljes dyvalentëshe *dëgjoj*, të cilëve folja u shënon rolet e saj tematike.

Kështu, në (1) folja *dëgjoj* i shënon rolin tematik të *Vepruessit kryefjalës Ana*, ndërsa kundrinorit *muzikë* i shënohet roli i *Temës*.

Roli tematik që folja i shënon sintagmës e cila shërben si komplement i foljes, quhet rol tematik i brendshëm dhe argumenti që vishet me këtë rol quhet argument i brendshëm. Pra, folja *dëgjoj* i shënon rolin tematik të brendshëm argumentit *muzikë*.

Roli që i shënohet kryefjalës, quhet rol tematik i *jashtëm* dne argumenti që e merr atë, quhet argument i *jashtëm*.

Termat i *brendshëmi jashtëm* kanë të bëjnë me faktin që argumenti i brendshëm ndodhet brenda sintagmës foljore VP, ndërsa argumenti i *jashtëm* zë një pozicion në periferinë e majtë të kësaj sintagme.

Roli tematik i kryefjalës nuk shënohet vetëm nga folja, por nga bashkimi i saj me argumentin e brendshëm, pra sintagma follore *dëgjon muzikë* i shënon rolin tematik argumentit të *jashtëm Ana*.

Për të parë dallimin mes dy argumenteve dhe rolin që luan argumenti i brendshëm ndaj atij të *jashtëmit*, le të shohim shembujt e mëposhtëm:

- (2) a. *Ana theu xhamin / gotën¹*
b. *Ana theu qafën¹*

Roli i argumentit të *jashtëm Ana* në (2) ndryshon në varësi të kuptimit që argumenti i brendshëm *xhamin/gotën* dhe *qafën* u jep përkatesisht sintagmave follore: *theu xhamin/gotën, theu qafën*.

Në rastin e parë, argumenti *Ana* është vepru (veprimi bie mbi *xhamin/gotën*), në të dytin pësues (veprimi bie mbi vështirën). Duhet kujtuar se kryefjalës i shënohet roli tematik kur kjo ndodhet brenda sintagmës VP, pra përparrë lëvizjes sintaksore drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës fiksionale SpecIP.


4.2. Foljet ditranxitive

Krahas ndërtimeve ku folja i shënon rolin tematik vetëm një argumenti të brendshëm, meritojnë të trajtohen edhe ndërtime me dy argumente të brendshme të tillë, si në (3):

- (3) *Ana i dha librin Agimit²*

Në frazën (3), folja *dha* u shënon rolin tematik dy argumenteve të brendshme, kundrinorit të drejtë, i cili në gramatikën gjenerative emërtohet *temë* (angl. *theme*) dhe kundrinorit të zhdrojtë, që emërtohet *qëllim* (angl. *goal*). Struktura e saj mund të paraqitet si më poshtë:

(4)




Argumentet e brendshme janë gjeneruar në një pozicion poshtë foljes. Duke iu referuar skemës së mësپerme, mund të themi se folja *dha* i ka shënuar së pari rolin tematik temës *librin* e më pas e gjithë sintagna është bashkuar me argumentin *Agimit*.


Duke qenë pjesë e sintagmës foljore, elementi *Agimit* shtohet brenda kësaj sintagme në një pozicion më poshtë foljes dhe komplementit të saj. Rrijedhimisht, struktura VP rikompozohet sërisht.

Për ndërtime të tillë Larson (1988) propozon që struktura e sintagmës foljore të shënohet poshtë ndërtimeve ditranxitive si në (5):

¹ Me kuptimin u rrëzua apo u largua.
² Për vendin e kilitikëve në frazë shih kap.VII.



Në këtë skemë kemi dy sintagma IP, ku koka e së parës është folja *dha*, ndërsa pozicioni kokë i së dytës është bosh. Folja *dha* duhet të realizojë lidhjen me argumentin e jashtëm *Ana*, prandaj ajo lë pozicionin fillestar për t'u ngritur në pozicionin kokë të sintagmës foliore, nga ku ishënon rolin tematik specifikuesit të kësaj sintagme si në (6):




(*në bibliotekë dhe në mëngjes*). Lidhur me rolin e tyre në frazë, vëmëre që kundrino i drejtë *Tanin* është i domosdoshëm përfoljen, pranuk mund të hiqet, sic dëshmohet në ndërtimin jogramatikor (8a) ndërsa prania e dy sintagmave parafallore është fakultative, pasi ato jepin një informacion shthesë jo të domosdoshëm përfundimtina dherë kuptimin e frazës, nuk janë valencia të foljes, pra mund të mos jenë të shprehura:

- (8) a. **Beni takoi në bibliotekë në mëngjes*
 b. *Beni takoi Tanin*
 c. *Beni takoi Tanin në bibliotekë*
 d. *Beni takoi Tanin në mëngjes*

Elementet e domosdoshme në frazë i kemi quajtur argumente, ndërsa ato fakultativë quhen adjunktitë. Adjunktet zënë pozicione të ndryshme në skemën që paraqet strukturën e frazës.

Le t'i rikthehem i ndërtimit (7). Në sintagmën follore bëjnë pjesë folja *takoi* dhe komplementi i saj *Tanin*. Bashkimi i kokës V me komplementin formon projekcionin e ndërmjetëm V'.

Përbërësit *në bibliotekë* dhe *në mëngjes* i shthohen më vonë formantit të foljes dhe komplementit të saj duke qenë se janë pjesë e kësaj sintagme follore. Struktura VP ka disa shtrresa në varësi të përbërësve të shthuar. Superpërbërësit janë projektimi të foljes prandaj shënohen me etiketten V' meqë i shthohen nivelit të ndërmjetëm. Struktura (7) paraqitet e tillë si:



4.3. Adjunktët

Mes sintagmave të ndryshme që mund të formojnë një frazë, disa prej tyre janë të domosdoshme e të tjera fakultative. Le t'i referohemi shembullit të mëposhtëm:

- (7) *Beni takoi Tanin në bibliotekë në mëngjes*

Kjo frazë përbëhet nga një sintagmë follore (*takoi Tanin*), një sintagmë sintazmë emërore (*Beni*) dhe nga dy sintagma parafallore

Ndërkohë që adjunktët mund të shfaqen, të shtohen apo të hiqen lirshëm nga fraza, numri i argumenteve është i përcaktuar qartë dhe nuk mund të shtohen apo të mënjanohen pa kriter, siç ilustrohet në shembujt e mëposhtëm:

- (10) a. *Beni takoi Tanin*
- b. **Beni, djali takoi Tanin*
- c. **Beni takoi Tanin, djalin*
- d. *Beni takoi *(Tanin) në bibliotekë, në mëngjes*


Ndërtimet jogramatikore (10b) dhe (10d) dëshmojnë se në strukturën e sintagmës follore ka një pozicion të përcaktuar qartë për secilin argument dhe se, në ndryshim nga adjunktët, ata nuk mund të shtohen apo të përsëriten.

Nga ana tjetër, ndërtimi (10d) provon domosdoshmërinë e shprehjes së argumentit të brendshëm që plotëson foljen. Mungesa e tij bën që fraza të jetë jogramatikore, pavarësisht shprehjes së dy adjunktkëve nëpërmjet sintagmave parafjalore përkatëse.

Të gjitha sintagmat mund të kenë adjunktë. Le të shohim një sintagmë emëtore si më poshtë:

- (11) *ai perëndim dielli mbi mal*

Kjo sintagmë përbën edhe elemente të tjera vegë kokës *perëndim*, komplementit *dielli* dhe specifikuesit *ai*. Për shtimin e adjunktit *mbi mal* është e nevojshme të shtohet nyja e ndërmjetme N', siç dëshmohet në (12):



Siq e kemi përmendur në kreun e parë (1.2), zanafilla e bashkimit të fjalëve në sintagma e më pas i këtyre të fundit në fjalë fillon me zbatimin e një rregullë të thjeshtë që Chomsky (1995, 1999) e quan *Merge*: shkrirja në një njësi të vetme e dy a më shumë elementeve të përzgjedhura nga leksiku.

Për shembull, nëse ne përzgjedhim dy a më shumë elemente leksikore si *Beni* dhe *fle*, nëpërmjet veprimit *Merge*, ndërtojmë sintagmën e mëposhtme (1):

- (1) [Beni *fle*]

Një veprim tjetër që na ndihmon të ndërtojmë sintagma dhe fjalë është regula *Move* (lëviz). Në të vërtetë, nëpërmjet lëvizjes mund të krijojmë struktura me përbërës tashmë të pranishëm në frazë. Kështu, në (2) emri që ndodhet në krye të fjalisë, gjendet në këtë pozicion falë lëvizjes që ka pësuar nga pozicioni i tij fillestar në fund të fajisë:

(2) *librin, Beni e lexi*

Siq e dinë, emri *librin* funksionon si kundrino i drejtë lidhur me foljen *lexoj* dhe pozicioni i tij fillestar është një pozicion argumentor në brendësi të sintagmës follore VP. Fakti që ai del në krye të frazës, do të thotë se është zhvendosur drejt një pozicioni më të lartë, për të cilin do të flasim në kreun vijues.

Pas zbatimit të rregullave *Shkri* (*Merge*) e *Lëviz* (*Move*), falë të cilave krijohen strukturat sintaksore, derivimi i përcillet përbërësit Fonetik dhe atij Logjik.

Kjo pikë e derivimit emërtohet nga Chomsky (1993) si *Spell-Out*, pra si momenti në të cilin sintagma apo fjalia shqiptohen; pas fazës *Spell-Out* nuk është më i mundshëm asnjë veprim i rregullës *Merge*, pra nuk mund të ketë më bashkim fjalësh apo sintagmash.

Nga ana tjetër, para veprimit *Spell-Out* element mund të zhvendosen në brendësi të frazës dhe, në këtë rast, kemi të bëjmë me lëvizje të dukshme, si në shembullin (2), por ata mund të lëvizin vetëm në Formën Logjike dhe për këtë arsy e përftojmë një lëvizje të padukshme, apo abstrakte.

Çdo lëvizje që kryhet krijon një lidhje të caktuar mes dy pozicioneve: pozicioni bazë në të cilin një element i caktuar është vënë aty falë veprimit të *Merge*, dhe ai i mbërritet, pra pozicioni në të cilin shfaqet.

Duke iu rikthyer shembullit (2), vëmë re se pozicioni bazë i emrit *librin* është ai i komplementit të fjosjes, brenda sintagmës follore VP, ndërsa pozicioni i mbërritet është ai i specifikuesit të sintagmës komplementuese CP. Mes dy pozicioneve krijohet një *zinxhir* që na lejon ta shohim këtë emër si kundrino të drejtë të foljes.

Ka forma të ndryshme për paraqitjen e kësaj lidhjeje mes pozicionit bazë dhe atij të mbërritet. Pozicioni bazë i një elementi çfarëdo mund

të shënohet me një *t* (nga angl. *trace* "gjurmë"), qëka do të thotë se zhvendosja e tij lë një gjurmë të dukshme në këtë pozicion. Po ashtu, ai ka të njëjtin tregues (*i*) që shënohet përbri përbërësit të zhvendosur, pikërisht për të treguar se ky përbërës dhe gjurma e lënë prej tij bashkëndajnë të njëjtin referues, pra formojnë një *zinxhir* të pandashëm.

(3) *librin; Beni e lexi* *t* *dje*

Të dy elementet që formojnë këtë zingjir bashkëndajnë të njëjtin dhe të vërtmin rol tematik, i cili shënohet në pozicionin argumentor apo tematik, pra në pozicionin bazë.

Një mënyrë tjetër për paraqitjen e kësaj lidhjeje mes pozicionit fillestar dhe atij të mbërritetës është veprimi *kopjo* dhe *fshij*. Me këtë kuptojmë krijimin e një kopjeje identike të përbërës që zhvendoset për të zënë vend në pozicionin e mbërritetës, qëka pasohet me fshirjen e kopjes në pozicionin fillestar:

(4) *librin, Beni e lexi* *librin* *dje*

Në shembullin (4), vëmë re se një kopje e emrit *librin* ka zënë vend në krye të fjalisë e më pas është fshirë realizimi i saj në pozicionin fillestar.

Në këtë tekst është preferuar pikërisht përdorimi i kësaj të dytës, pra paraqitja e strukturave të ngjashme me (4) do të jepet nëpërmjet kopjeve të fshira.

5.1. Kufizime mbi lëvizjen e përbërësve në frazë

Lëvizja e përbërësve në fiali nuk është e liuë, qëka do të thotë se jo gjithçka mund të lëvizë kudo pa rregulla dhe pa kufizime. Ka një sërë parimesh universale që e kontrollojnë këtë lëvizje:

A - Një element nuk mund të zhvendoset drejt një pozicioni tashmë të zënë prej një elementi tjetër i cili ka mbërritur aty si pasoje e zhvendosjes. Pra, nëse një pozicion është i zënë, aty nuk ka vend për ndonjë element tjetër, përvèç rasteve kur ai zhvendoset për t'u

trupëzuar me ndonjë tipar që ndodhet në këtë pozicion të mbërritjes. Këtu mund të përmendim rastin e një foljeje që ngrihet për t'u bashkuar me fleksionin e saj në një pozicion më të lartë, ku ndodhen morfemat foljore.

B - Sipas Parimit të Ruajtjes së Strukturës (Emonds 1976), një element i llojit X° , pra një kokë mund të zhvendoset vetëm në një pozicion të të njëjtët lloj, pra në një pozicion kokë, ndërsa një sintagmë mund të zhvendoset vetëm në një pozicion specifikuesi, pra në një pozicion që mund të pranojë një projekcion maksimal XP.

C - Zhvendosja e përbërësve bëhet gjithnjë nga e djathta në të majtë, apo thënë ndryshe, nga poshtë lart. Pra, një element mund të zhvendoset drejt një pozicioni më të lartë, por nuk mund të ndodhë të zbresë në një pozicion më poshtë skemës së fjalisë.

D - Cdo element që zhvendoset, duhet të zëre pozicionin më të afërt për të. Ky kusht njihet si kushti i *Lokalitetit ose si Minimal Link Condition* (Chomsky 1986). Sipas këtij parimi, lëvizja duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur dhe e justifikueshme.

Një element e ka të nevojishme të lëvizë, nëse duhet kryer kontrolli i tipareve. Për shembull, folja zhvendoset nga pozicioni V drejt atij Infl për të realizuar kontrollin e tipareve të kohës, vetës dhe të numrit që ndodhen në këtë pozicion, ndërsa kryefala e një fjalie e merr rolin tematik nga folja brenda sintagmës foliore VP e më pas zhvendoset në pozicionin e specifikuesit të sintagmës fleksionale InflP për të kontrolluar rasën emërore nëpërmjet kokës fleksionale.

Këto veprime me bazë kontrollin e tipareve ndodhin ose në konfigurime të llojit kokë-kokë, si në rastin e zhvendosjes së foljes V drejt fleksionit I ose në konfigurime të llojit kokë-Specifikues si në rastin e fleksionit foljor në I^o dhe të kryefjalës në SpecIP.

5.2. Llojet e ndryshme të lëvizjes

Siqështë thënë më lart, mund të kemi zhvendosje të një koke X^o apo të një projekzioni maksimal XP. Lëvizja nga koka drejt një koke tjeter

është dy llojesh. E para, e quajtur Shthesë, realizohet në ato raste kur një kategori, p.sh. V, zhvendoset për t'u bashkuar me një kategori tjeter, për shembull Infl, për t'u trupëzuar aty me morfemat foljore. Në këtë rast thuhet se folja V u shtohet elementeve që ndodhen në pozicionin Infl.

Lloji i dytë i lëvizjes që emërohet me termin Zëvendësim, ka si objekt të saj një kategori që zhvendoset për të zënë një pozicion bosh. Për shembull, në frazat pyetëse (siç do të shohim në kreun vijues), folja V lëviz drejt pozicionit C^o, i cili është bosh.

Edhe lëvizja e projekzioneve maksimale është dy llojesh, Lëvizje A (Argumentore) dhe Lëvizje A' (lexohet "A-bar", që do të thotë joargumentore).

Në rastin e parë, një sintagmë emërore zhvendoset nga pozicioni ku i shënohet roli tematik, drejt një pozicioni tjeter ku i shënohet rasa.

Shembulli më i mirë është ai i një kryefjale që zhvendoset në fjalë nga pozicioni i specifikuesit të sintagmës foliore SpecVP drejt atij të sintagmës fleksionale SpecIP.

Lëvizja A' është lëvizja e një sintagme emërore nga një pozicion ku ka marië rolin tematik dhe rasën, drejt ndonjë pozicioni tjeter. Për këtë rast, mund të sjellim shembullin e emrit *librin* apo përemrit *kë* në ndërtimet e mëposhtme:

- (5) a. *librin, leroi Beni*
b. *kë takoi Beni?*

Si emri *librin*, ashtu dhe përemri *kë* e kanë marrë rolin tematik përkatës dhe rasën para se të zhvendoseshin drejt një pozicioni më të lartë në frazë, që në rastin konkret është SpecCP. Pikërisht këtu kemi të bëjmë me një lëvizje të tipit nga pozicioni A drejt një pozicioni A'. Duhet mbajtur parasysh se rregullat e lëvizjes zbatohen gjatë derivimit të strukturave njëkohësisht me procesin e formimit të përbërësve si një cikël që mund të përsëritet e ripërsëritet.

Sipas këtij këndvështrimi minimalist, Chomsky heq dorë nga kundërvënia e hershme strukturë e thellë-strukturë sipërfaqësore, sipas së cilës zbatimi i disa rregullave transformacionale mbi strukturën e thellë prodhon strukturën sipërfaqësore.

Kështu, nëse do t'u referoheshim ndërtimeve vepore dhe joveprore, nuk do të kërkonim në to strukturën bazë, mbi të cilën përfshohet një strukturë e dytë, por do të duhet të shpjetonim rregullat e ndryshme që çojnë në përfshimin e tyre. Në fjalë e mëposhtme:

- (6) a. Tregtarët tritën çmimet
- b. Çmimet u ritën nga tregtarët


duhen analizuar hapat që çojnë në përfshimin e njëpasnjëshëm të përbërësve si dhe zhvendosjen e tyre brenda secilës fjalë.

6

STRUKTURA E BRENDSHME E SINTAGMËS EMËRORE DHE MBIEMËRORE

6.0. Sintagma determinante

Në kreun e dytë u paraqit një analizë e shkurtër e sintagmës emërore, koka e së cilës është emri. Emri së bashku me komplementin e tij formon projektimin e ndërmjetëm N', i cili duke bashkëvepruar me një specifikues, formon projksionin maksimal NP.



Struktura e paraqitur në (1) nuk mund t'u përgjigjet të gjitha kombinimeve që emri mund të realizojë me elemente të tjera si: nyja, përemra dëftorë, kuantifikatorë, mbiemra. Le të shohim sintagmën:

(2) *Këta është libra*

Nëse dëftori zë pozicionin e specifikuesit të sintagmës emëtore NP dhe emri *libra* zë pozicionin e kokës N°, struktura në (1) nuk ka vend të mjaftueshëm për përfshirjen e numërorisë *dy*. Po i njëjtë problem shtronhet edhe për gjuhë si italishtja kur sintagma emëtore ka në përbëjen e saj një përemrë pronor:


(3) *il mio libro* 'libri im'

Nëse do të përdornim një skemë si në (1), nuk do të kishte vend brenda saj për pronorin.

Duke u nisur nga të dhënët e anglishtes, Abney (1987) propozon që projekcionin maksimal i emrit NP të merret si komplement i kokës D (determinant).

Sipas autorit, është kategoria D° me anë të së cilës shprehet Shquarsia e emrit, qëka do të thotë që determinanti e përcakton atë. Kështu, emri del si komplement i determinantit. Determinanti projektion një sintagmë determinante DP¹ sipas teorisë X':

(4)



Në këtë skemë, koka D° merr si komplement projekcionin maksimal të emrit (NP). Në pozicionin kokë N° është gjeneruar emri. Gjithashtu në pozicionin kokë të sintagmës determinante gjenerohet determinant.


¹ Ky emërtim zë fill nga korresponduesja në anglisht *Determiner Phrase* (DP)

6.1. Analizë e sintagmës determinante

Para se të trajtojmë strukturën e sintagmës emëtore, duhet të mbajmë parasysh se në klasën e determinantëve bëjnë pjesë elemente të tillë si dhe të pacaktuar, nyja e pëparme dhe e prapme e fjales: *djal-i, vajz-a, mik-u* etj.

Sipas këndvështrimit gjenerativist, këto tri klasa që gramatika tradicionale i dallon nga njëra-tjetra kanë një tipar të përbashkët mjaft të rëndësishëm që i bashkon mes tyre, tiparin emëror [+N]. Për shkak të kësaj karakteristike që ato shfaqin, përfshihen në një klasë të vetme dhe emërtohen determinantë, që simbolikisht shënohen me shkrirjen D. Duke ndjekur analizën e propozuar nga Abney (1987), mund t'u referohemi shembujve të shqipes dhe të dallojmë determinantë që mund t'i paraprijnë emrit, si përemra dëftore (*ky/ko*), përemra të pacaktuar si *çdo/disă*, dhe nyja e pëparme *një*, nga determinantë që mund t'i prapavendosen emrit, si nyjat e shquara. Një sintagmë emëtore që ka në përbëjen e saj një përemrë dëftor, si *ky libér*, do të ketë një strukturë si më poshtë:

(5)




Siq mund të vihet re, projekioni më i lartë i emrit është pozicioni i komplementit të sintagmës determinante. Emri është gjeneruar në pozicionin kokë të sintagmës emëtore, në N° dhe determinanti në pozicionin kokë të sintagmës determinante D°. Pozicioni i tyre ruhet edhe në sintaksën e shfaqur, pasi, si emri ashtu është datuar

mund të qëndrojnë më vete. Ndryshe nga përemrat dëftorë, nyja e shquar në gjuhën shqipe i prapavendoset emrit:

- (6) a. *libr-i*
b. *këng-a*

Lidhja që vendoset mes këtij determinanti dhe emrit, shpeshherë, shfaq një parametër të veçantë për sa i përket pozicionit që ata zënë brenda strukturës së sintagmës determinante.

Pavarësisht shfaqjes së këtij parametri, nuk mund të mohohet fakti se kemi të bëjmë sërisht me një sintagmë determinante, por me dallimin e vetëm që emri, në sintaksën e shfaqur, nuk gjendet më në pozicionin e tij filletar, por në pozicionin e kokës së sintagmës determinante, ku është ngritisur për t'u vënë në të djathë të determinantit. Le t'i referohemi skemës së mëposhtme:




Longobardi (1992) e zgjeroi dhe argumentoi më tej këtë çështje, duke nënshnuar domosdoshmérinë e ngritjes së emrit drejt pozicionit të determinantit, për shkak të tipareve të përbashkëta që bashkëndajnë këto dy kategorit.

Si emri, ashtu dhe determinanti mbartin tipare referenciale (+ref), për këtë arsyё atë duhet të zënë pozicione pranë njëri-tjetrit. Kur emri nuk zhvendoset haptas drejt pozicionit D, sidoqoftë e realizon atë në mënyrë abstrakte. Pra, pozicioni D është i nevojshtëm për shquarsinë e emrit. Edhe në ato raste kur emri del i pashoqëruar nga determinanti, si në shembullin (8):

- (8) a. *lexoj gazeta*
b. *ha domate*

sidoqoftë, projektohen një sintagmë DP. Bëhet fjalë për një sintagmë DP me determinant zero, pra me një determinant të pranishëm në strukturën sintaksore, por që nuk realizohet fonologjikisht:



6.2. Sintagma kuantifikatore QP

Në skemën (7) është paraqitur struktura e sintagmave determinante *libri* dhe *këng-a*. Siç vijhet re nga diagrami, në pozicionin e kokës së sintagmës emërore janë gjenieruar emrat *liber* dhe *këng-e*, ndërsa në pozicionin e kokës së sintagmës determinante, përkatësisht determinantët *i* dhe *a*. Duke qenë se në shqipë determinanti trupëzohet me fjalën, emri lë pozicionin e tij filestar dhe ngrihet në D°, në të djathë të determinantit.

Në ato gjuhjë ku determinanti trupëzohet me fjalën, emrat i nënshtronen një rregullë sipas së cilës atë duhet të zhvendosen nga pozicioni baze (N°) ku gjenerohen për tu ngjitur në pozicionin D° ku është gjenieruar determinanti, në mënyrë që të bashkohen me të.


- (10) a. *ca libra/cà çanta*
b. *pak libras/pak çanta*

Kuantifikatori, ashtu si determinanti, projekton një sintagmë me pozicionin kokë Q°. Si komplement i saj mund të shërbëjë dhe një emërçfarëdo. Le t'i referohemi sintagma kuantifikatore QP:

Një klasë e re që meriton të trajtohet gjatë kësaj analize është dhe ajo e kuantifikatorëve. Disa nga elementet që bëjnë pjesë në këtë klasë janë përemrat e pacaktuar si *ca*, *disa*, *çdo*, *shumë*, *pak*, si dhe numërorë të ndryshëm që dallohen nga përcaktorët e tjera, sepse nuk përshtaten me emrat që shoqërojnë:


Të shohim një sintagmë hjetër, ku kuantifikatori i paraprin determinantit:

- (14) *gjithë këta libra*




Në (11) është paraqitur skema x-bar e sintagnës kuantifikatore. Koka e kësaj sintagme është kuantifikatori *çapak*, ndërsa komplementi i saj është sintagma emërore *libra/çanta*. Pozicioni i kuantifikatorit dhe determinantit në frazë është i ndryshëm në varësi të llojit të determinantit. Nëse determinanti i paraprin emrit, kuantifikatori zë një pozicion më të ulët në frazë, përkundrazi, nëse determinanti i pasnjitet emrit, atëherë kuantifikatori ndodhet në një pozicion më të lartë se i pari. P.sh., në (12) kuantifikatori *dy* ndjek determinantin:

- (12) *këta dy libra*



Në (13) jepet skema e sintagnës determinante *këta dy libra*. Secila prej fjalëve që e përbën atë, projekton një sintagmë më vete, përkatësisht një sintagmë emërore e cila është komplement i sintagnës kuantifikatore, që projektohet nga kuantifikatori *dy* si komplement i sintagnës determinante, e cila përbën dhe projekzionin më të lartë të kësaj skeme, pra determinanti zë një vend më të lartë se kuantifikatori.

- (15) *gjithë këta libra*



Në (15), kuantifikatori *gjithë* zë një pozicion më të lartë. Si komplement i saj shërben sintagma determinante, në pozicionin kokë të së cilës është gjenuerar determinanti *këta*, kurse emri *libra* është në pozicionin më të ulët të kësaj diagrame.

6.3. Lidhja e dy a më shumë elementeve përcaktuuese

Shqipja e ka të mundshme të kombinojë disa elemente përcaktuuese brenda sintagnës emërore. Këshu, është e mundur të lidhet një déftor me një emër të shquar, si në shembullin (16a) apo një déftor dhe një kuantifikator me një emër të shquar si në (16b).

- (16) a. *ky djali im*
b. *këto dy çantar (këtu/e mia)*

Lidhja e një emri të shquar (pra, të një emri që e ka të trupëzuar kategorinë D) me elemente të tjera përcaktuuese si p.sh. déftoret, nuk realizohet krejt lirisht dhe natyrshëm. Le të bëjmë një krahasim në shembullin gramatikor në (17a) me atë jogramatikor në (17b):


- (17) a. *Ishite një mbret. Ai mbreti kishte një vajzë*
b. **Ai mbreti kishte një vajzë*
c. *Ai mbret kishte një vajzë*

Kundërshtia mes (17a) e (17b) dëshmon se lindhja e një dëftori me një emër të shquar është e mundshme vetëm në kontekste të tilla si temë-koment nëpërmjet të cilës paraqitet një situatë në të cilën, pasi jepet tema (*një mbret*), folësi ndërtion një koment rreth saj (*kishte një vajzë*). Në mënyrë të vegantë, dëftori e përforcon rolin e përbërësit të përzgjedhur si temë. Është përf t'u vënë re se mes dëftorisit dhe emrit të shquar nuk ka asnjë lloj lidhjeje varësie: fshirja e çdonjërit prej dy përbërësve nuk e cenon gramatikalitetin e frazës:


- (18) a. *Ishte një mbret. Ai kishte një vajzë*
 b. *Ishte një mbret. Mbreti kishte një vajzë*

Struktura të tilla si ato në (16) e (17) shtrojnë qështjen e pozicionit që zë dëftori në to. Sigurisht nuk mund të jetë pozicioni D° sepse në këtë pozicion vendoset emri *djal/mbrer-* përf t'u trupëzuar me nyjen shquese -i (*diali/mbreti*). Prandaj është e udhës të mendojmë që dëftori zë një vend tjeter, natyrish më lart se ai i emrit.

Këta shembuj na sugjerojnë se, në sintagmën emërore, ka një pozicion më të lartë që do ta emërojimë D_O (*operator*) e që, siç do ta shohim, del në lloje të ndryshme sintagmash emërore të shqipes. Kështu, ndërtimi në (16a) ka këtë strukturë të paraqitur në vijim²:




çanta ngritet përf t'u trupëzuar me nyjen, një pozicion Q° ku përfshihet kuantifikatori/numërori *dy* dhe një pozicion akoma më të lartë D_O, ku zë vend dëftori *këto*:



6.4. Emra të paranyjëzuar

Emrat e paranyjëzuar në gjithë shqipe përbëjnë një klasë relativistë të gjierë fjalësh. Në trajtën e shquar këta emra, përvëç mbaresë-nyjës, paraprihen nga një element që në traditën gramatikore të shqipes është bërë zakon të quhet "nyje e pëparme".

Le të marrim si shembull emrin *e ardhme*, trajta e shquar *e ardhme* e të cilit, siç vihet re, trupëzohet me nyjen e gjinisë femërore *-ja* dhe, në të njëjtën kohë, paraprihet nga elementi *e*. Ç'strukturë të brendshme kanë këta emra? Nëse supozojmë se, si në rastet e tjera, emri *ardhme* trupëzohet me nyjen duke u zhvendosur në pozicionin D°, nyja që i paraprin duhet të jetë në një pozicion më të lartë. Ekzistencë e një kategorie D_O, sic në shembujt paraardhës, e zgjidh edhe problemin e emrave të tillë si *e ardhme*, përf t'u analizohet një fazë të mëvonshme:



Në këtë strukturë të përbërë, emri zhvendoset nga pozicioni i tij i originës N° drejt atij D° përf t'u trupëzuar me nyjen shquese, ndërsa dëftori zë pozicionin kohë të sintagmës D_O. Më e ndërikuar paraqitet struktura e sintagmës (16b) pasi ajo përfshin në vetyvet pozicionin N° në të cilin gjenerohet emri, një pozicion D° ku emri

² Këtu nuk do të trajtohet pronorin *-im*, pasi do të analizohet një fazë të mëvonshme.

Po të njëjtin strukturë kanë emrat e farefisnisë si *i biri*, *i ati*, *e ëma*, *e mbesa*, të paraprirë nga një nyje e vetës së trete njëjës; dhe të shquar nga një nyje e trupëzuar me të.

Edhe këta emra i shohim të zhvendosen nga pozicioni më i ulët N° drejt atij D°, në mënyrë që të realizohet trupëzimi i njës shquese, ndërsa nyja që i paraprin fjalës zë vend në pozicionin DPop.

6.5. Lidhja mes dy emrave

Le të ndalojmë tanë tek ato ndërtime që kanë në përbërje të tyre dy emra. Në gjithën shqipe mund të realizohen dy sintagma të ndryshme emërore, njëra e tipit emër + emër në rasën gjinore të shquar, kurse e dyta emër i pasquar + emër në rrijedhore të pasquar. E para sillet në ndërtimin (22) ndërsa e dyta në (23):

(22) *portreti i Benit*

(23) *shtëpi guri*

Në (22) kemi një strukturë ku të dy emrat janë të shquar, pra janë të trupëzuar me nyjen. Përveç kësaj, emri *Benit* paraprihet nga një element që s'mund të shihet veçse si nyje, pasi ajo përshtatet në gjini dhe numër me emrin që paraprin:


(24) a. *portreti i Benit*

b. *çanta e Benit*

Ç'vend zë nyja që i paraprin emrit *Benit* në një kohë kur pozicionin D° të këtij emri e zë po ky emri *Ben*, i cili ngrihet për t'u bashkuar me njënyen shquese që mbart shenjuesin e rasës gjinore? Për t'i bërë vend kësaj nyje, është e nevojshme t'i rikthehemi sërisht pozicionit DPop të sipërpërmendur.

Mbetet për t'u përcaktuar struktura e kësaj sintagme nën dritën e Teorisë X'.


Së pari, duhet vërejitur se në strukturën (22) dy sintagmën *i Benit* si komplement i kokës *portreti*. Struktura e plotë mund të analizohet si më poshtë:



Të ndalojmë te ndërtimi *shtëpi guri*, i sjellë në shembullin (23). Ky ndërtim dallon në sintagma *portreti i Benit*, e analizuar më sipër në katër pikë. Në *shtëpi guri*, emri i parë mund të paraprihet nga të gjitha elementet përcaktuuese, por nuk mund të marrë një nyje shquese (26a); emri i dytë është në rasën rrijedhore e jo në gjinore (26b); emri i dytë është gjithnjë në rasën rrijedhore, në trajtën e pashquar (26c); emri i dytë nuk mund të shoqërohet nga ndonjë determinant (26d):

- (26) a. *një/kolajo shtëpi guri* vs. **shtëpia guri*
 b. *shtëpi guri* vs. **shtëpi e gurit*
 c. *shtëpi guri* vs. **shtëpi gurit*
 d. *shtëpi guri* vs. **shtëpi një/këtij guri*


Kuptohet lehtë se sintagma *shtëpi guri* ka strukturë të ndryshme nga sintagma *portreti i Benit*. Fakti që emri në rrijedhore s'mund të paraprihet nga asnjë determinant mund të interpretohet si mungesë e plotë e pozicionit D brenda kësaj strukture. Pra, ka vetëm një kokë D ku zë vend determinanti që shoqëron emrin e parë, kurse i dyti është një projektim NP:



Kjo strukturë shpjeton pamundësinë e kombinimit të sintagmës me emër në rrijdhore me ndonjë nga determinantë e mundshëm: në mungesë të pozicionit D° , nuk ka vend për përfshirjen e tij, për rrijdhojë ky emër mund të dalë vërtëm në trajtën e pasquar.

Mbetet për t'u shqyrtuar se përsë emri i parë mund të shoqërohet nga déiforët apo kuantifikatorët (*një/kjo/ajo shëpi guri*), ndërkohë që nuk mund të marrë një nyje shquese (**shëpia guri*).

E vetmja përgjigje e mundshme për këtë pyetje është se në nivelin e fundit të paraqites, të dy sintagmat formojnë një lloj emri të përbërë dhe kjo e pengon emrin e parë të shkëputet për t'u zhvendosur drejt pozicionit D° :




6.6. Sintagma mbiemërore

Mbiemri është një element që modifikon emrin brenda sintagmës DP. Për shembull, në strukturën *libër interesant*, mbiemri *interesant* jep një informacion shtesë lidhur me emrin *libër*. Mbiemi mund të modifikohet po ashtu nga elemente të tilla, si *shumë*, *pak etj.*:


(29) *një libër shumë/pak interesant*

Edhe sintagma mbiemërore mund të paraqitet në termat e Teorisë X, pra me anë të një diagrame që është e njëjtë me ato të sintagmave të tjera, çka do të thotë se ka një kokë, një komplement dhe një specifikues.

Le të marrim një sintagmë të tillë, si *shumë krenar për Benin*. Mbiemri *crenar* është koka e një sintagme mbiemërore AP, specifikues i së cilës mban modifikuesin *shumë*, ndërsa në pozicionin e komplementit zë vend sintagma parafajlore *për Benin*:




Duke qenë se shqipja ka dy klasa mbiemrash, i panyjshëm-i nyjshëm, analiza e strukturës së brendshme të këtyre ndërtimeve merr rëndësi të veçantë. Sintagmat mbiemërore që kanë si kokë një mbiemër të panyjshëm paraqesin një strukturë të brendshme më të thjeshtë (31):




Ndryshe paraqitet struktura e brendshme e mbiemrave të nyjshëm, si p.sh. *i bukur*, të cilët shoqërohen nga një nyje dhe kërkijnë një pozicion të veçantë për nyjën në brendësi të sintagmës mbiemërore.

Hipoteza më e pranueshme është ajo sipas së cilës kjo nyje gjenerohet në një pozicion D° , prandaj projekzioni maksimal i këtyre mbiemrave nuk është ai i një sintagme AP, por i një sintagme determinante mbiemërore, DP_{Adj} (= *Adjectival DP*).



Edhe mbiemri i nyjshëm ka të njëjtën strukturë të analizueshme sipas skemës së Teorisë X'. Pra, mund të kombinohet me një specifikues

dhe një komplement, si në shembullin e sintagmës *shumë i ri në moshi* siç paraqitet në shembullin e mëposhtëm (33):




Në të njëjtën holl vijon edhe analiza e numërotohive trije shkronjorë si *i parë*, *i dytë*, etj., të cilët kanë të njëjtën strukturë të brendshme si mbiemrat e nyshëm, struktura e të cilëve është paraqitur në (32). Të ndalojmë te vendi që zë një sintagmë mbiemrore në brendësi të sintagmës emërore dhe te lidhja që realizon emri me mbiemrin. Siç vihet re nga shembujt, në gjuhën shqipe mbiemi del gjithnjë në pozicion pas emrit:

- (34) a. *ky libër interesant* vs. **ky interesant libër*
 b. *libri interesant* vs. **interesant libri*


Shtrohet pyetja se si gjenerohet mbiemi brenda sintagmës emërore. Nga studimet e shumta tretë kësaj çështjeje, dy mbeten analizat më të bindshme.

Sipas së parës, mbiemrat zënë një pozicion si specifikues të sintagmës emërore NP, brenda asaj determinante DP. Po të ndiqnim këtë analizë, do të përftonim strukturën e mëposhtme:




Siç vihet re në skemë, mbiemi, mbiemi, në strukturën bazë i paraprin emrit, pasi pozicioni i tij original është ai i specifikuesit të sintagmës emërore

NP. Por, kur emri ngjitet në pozicionin D° për t'u trupëzuar me nyjen përfshohet rendi linear N + A, tipik për shqipen. Kjo strukturë nuk e zgjidh problemin që shttron ndëstimi *ky libër interesant*, pasi, nëse pozicioni D° zihet nga determinanti *ky*, emri *libër* është i detyruar të mbetet në pozicionin e tij filletar, duke dhënë këtë ndërtim jogramatikor:



Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, brenda sintagmës emërore mund të përfshijmë një kategorji funksionale, të markuar me ndonjë tipar përshtatteje, që i jep mundësi emrit ta kapërcëjë mbiemrin duke u hedhur në një pozicion më lart se ky i fundit. Hipoteza e pranisë së një kategorji funksionale të ndërmjetme mes DP e NP është pranuar nga shumë studime për gjithë të ndryshme.


Kjo kategorji e përshtatjes (AGReement Phrase) do të shërbente për të kontrolluar tipare të ndryshme, si ato të gjinisë dhe numrit. Pra, nëse ajo është e pranishme në strukturën DP, atëherë emri e lë pozicionin e tij original N° për t'u zhvendosur drejt pozicionit të kategorisë funksionale të përshtatjes në mënyrë që të bashkohet me tiparet e gjinisë dhe të numrit:



Krahas kësaj, ka edhe një hipotezë të dytë që lidhet me pozicionin original të mbiemrave brenda sintagmës DP, sipas së cilës mbiemrat projektojnë një kategoritë vjetën funksionale diku në një pikë të ndërmjetme mes DP ed NP.

Pra, nuk kemi të bëjmë më me specifikes të sintagmës emërore NP, por koka që kanë një projekzion të tyrin funksional (AP), struktura e së cilës ndjek parimet e Teorisë X'.


Një hipotezë e tillë, e zbatuar për shqipen, do të jepte skemën (38):




Sidoqoftë, edhe kjo strukturë është e pamjaftueshme dhe nuk u përgjigjet ndërtimeve të tillë si ky *liber interesant*, pasi, nëse pozicioni D° është i zënë nga dëfitorri *ky*, emri nuk mund të zhvendoset në një pozicion më të lartë se mbiemri, prandaj struktura përfundimtare do të ishte një strukturë grammatikore **ky interesant liber*.

Është e qartë se çfarëdo lloj teorje që të zgjidhet për strukturën e pozicionin e mbiemrave, mbetet gjithnjë në vëmendje problemi i përbysjes së rendit N + A dhe kjo mund të realizohet vetëm duke propozuar një kategoritë re funksionale krahas asaj emërore dhe determinante.


Me pak fjalë, për të analizuar lidhjen e një emri me një mbiemër kemi nevojë për një strukturë emërore më të artikuluar, që përfshin së pakunjë projekzion funksional të përshtatjes. Kështu, për shqipen mund të propozohet një kategori AGrP në të cilën emri zhvendoset për të kontrolluar tiparet e veta.



Nëse pranojmë se struktura DP e shqipes është ajo e paraqitur në (39), atëherë sintagma ky *liber interessant* do të paraqitej si më poshtë:



E ngjashme me të do të jetë struktura e sintagmës ky *djalë i bukur apo djali i bukur*. Në rastin e parë do të kishim një skemë si në (41):




Sidoqoftë, edhe kjo strukturë është e pamjaftueshme dhe nuk u përgjigjet ndërtimeve të tillë si ky *bukur djalë* në vëmendje problemi i pozicionit më të lartë se mbiemri, prandaj struktura përfundimtare do të ishte një strukturë grammatikore **i bukur djalë*.

Është e qartë se çfarëdo lloj teorje që të zgjidhet për strukturën e pozicionin e mbiemrave, mbetet gjithnjë në vëmendje problemi i përbysjes së rendit N + A dhe kjo mund të realizohet vetëm duke propozuar një kategoritë re funksionale krahas asaj emërore dhe determinante.

Me pak fjalë, për të analizuар lidhjen e një emri me një mbiemër kemi nevojë për një strukturë emërore më të artikuluar, që përfshin së pakunjë projekzion funksional të përshtatjes. Kështu, për shqipen mund të propozohet një kategori AGrP në të cilën emri zhvendoset për të kontrolluar tiparet e veta.

Ndryshe ndodh me ndërtimin *djali i bukur*, në të cilin emri ngrihet në pozicionin D° të DP-së për t'u trupëzuar me nyjën.



6.6.1. Mbiemrat që u paraprijnë emrat e

Edhe pse shqipja ka një rend linear neutral emër-mbiemër, megjithatë mund të ndeshen disa raste në këtë gjuhë ku mbiemri i paraprin emrit.


Këtë e dëshmojnë dhe ndërtimet e mëposhtme:

- i vetmi djalië*
- e zeza natë*

Ndërtimë të tillë kanë një efekt stilistikor të vegantë. Duke qenë se Chomsky-i parashtron idenë se çdo tipar duhet të kontrollohet nga një element që mbart të njëjtin tipar, vijmë në përfundimin që tipari Fokus, që karakterizon strukturën të tillë, të kontrollohet në brendësi të një projekzioni FocusP (*Focus Phrase*), në një pozicion më të lartë se DP. Mbiemri ngrihet në pozicionin e specifikuesit të këtij projektimi FocP nga ku bashkohet me nyjën që ndodhet në pozicionin Foc°.

Pasi ndodh bashkimi i nyjës me mbiemrin, nuk ka më arsyë që emri të zhvendoset dhe prandaj mbetet brenda sintagmës NP:

(44)



Edhe numërorët reshtorë mund t'i paraprijnë emrit, si te (45):


(45) *i pari vrapiues*

Një strukturë e tillë do të ketë të njëjtën paraqitje si ajo në (44). Së fundi, në pozicionin paraemëror mund të gjeljmë edhe disa numërorë të paraprirë nga nyja si në shembullin (46):

(46) *të dy burrat*

Numërori *dy* i shprehur në trajtjen *të dy* sillet si një mbiemër i nyjshëm, pra, ka të njëjtën strukturë ashtu si dhe mbiemri *i bukur*, i cili paraqitet në skemën (32).

(47)



Në këtë ndërtim, shohim ngritjen e emrit *burra* drejt pozicionit D° për t'u bashkuar me nyjën e shquar. Numërori i nyjëzuar, që gjenerohet në pozicionin AP më të ulët apo në një pozicion QP, zhvendoset dhe zë vendin e specifikuesit të sintagmës DP:

6.7. Pronorët

Së fundi, le të marrim në shqyrtim ndërtime me përemra pronorë. Veçoria e parë që bie në sy është se këta përemra kombinoohen vetëm me emra të shquar, pra me emra që trupëzohen me nyjnë e shquar:

- (48) a. *libri im*
- b. *nyjë libër im
- c. *nyjë im libër


Një vëgori e dytë që lidhet me këto struktura ka të bëjë me mundësinë e lidhjes ose jo të tyre me nyjë. Për shembull, në numrin njëjës format e thjeshta të vetës së parë dhe të dytë *im* e *yt*, dhe të shumësит *ynë* e *juaj* u kundërvihen formave të nyishme të vetës së tretë njëjës *i tij* e *i saj* dhe shumës *i tyre*.

Po ashtu, të nyjishme dalin trajtat e vetës së parë, të dytë e të tretë *e mi*, *e tu*, *e tij*, *e saj*, *e tyre*. Ndërsa shumësiti i vetës së parë e të dytë dalin pa nyjë: *tanë* e *tuaj*. Si të gjithë mbiemrat, edhe përemrat pronorë, zakonisht, zënë vend pas emrit:


- (49) *libri im* vs. **im libri*

Lidhur me strukturën e tyre të brendshme, vihet re se në gjuhën shqipe pronorët sllen përafërsisht si mbiemrat. Kështu, përemrat pronorë të nyjshëm për nga ndërtimi janë të njëjtë me mbiemrat e nyjshëm, khs. *i tij* dhe *i bukur*; po ashtu, pronorët e panyjshëm mund të krahasohen me mbiemrat e panyjshëm, khs. *im* dhe *interesant*.

Nisur nga kjo gjashmëri strukturore, pronorëve mund t'u shënojmë të njëjtën strukturë të brendshme të mbiemrave cilësorë. Kështu, struktura e pronorëve të nyjshëm mund të paraqitet si në shembulin e mposhtëm (50):³




Për pronorët që dalin pa nyjë, struktura e tyre do të paraqitet kështu:



Në ato raste kur i shohim të lidhur me emrin, vlejnë të njëjtit nregulla si për mbiemin (ref. (42)). Pronorët, sidoqoftë, shfaqin disa tipare të veçanta lidhur me paradigmën e tyre kur lidhen me emrat e farefisnisë. Disa prej këtyre emrave e lelojnjë përemrin të zëre vend si pas, ashtu dhe para emrit. Sidoqoftë, sintaksa e këtyre dy strukturave paraqitet e ndryshme. Në ato raste kur përemri pronor zë vendin e zakonshëm, pas emrit, emri i farefisnisë shoqërohet nga nyja shquese:

- (52) *biri im* vs. **bir im*

Në këto ndërtime, emri duhet të zhvendoset drejt pozicionit D°:




³ Për sintagmën e pronorëve përdorim simbolin PossP (Possessive Phrase).

Kur përemi i paraprin emrit të farefisnisë, emri s'mund të dalë i shquar:

- (54) *im bir* vs. **im biri*

Fakti që emri nuk mund të shoqërohet me nyjën shquese, lë të kuptohet se mund të jetë pronori ai që zë pozicionin D°, duke e penguar këshutu nyjën shquese të gjenerohet aty, si dhe emrin të zhvendoset diku më lart periferisë së kësaj strukturë:



Të dhënët e shqipes dëshmojnë se kjo është e mundshme vetëm me pronorët e vetës së parë e të dytë njëjës:

- (56) a. *im bir*
 b. *yt bir*
 c. **i tij bir/ynë bir/juaj bir/tanë bij /tuaj bij/i tyre bir*

Sigurisht, kjo ka të bëjë me përcaktueshmërinë e referentit. Siç dihet, gjatë ligjërimit veta e parë i korrespondon folësit, ndërsa e dyta dëgjuesit. Kur pronorët e vetës së parë e të dytë njëjës kombinohen me emrat e farefisnisë, kanë vetinë t'u shënojnë referentin këtyre të fundit, që do të thotë se lidhja e një pronori të vetës së parë e të dytë njëjës me një emër farefisnie shénon një individ dhe jo një argument të hapur që kërkon të plotësohet, të ngopet nga një kategori D. Në të vërtëtë, përenrri pronor i vetës së parë dhe të dytë në pozicionin D° është i mjaffueshëm për të legjitimuar një interpretim referencial, duke e penguar kështu emrin të marri nyjë. Ndryshtë ndodh me pronorët shumës, të cilët kanë si referentë, përvèç folësit dhe dëgjuesit, edhe të tjera, kështu që nuk janë në gjendje të legjitimojnë një interpretim të përcaktuar, që ua bëjn atyre të pamundur zhvendosjen në pozicionin D°.

KLITIKËT: ANALIZË E STRUKTURAVE KU SHFAQEN ATA

7.0. Klitikët, vendi dhe roli tyre në frazë

Në kuadrin e gramatikës gjenerative, një ndër çështjet kryesore lidhur me studimin e klitikëve ka qenë përcaktimi i vendit, pozicionit të gjenerimit të tyre në frazë. A përpunhet ai me vendin që klitikët zëne në sintaksën e shfaqur, apo ky pozicion përfshihet nga zhvendosjet në frazë? Le të referohemi shembullit të mëposhtëm:

- (1) *Ai e përshtëndet Anën*
 Folja përshtëndet është një folje dyvalentëshe e cila u shënon rolet tematike argumentit të brendshëm *Anën* dhe atij të jashtëm *ai*. Në sintaksën e shfaqur vëmë re se para foljes ndodhet trajta e shkurtër,

thënë ndryshe klitiku *e*, me anë të të cilit rimerret kundrinoi i drejtë.
Duke parë lidhjet që folja realizon me fjalët, lind pyetja:

– Në ç'raport është ajo me trajtën e shkurtër *e*?
– Nga e merr rolin tematik kjo e fundit dhe cili është pozicioni i saj argumentor?

7.1. Zhvendosja e klitikëve në frazë

Në lidhje me pozicionin e klitikëve në frazë ka dy linja të ndryshme mendimi. Sipas Kayne-it (1975), klitikët dalin së pari në një pozicion pastfoljor, si argumente të fojës e më pas zhvendosen në pozicionin e tyre sipërfaqësor ku i gjëjmë në sintaksën e shfaqur.


Pra klitikalizimi, apo rimarrja e kundrines, nuk shpjegohet veçse me rregullën e lëvizjes (*Move*). Kayne arrin në këtë përfundim duke analizuar të dhënat që i ofron gjyha frëngje. Rimarrja e kundrines së drejtë dhe të zhdrjetë në këtë gjuhë realizohet vetëm në mungesë të shprehjes së tyre në frazë, ndryshe nga shumë gjuhë të tjera si shqipja, spanjishtja etj. Le t'u referohemi shembuje të mëposhtëm:

- (2) a. *Marie voit Jean*
Maria pa Zhanin
- b. *Marie le voit*
Maria e pa
- c. **Marie le voit Jean*
Maria e pa Zhanin
- d. **Jean lui a donné des bonbons à Marie*
Zhani i dha bonbone Marisë

Pra, sipas Kayne-it, sintagma emërore dhe klitiku janë në marrëdhënie përmendarjeje plotësuese: kështu, në (1a) del vetëm sintagma emërore *Jean*, kurse në (1b) del vetëm klitiku *le*. Kayne-i e mbështet analizën e tij në një sërë argumentesh, një ndër të cilat është pikërisht përndarja plotësuese mes klitikëve dhe fjalëve të lidhura. Pra, të dy këto elemente janë argumente të brendshme të foljes, prandaj edhe e përjashtojnë njëri-tjetrin siç u pa në shembujt e mësipërm. Sa kohë që kjo rregull respektohet, kemi ndërtimë gramatikore, por, nëse shkelet

si në (1c-d), ku del si klitiku ashtu dhe sintagma emërore, atëherë përfshohen ndërtimë gramatikore.

Pamundësia e përdorimit të dy elementeve njëkohësisht (argumentit DP dhe klitikut që e rimerr atë) pra, përndarja e tyre plotësuese lidhur me foljen përbën bazën ku mbështetet analiza e zhvendosjes. Sipas propozimit të Kayne-it, zhvendosja e klitikut në rastin e shembullit (2b) do të paraqitej si më poshtë:



Sipas kësaj skemë, klitiku *e* lind si komplement i vetëm i foljes dhe më pas zhvendoset në të majtë të sintagmës fleksionale IP si adjunkt i saj në pozicionin *Cl°*.

7.2. Klitikët dhe pozicioni i tyre argumentor në frazë

Analiza e propozuar nga Kayne-i ka njohur kundërshtime të shumta në studimet pasuese sidomos për vështirësinë që haset për të pranuar adjunktet në të majtë të periferisë së frazës. Po ashtu, një sëri studimesh na kujtojnë se kjo dukuri nuk është një universale gjuhësore, pasi në shumë gjuhë të tjera këto dy elemente mund të shfaqen njëkohësisht në frazë.

Duke qenë se, ndryshe nga të dhënat që na ofron gjyha frëngje, në gjyħe si shqipja, spanjishtja etj, ku normalisht dalin si sintagma emërore me funksion kundrinoj, ashtu dhe trajta e shkurtër që e rimerr atë (4a-b), lind pyetja: C'mekanizma veprojnë dhe si bijnë të mundur që, si klitiku, ashtu dhe sintagma emërore e rimarrë prej tij të kenë të rrijjetin rol tematik dhe të njëjtën rasë?

- (4) a. *E pashë Zhanin*
- b. *Lo vio a Juan*

Kështu në ndëritmet në (4), si sintagma emërore *Zhanin/Juan*, askutu dhe klitiku *e/lo*, në secilën prej gjuhëve nga janë marrë shembujt, kanë të njëjën rasë, atë kallëzore, dhe ndajnë të njëtin rol tematik. Fojja *shoh* është dyvalentëshe (*kush shoh? kë shëh?*). Kush ia shënon rolin tematik klitikut? Kujtojmë që sipas Kriterit Tematik (Chomsky 1981):

- çdo argumenti i duhet caktuar një dhe vetëm një rol tematik.*
- çdo rol tematik i duhet caktuar vetëm një argumenti.*

Ndryshe nga Kayne-i, një sërë studuesish të tjere, si Rivas (1977), Borer (1981), Joeggli (1982) etj., mendojnë se nuk ka zhvendosje të klitikëve në frazë, pasi ata janë gjeneruar në atë pozicion që dalin në sintaksën e shfaqur.



7.3. Sintagma Klitike

Në gjuhën shqipe, ashtu si dhe gjuhë të tjera, klitikët mund të dalin edhe në pozicionin pasfoljor. Kjo ndodh kryesisht në format follore të mënyrës urdhërore, ku klitikët dalin të trupëzuar me to:

- merre librin*
- merre*

Në ato raste kur klitikët gjenerohen në pozicionin kokë të sintagmës klitike CIP, ata mund të trupëzohen me foljen, vetëm nëse kjo e fundit ngrihet në pozicionin e kokës C°.

Kështu, struktura e këtyre ndërtimeve do të kishte këtë paraqitje skematike:



Siq shihet, kundrinosi *Zhanin* lind si argument i foljes *shoh*, kurse klitiku lind në pozicionin kokë të sintagmës CIP.

7.4. Proklizë, enklizë, endoklizë

Pozicioni parafoljor i klitikut, siç e pamë në (5), ndryshe quhet proklizë. Përvèç proklizës, të dhënat e shqipes na ofrojnë edhe pozicionin parafoljor të klitikut, enklizën, dhe vendojjen e tij në mes të foljes endoklizën.

Le t'i analizojmë këto raste për të parë pozicionin që zë klitiku në ndërtimë të tillë, duke u mbështetur në analizën e propozuar nga Sportiche-i.

7.4.1. Klitikët në pozicion pasfoljor

Në gjuhën shqipe, ashtu si dhe gjuhë të tjera, klitikët mund të dalin edhe në pozicionin pasfoljor. Kjo ndodh kryesisht në format follore të mënyrës urdhërore, ku klitikët dalin të trupëzuar me to:

- merre librin*
- merre*

Në ato raste kur klitikët gjenerohen në pozicionin kokë të sintagmës klitike CIP, ata mund të trupëzohen me foljen, vetëm nëse kjo e fundit ngrihet në pozicionin e kokës C°.


Kështu, struktura e këtyre ndërtimeve do të kishte këtë paraqitje skematike:

7.4.2. Klittkët në mes të foljes

Kur folja në urdhëore del në vetën e dytë shumës, atëherë klittkët zënë vend në mes të trupit të foljes:

- (7) a. *merreni librin*
b. *merreni*

Edhe në këtë rast folja lëviz duke i lënë tiparet fleksionale poshtë, në pozicionin Infl, ndërkohë që zë vend si kokë e sintagmës komplementuese C^o, siç dëshmohet në skemën e mëposhtme:



FJALIA PYETËSE

8.0. Hyrje

Duke ecur në hulinë e një klasifikimi të bërë traditë tashmë, brenda grupit të fjalive pyetëse do të dallojmë pyetëset WH¹ e pyetëset PO/JO. Të parat janë ato lloje fjalish pyetësse për ndërtimin e të cilave bashkëveprorinë elemente pyetëse të tipit *kush*, *gjfarë*, *cli*, *kur*, *ku*, *pse*, *si*, siç ilustrohen në shembujt e mëposhtëm:

- (1) a. *kë ka takuar Beni?*
b. *kur do ti niset Beni?*

Ndërsa në grupin e dytë (pyetëse *po/jo*) bëjnë pjesë ato fjali pyetëse, të cilat kërkojnë përgjigjen *po ose jo* dhe formohen ose vëtin nëpërmjet intonacionit të zërit, si në (2a), ose me pjesëzën pyetëse *a si në* (2b):

¹ Pyetëset WH janë ai lloji fjalish pyetëse që kanë në përbërjen e tyre elemente pyetëse të Illojt KUSH, KË, GJARË, KU, dhe emrirohen këshnu nisur nga shkronjat e para të fjalëve pyetëse në anglishtë: *Who* (kush), *What* (gjfarë), *Where* (ku), *When* (kur).

- (2) a. *të pëlqen vjeshtë?*
b. *a punove dje?*

Duke qenë se këto dy lloje fjalish pyetëse shfaqin tipare të ndryshme për nga pikëpamja strukturore, do t'i analizojmë veçmas, duke sjellë për secilën prej tyre një paraqitje të detajuar strukturore.

8.1. Pyetëset WH

Frazat pyetëse të tipit WH me përemrat pyetës KUSH/CLL/ÇFARË kanë një strukturë të veçantë, pasi elementi pyetës i tyre del gjithnjë në krye, ndërsa kryefjala, që normalisht e zë vetë këtë pozicion, shiyhet në fund të fjalisë:

- (3) *çfarë lexoi Beni?*

Elementi pyetës *çfarë* i frazës (3) gjenerohet brenda sintagmës follore, ku merr rolin tematik dhe rasën kallëzore nga folja *lexoj*. Më pas zhvendoset si posojë e një rregulle që e lëviz nga pozicioni i tij fillestar për ta vendosur në një pozicion tjeter, pasi tiparet pyetëse duhet të gjenden në krye të frazës.

Zhvendosja e elementit pyetës nga pozicioni i tij argumentor drejt fillimit të fjalisë është një lëvizje e detyrueshme. Kështu, nëse elementi *çfarë* në ndërtimin (4) do të qëndronë në pozicionin e tij argumentor, nuk do të përftonim një pyetëse të mirëfilltë, por një pyetëse të llojit *eko*²:

- (4) *Beni lexoi çfarë?*

Edhe elementet pyetëse që gjenerohen në brendësi të fjalisë së zhvendosur duhet të zhvendosen drejt kreut të fjalisë kryesore, siç dëshmohet në (5):

- (5) *çfarë thua/mendon se lexoi Beni?*

Këtu, elementi *çfarë*, edhe pse del në rolin e kundrinorit të drejtë të foljes së fjalisë së nënrenditur *lexoj*, megjithatë e gjëjmë t'i paraprijë frazës, qëka e përforcion më shumë pohimin se të gjitha fjalitë pyetëse

- (2) a. *të pëlqen vjeshtë?*
b. *a punove dje?*
- Këtu elementet *WH* dalin pas komplementuesit *se*, i cili i paraprin fjalisë pyetëse të zhdrjetë. Pra, në gjuhën shqipe, një fjali pyetëse mund të paraprihet nga një komplementues:
- (6) a. *nuk e di se kush do të niset*
b. *nuk e di se kur do të niset Beni*

Siq u tha më sipër, një ndër tiparet që karakterizojnë këto struktura është pozicioni i përhershëm i sintagmës *WH* në krye të frazës. Një dukuri e tillë lë të nënkuptohet se përbëres të tilë, me gjasë, zënë një pozicion në periferinë e parë të frazës, pra në njyën CP.

Duke u nisur që nga zanafilla e formulimeve të para rrëth Teorisë X³, është thënë se elementet *WH*, zhvendosene drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës komplementuese CP, sepse pozicioni C° i frazave pyetëse mbart një tipar pyetës abstrakt, pra një tipar *WH* i cilë dëshmon naryrën pyetëse të gjithë kësaj strukturre.

Kështu, të gjithë ato elemente që mbartin tiparin *WH* zënë vend në hapësirën C°, e cila është mbartëse e po këtij tipari pyetës. Duke qenë se hapësira CP përfaqëson periferinë e skajshme të frazës, është e pritshme që edhe elementet pyetëse të dalin rregullisht në krye të saj.

Por nuk ndodh kështu, sepse një element pyetës mund të dalë edhe në vend të dytë, pas një elementi të zhvendosur më parë, siç dëshmohet në frazat (7), ku elementi pyetës shfaqet pas emrit *Benin*. Ky i fundit ka lënë pozicionin argumentor brenda sintagmës foliore VP (ku i është shënuar rasa kallëzore nga folja) dhe është ngritisur drejt një pozicioni më të lartë, brenda hapësirës CP.

- (7) a. *Benin, kur e takove?*
b. *Benin, kush e takoi?*

Është e qartë se të dy elementet, *Benin* dhe sintagma *WH*, kanë dale në periferinë e majtë të frazës. Por në cilin pozicion ndodhen ata? Nëse

² Në pyetjet e llojit *eko*, folësi e njeh që më parë përgjigjen e pyetjes që parashtron.

nyja CP ka vetëm një pozicion për Specifikuesin, si mund t'i mbajë dy elemente njëkohësisht? Përveç kësaj, nëse me të vërtetë elementi *WH* është në pozicionin e Specifikuesit të sintagmës CP, atëherë si mund të shpjegohej që ai shfaqet pas komplementuesit *se* (ref. (6)) i cili zë pozicionin e kokës C°, kur në të vërtetë ai do të duhej ta ndiqte e jo t'i paraprinë elementit pyetës?

Shembujt si ata në (7), të ngjashëm edhe me ata në gjuhën italiane, e kanë shhytë Rizzi-in (1995) të argumentojë se struktura e njës CP është më e ndërlikuar nga që duket në pamje të parë.

Në të vërtetë, për analizën e këtyre të dhënavave është e udhës të marrim në shqyrtim një strukturë më të ndërlikuar të njës CP, në të cilën gjenden pozicionet e nevojshme si për emrin *Benin* ashtu dhe për elementet pyetës *kur/kush*. Në vijim do të analizojmë strukturën e sintagmës komplementuese CP duke u mbështetur në propozimin e sjellë nga Rizzi (1995).

8.2. Periferia e majtë e frazës


Rizzi (1995) ka propozuar një paraqitje të re për njën CP, shumë më të artikular dhe zgjeruar se ajo tradicionala, në të cilën pasqyrohen vetëm koka C, specifikuesi dhe komplementi IP.

Kjo strukturë e re, e cila njihet me emrin *Sistemi Forcë-Shtjellim (Force-Finiteness)*, përfshin, përvèç komplementuesit, edhe elemente të tjera si Topik (*Topic*) dhe Fokus (*Focus*), kategori që përfaqësojnë, përkatesisht, të njohurën dhe të panjohurën që përmban një mesazh i caktuar. Struktura e re e propozuar nga Rizzi krijon vend, së paku, përkatë pozicione të ndryshme, brenda njës CP.

Pozicioni më i lartë është ForceP: projektohet nga koka Force° dhe shërben për të përcaktuar llojin e frazës. Tek koka Force° zënë vend komplementuesit si: *se*, që paraprin fjalinë dëflore; *që*, i cili paraprin fjalinë me foljen në lidhore apo atë relative; dhe *nëse* që paraprin fjalinë kushtore, si në frazat në (8):

- (8) a. *Tha se do të kthehet shpejt*
- b. *Libri që lexoi më pëlgj*
- c. *Merr makinën nëse s'ka tren*


Në frazat e mësipërmë dallohen komplementuesit *se*, *që* dhe *nëse* falë të cilëve ne kuptojmë që këto fraza janë përkatesisht emërore (që bëjnë punën e kryfjalës, të kundrinës a të kallëzuësit emëror), relative dhe kushtore⁸. Më poshtë është paraqitur skema X-bar e kësaj sintagme:



Poshtë nyjës ForceP ka një pozicion Topik (e shënuar shkurtimisht TopP nga *Topic Phrase*). Kategoria Topik (temë) shpreh të njohurën, atë që është thënë më parë. Shembuj topikalizimi janë ata të frazave (7) dhe (10), ku sintagmat emërore *Benin*, *librin* dalin si Topik (temë), pra si e njohur:

- (10) *librin, Beni e lexoi dje*

Në sintagnë TopP, koka funksionale Top° projekton skemën e saj X-bar, ku bëjnë pjesë specifikesi dhe komplementi. Në vendin e specifikuesit mbërrijnë elemente si *Benin*, *librin*, të zhvendosur si pasojë e procesit të topikalizimit.




Pozicioni Topik ndiqet nga Fokus (*Focus*), i cili shpreh të panjohurën, të renë e informacionit, si sintagma emërore *LIBRN* në shembullin e në vijim.

⁸ Natyrisht, njëkohësisht me komplementuesin merrin parasysh edhe elemente të tjerë që shërbejnë për organizimin e frazës.

(12) *LIBRIN lexoi Beni (jo gazetën)*


FocusP (ë shënuar shkurtimisht FocP nga *Focus Phrase*) projktohet nga koka Foc^o dhe në specifikuesin e tij zënë vend elementet e fokalizuar si *LIBRIN*.




Për ta bërë më të qartë mënyrën e shprehjes së kategorive të analizuara më lart, po jepim strukturën e plotë të një fraze që përmban këto elemente:

(16) *tha se Arbeni DY LIBRA kishte lexuar*

(17)



Nyja më e ulët është ajo FinP (*Finalness Phrase*), që qëndron në një pozicion më të lartë se ajo e fletksionit IP dhe, në rastin e shqipes, përmban formantë të tillë, si parafjalën *me* në ndërtimet e paskajoresh gëge (*me fol*) të cilave në gjithë të ndryshme u gjejgen elemente të tillë si *di* për italishten (*di parlare*) *to* për anglishten (*to speak*) etj. Ndërkohë foljet zënë pozicionin e kokës së sintagmës fletksionale:



Në pozicionin kokë të kësaj nyje zënë vend ato elemente që janë shprehëse të tipareve të ndryshme foljore. Rrjedhimisht, struktura e propozuar nga Rizzi ka paraqitet e mëposhtme:

(15) Force...Topic...Focus...Fin...IP

ku Force është pozicioni më i lartë i sintagmës komplementuese, Topik shpreh të rjohurën, atë që është thënë më parë, ndërsa Fokus

Duhet pasur parasysh se sistemi forcë-shtjellim është pjesa kryesore më e rëndësishme e sistemit komplementues, kështu që duhet parë i pranishëm në të gjitha strukturat e mundshme që paraqesin frazat e ndryshme.


Nga ana tjetër, duhet theksuar që sistemi *Topik-Fokus* është i pranishëm në një strukturë të caktuar vetëm nëse është "i nevojshëm", Topik shpreh të rjohurën, atë që është thënë më parë, ndërsa Fokus

shpreh të panjohurën, të renë e informacionit që përcilllet. Mbi këtë të fundit bie dhe theksi logjik i frazës. Sintagmat FinP / IP janë shprehëse të fletksionit foljor dhe zënë vend në periferinë e djathit të sistemit komplementues, ku IP zë pozicionin më të ulët të këtij sistemi.

Për ta bërë më të qartë mënyrën e shprehjes së kategorive të analizuara më lart, po jepim strukturën e plotë të një fraze që përmban këto elemente:

(16) *tha se Arbeni DY LIBRA kishte lexuar*

(17)



këto kategoritë dalin rëndom në fjalitë pyetëse, atëherë edhe për strukturën e sintagmës komplementuese CP të këtyre fjalive do të ndiqet e njëjtë lindje analizë.

8.3. Analiza e përbërësve brenda fjalisë pyetëse

C' vend zënë elementet pyetëse brenda kësaj strukturë? Duke qenë se sintagmat *WH*, ashtu siç pamë në (7), mund të paraprihen nga elemente të topikalizuar, të cilët zënë pozicionin e specifikuesit të sintagmës TopP, është e natyrshme të mendojmë që elementet pyetëse të zënë vend më poshtë, si specifikues të sintagmës FocP. Dhe në të vërtetë, këtë e dëshmon fakti se kur fraza mbart elemente *WH*, është e pamundur të ketë gjithashu elemente të fokalizuara:

- (18) **kush LIBRN lexoi?*

Jogrammatikalliteti i shembullit (18) rrjedh prej faktit se dy elemente të ndryshme (*kush* e *LIBRN*) gjinden në të njëjtin pozicion, ndërkohë që aty ka vend vetëm për njërin syresh. Pra, mund të arrimë në përfundimin se elementet pyetëse zhvendosen nga pozicioni i tyre fillestar, brenda sintagmës foljore VP, drejt pozicionit të Specifikuesit të sintagmës FocP. Pasi kemi përcaktuar vendin e mbërritjes së elementeve pyetëse, lind nevoja të njohim pozicionin e elementeve të tjera në brendësi të frazës pyetëse.

Struktura më të ndërikuara na bëjnë të qartë se fjalia pyetëse nuk ruan të njëjin rend si ai i elementeve përbërëse të frazës dëftore. Konkrektisht, në fjalinë pyetëse kryefjala mund të realizohet në pozicion fundor (19a) ose në pozicion pasfolior (19b); por asnjëherë në pozicion parafoljor (19c-d):

- (19)
 - a. *kur (e) lexoi librin Beni?*
 - b. *kur (e) lexoi Beni librin?*
 - c. **kur Beni lexoi librin?*
 - d. **Gjare Beni lexoi?*

Shembujt gramatikorë në (19) janë ata në të cilët elementi pyetës dhe folja pasojnë njëri-tjetrin. Kjo të bënin të mendosh se jo vetëm elementi *WH*, por edhe vetë folja është zhvendosur në një pozicion më të lartë,

në afërsi të sintagmës pyetëse. Atëherë, le të shohim më mirë se cili është pozicioni i mbërritjes së foljes dhe arsyet që e detyrojnë atë të zhvendoset në frazë.

Siq e përmendëm më lart, që në fillesat e para të Teorisë X', ishte arritur në përfundimin se elementet pyetëse zhvendoset drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës komplementuese CP, në mënyrë që të realizohet përshtatja specifikues-kokë me kokën C° , e cila mbart të njëtin tipar.

Nga ana tjetër, Rizzi (1991) ka hedhur hipotezën se nuk është koka C° që mbart tiparet *WH*, por vetë folja dhe për këtë arsyë ajo zhvendoset drejt këtij pozicioni për t'i depozituar aty tiparet pyetëse. Ngrijta e foljes në pozicionin C° diktohet nga nevoja e përshtatjes së një specifikuesi, mbartës i tiparit *WH*, dhe një koke që ndan me të njëjtin tipar. Rizzi e ka emërtuar këtë me termin *WH-CRITERION*.

(20) WH-CRITERION

- A. Një operator *WH* duhet të ketë konfigurimin Spec-kokë lidhur me kokën X° [+WH]
- B. Një kokë X° duhet të ketë konfigurimin Spec-kokë lidhur me operatorin *WH* [+WH]

Pra, sipas kushtit *WH-CRITERION*, një element pyetës duhet të gjendet në pozicionin e specifikuesit të një koke pyetëse dhe, anasjelltas, një kokë, mbartësse e tipareve pyetëse, duhet të ketë si specifikues të saj një element pyetës. Nëse brenda strukturës CP të detajuar, elementi pyetës ngjitet tek specifikuesi i sintagmës FocP, folja duhet të ngjitet në pozicionin kokë të Foc $^\circ$.

Këshiu, në fjalinë pyetëse, folja së pari zhvendoset nga V° në I° për të kontrolluar tiparet e kohës, vetës dhe numrit e mië pas nga I° në Foc $^\circ$ për të dërguar aty tiparin pyetës *WH*.


Mbetet tanë për t'u shpjeguar pozicioni i kryefjalës. Në shembullin (19a), ai del në pozicionin fundor të frazës (*kur (e) lexoi librin Beni?*). Përse del kryefjala në vend të fundit? Një ndër përgjigjet, edhe pse e paargumentuar kënaqshëm, është se folja ngrihet në nyjën FocP e shoqëruar nga kundrinoi i drejtë, i cili e kapërcen kryefjalën.

Por, duke qenë se Foc° është një pozicion i llojit X° , vetëm një element i kësaj kategorie, pra vetëm një kokë mund të zhvendoset drejt atij pozicioni, d.m.th. vetë folja; kjo e fundit, bashkë me komplementin e saj formojnë një sintagmë foliore VP, thënë ndryshe një sintagme foliore të llojit XP dhe si e tillë mund të zhvendoset vetëm drejt një pozicioni maksimal të së rrijëtës kategori.

Përgjigja e dyjetë dhe më e pranueshme, vjen nga teoria e rasës dhe e përshtatjes mes kryefjalës dhe fleksionit foljor. Siç dihet, kryefala në konfigurimin specifikues-kokë të sintagmës fleksionale IP kur folja ndodhet në I° dhe kryefala si specifikues i saj. Por, nëse folja e lë pozicionin e saj në $Infl$ për t'u ngritur drejt pozicionit Foc° , atëherë do të prishet konfigurimi i përshtatjes mes kokës $Infl$ si shënues i rasës dhe kryefjalës si specifikues.

Që kryefala ta marrë rasën emërore edhe në mungesë të fleksionit, duhet të qëndrojë brenda sintagmës foliore VP, në një pozicion adjunktivi, ku mund t'i shënohet rasa nga koka T° . Në (21) paraqitet struktura e një fjalë pyetëse në përbërje të së cilës gjëjmë elementin pyetës, foljen, kundrinorin e drejtë dhe kryefjalën.

(21)




Në këtë strukturë, elementi pyetës *kur* është ngritur nga pozicioni i adjunktit të sintagmës foliore VP (ku ka mbetur një kopje e fshirë) drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës fokus FocP. Folja *lexoi*, së pari është ngritur në I° për të kontrolluar tiparet fleksionale dhe më pas në Foc° për të depozituar aty tiparin + *WH*. Kryefala *Beni* ndodhet në pozicionin e adjunktit të sintagmës VP. Po ashtu, kryefala mund të dalë në një pozicion që i paraprin kundrinorit të drejtë si në (19b), që po e risjellim këtu si (22):

(22) *kur (e) lexoi Beni librin?*

Nuk mund të hamendësohet që në ndërtime të tillë kryefala të ndodhet në pozicionin e Specifikuesit të sintagmës fleksionale IP e as të jetë tejkaluar nga folja e ngritur në pozicionin Foc° , sepse zhvendosja e foljes në këtë pozicion do të prishte konfigurimin Specifikues. Kokë mës fleksionit dhe kryefjalës si Specifikues i tij. Ka më shumë gjasa të pranohet vendi i kryefjalës brenda sintagmës foliore VP, pranë pozicionin e saj filletar siç dëshmohet në skemën e mëposhtme:



(23)



Në frazën pyetëse të zhdrjetë, të tipit *gjfarë thua se lexoi Beni?*, elementi *gjfarë* gjenerohet si komplement i foljes *lexoi* në brendësi të

fjalisë së varur, e cila paraprihet nga komplementuesi *se* e më pas zhvendoset drejt kreut të fjalisë kryesore. Duke qenë se rregullat e lëvizjes kanë kufizimet e veta, sintagma pyetese nuk mund të zhvendoset me një spostim të vetëm nga fjalia e varur deri tek specifikuesi FocP i fjalisë kryesore.

Parimet e lokalitetit nuk e lejojnë këtë lëvizjeje të menjëhershme të elementit *gfarë* drejt fjalisë kryesore. Mundësia e vërtme mbetet zhvendosja me fazë, që ka do të thotë se sintagma pyetese, së pari, vendoset në pozicionin SpecFocP të fjalisë së varur e më pas zhvendoset drejt fjalisë kryesore (për lehtësi, po sjellim vetëm pozicionet më kryesore në skemën e mëposhtme):




kryesore, ndalon së pari në pozicionin e specifikuesit të sintagnës fokus SpecFocP të fjalisë së varur për shkak të parimeve të lokalizimit.

Pra, lëvizja mund të mos njohtë kufi, mjafton që të respektohen ciklet e njëpasnjëshme, apo të ashtuquajturat faza.

Në ato raste kur elementi pyetës mbetet në pozicionin e tij fillostar të fjalisë së nënrenditur, atëherë ai mund të dalë pas komplementuesit *se*.

Kjo lloj struktura mund të paraqitet si më poshtë:



8.4. Struktura e fjalisë pyetëse PO/JO

Sic është thënë më lart, pyetëset PO/JO mund të ndërtohen edhe me anë të përdorimit të pjesëzës *a*:

(26) *a ka motra Lindita?*

Siq shihet në skemën (24), elementi pyetës *gfarë*, para mbërritjes së tij në pozicionin që del në sintaksën e shfaqur, SpecFocP të fjalisë

Pjesëza *a* mund të përdoret jo vetëm për pyetjet e drejtpërdrejtë si ajo e sjellë në shembullin (26) por edhe për ato të zhdrejtë si në (27):

(27) *nuk e di a ka motra Lindita*

Ajo mund të paraprihet nga elemente të topikalizuara si në (28):

(28) *Lindita, a ka motra?*

Edhe në ndërtimet pyetëse PO/JO rendi i fjalëve është i ndryshëm nga ai i fjalive dëftore përkatëse, pasi folja ndodhet gjithnjë pranë pjesëzës pyetëse; pas foljes vjen kundrinori i drejtë, ndërsa kryefjala del në pozicionin fundor të frazës.

Pjesëza *a* është një morfemi pyetëse e mirëfilltë, apo më mirë një element që shihet në frazë pikërisht për të shënuar llojin e saj. Ndryshe nga elementet pyetësse *WH*, pjesëza *a* nuk ka fleksion dhe kjo na shihyn të mendojmë se ajo mund të ketë statusin e një operatori modal pyetës, një *Q-morpheme* (po t'i referohemi terminologjisë angleze), më shumë sesa atë të një sintagme.

Për më tepër, në këtë rast nuk mund të flitet për ndonjë zhvendosje nga pozicioni i brendshëm VP, sepse nuk është në gjendje të mbajë asnjë rol tematik, por duhet thënë se ajo gjenerohet në një pozicion kokë të sintagmës komplementuese CP.

Siq e pamë në (28), pjesëza *a*, ashtu si dhe sintagmat *WH*, mund të paraprihet nga elemente të topikalizuara, të cilët zënë vend në SpecTopP, dhe për këtë arsy nuk mund të hedhim hipotezën se vendi i gjenerimit të kësaj pjesëze, është më poshtë, pranë pozicionin kokë të sintagmës fokus, Foc^o.

Edhe pse roli i kësaj pjesëze është t'i paraprijë fjalisë pyetëse, pra të shënojë llojin e fjalisë, duhet përashtuar mundësia që ajo të jetë gjeneruar, ashtu si komplementuesit, në pozicionin kokë të sintagmës ForceP. Këtë e konfirmon fakti se pjesëza *a* mund të paraprihet nga një element i topikalizuar (28) e po ashtu mund të dalë në një fali e cila paraprihet nga një tjeter komplementues, si p.sh. *po*:

(29) *po Lindita a ka motra?*


Në strukturën (29), elementi *po* zë pozicionin e kokës së sintagmës ForceP, në të cilin, zakonisht, dalin komplementuesit; *Lindita* është në pozicionin e specifikuesit të FocP dhe të pjesëzës *a* që shërben si kokë e kësaj sintagme, Foc^o.

pozicionin e specifikuesit të një projektkimi TopicP, ndërsa pjesëza *a* është në pozicionin kokë Foc^o. Kundrinori i drejtë *motra* ndodhet brenda sintagmës VP.

Pasi kemi përcaktuar pozicionin e pjesëzës pyetëse, imbetet të përcaktojmë pozicionin e foljes që vjen menjëherë pas saj dhe të kryefjalkës që del në fund të fjalisë (26).

Ka gjasa që, në ato raste kur fjalia përmban pjesëzën *a* në Foc^o, folja, e cila është po ashtu mbartëse e tiparit pyetës, të ngjitet nga pozicioni Infl, drejt një pozicioni kokë më të afërt lidhur me Foc^o, pra në Fin^o për të kontrolluar tiparet pyetëse të Foc^o³.


Në një rast të tillë, ngjyrtja e foljes në pozicionin Fin^o e prish konfigurimin e përshtatjes mes kryefjalës në SpecIP dhe foljes. Për këtë arsy kryefjala kushtëzohet të qëndrojë brenda sintagmës foljore dhe të ndiekë Kundrinorin e drejtë. Struktura e frazës (16) do të paraqitej si më poshtë:



Ndërsa fraza (29) ka këtë strukturë:

³ *Wh-Criterion* gjen përgjigje në projekcionin FocP nga një operator *WH* që ndodhet në pozicionin e specifikuesit të FocP dhe të pjesëzës *a* që shërben si kokë e kësaj sintagme, Foc^o.

9



FJALIA ME FOLJE

NË MËNYRËN LIDHORE

9.0. Fjali të varura dhe të pavarura me folje në lidhore

Në këtë krye do të analizojmë strukturën e fjalive me folje në lidhore. Folja në lidhore mbart një pjesëz modale të pandryshueshme *të* dhe një formë të shtjelluar sipas vërtës, numrit, kohës dhe diatezës. Përdoret si në fjaltë e pavarura ashtu dhe në ato të varura. Në fjaltë e pavarura, lidhorja përdoret për të shprehur urim (1a) malkim (1b), dëshirë (1c), dyshim (1d), pyetje (1e), të ardhmen (1f):

- (1) a. *të rrojë sa male!*
- b. *në djall të shkojë!*
- c. *të shkoj edhe një herë në Shqipëri!*

- d. *të ketë ndonjë vështirësi?*
 e. *cilin të marr?*
 f. *kur do të fillojmë? Kur të vish ti*

Në fjalitë e varura, lidhorja del si komplement i foljeve që u përkasin Klasave të ndryshme, si folje që shprehin dëshirë (*dua, dëshiroj, preferoj, uroj*), folje modale (*mund, duhet*), kauzative (*bëj*), aspektore (*filloj, nis, vazhdoj*), të ashtuquajturave folje që kontrollojnë një kryefjalë të pasprehur (*urdhëroj, porosit, kërkoj, këshilloj*)¹. Nëdërtimet e varura me folje në lidhore kanë një përdorim të gjierë, pasi përgjithësisht përdoren në vend të trajtave infinitive që i gjejmë dendur në gjuhët romane e më gjierë:

- (2) *studenti nuk di të flasë anglisht
 lo studente non sa parler anglais* italishtë
l'étudiant ne sait pas parler anglais frëngjishtë

Në gjuhën shqipe fjalia e nënrenditur me folje në lidhore mund të paraprihet nga lidhëza *që*:

- (3) *ata primin që ai të thoshte një fjalë*

Kryefjalë e foljes së fjalisë së nënrenditur mund të jetë e njëjtë ose e ndryshme nga ajo e fjalisë kryesore. Kështu, në (4a), emri *Lindita* është njëkohësisht kryefjalë si për foljen e fjalisë kryesore *dëshironë*, ashtu dhe për foljen e fjalisë së nënrenditur *të fliste*.

Në (4b), dy foljet kanë kryefjalë të ndryshme: *Lindita* është kryefjalë e foljes kryesore, ndërsa *shoqer* është kryefjalë e foljes së nënrenditur në lidhore:

- (4) a. *Lindita dëshironë të fliste me shoqet*
 b. *Lindita dëshironë që shoqet të flisin me Artanin*

Ndërkohë që tiparet e foljes së nënrenditur në lidhore mund të janë të ndryshme nga ato të foljes kryesore, koha, gjithsesi, duhet të jetë e njëjtë për të dy foljet.

Pra, tiparet morfolgjike të kohës së foljes në lidhore përcaktohen gjithnjë nga ato të foljes kryesore. Ajo çfarë vihet re në fjalitë e varura me folje në lidhore së shqipës është pikërisht e ashtuquajtura *consecutio temporum*, përshtatja e kohëve të foljeve në fjalinë kryesore dhe të varur. Ja disa shembuj:

- (5) a. *Lindita vazhdon të flasë*
 b. *Lindita vazhdon të fliste*

Në (5a), folja në lidhore e fjalisë së varur është në kohën e tashme, pasi fjalia kryesore e ka foljen e saj në të tashmen; në (5b) kemi kohën e pakryer, pasi e pakryera është kohë e foljes së fjalisë kryesore. Në brendësi të foljes së nënrenditur lidhore, përbërësit mund të ndjekin rendin SVO (*Subject, Verb, Object*) ose VOS. Tipi i parë i këtyre ndërtimeve ilustrohet në (6a) dhe i dyti në (6b):

- (6) a. *Ata primitin që Lindita të lexonit të gjithë librat*
 b. *Ata primitin të lexonte të gjithë librat Lindita*

Fjalia e nënrenditur në (6a) paraprihet nga lidhëza *që*. Duke qenë një element i varur, lidhëza *që* zë vendin e parë brenda fjalisë së nënrenditur. Pas saj vijnë, sipas një rendi të caktuar, kryefjala *Lindita*, folja në lidhore *të lexonte* dhe kundrorni i drejtë *të gjithë librat*.

Dy elementet emërtore janë mbartëse të tipareve rasore që u përgjigjen funksioneve të caktuara gramatikore. Kryejalës *Lindita* i shënohet rasa emëtore, ndërsa kundrornit të drejtë *të gjithë librat* i shënohet rasa kallëzore.

Në ndërtimin sintaksor në (6b) mungon lidhëza e riënrenditur *që*. Kryefjala e fjalisë lidhore, *Lindita*, gjendet në pozicionin fundor të kësaj strukturre, edhe pse vazhdon të jetë mbartëse e rassës emëtore dhe të bashkëndajë tiparet e përshtatjes me foljen.

Rendi linear në (6b) ka gjasa të jetë pasojë e heqjes së lidhëzës *që*, pasi kur kjo lidhëz hiqet, vëmë re se kryefjala zhvendoset në fund të

¹Strukturat kontrolluese janë ato illoj ndërtimësh ku një argument i fjalisë kryesore (kryefjala apo kundrorni) ‘kontrollon’ një argument të fjalisë së nënrenditur. Për shembull në frazën e mëposhtme:

(i) *Beni dëshiron të niset*

Beni kontrollon kryefjalën e foljes së nënrenditur *të niset*. Kjo do të thotë se shihet si folje ‘në kontrollin e kryefjales’. Ndërsa në frazën:

(ii) *Beni detyron gruan të niset*

është emri *gruan* që kontrollon kryefjalën e foljes *të niset*. Pra, bashkëreferencia këtu realizohet mes kundrornit të drejtë të foljes së fjalisë kryesore dhe kryefjales së fjalisë së nënrenditur. Kjo illoj foljeje quhet ‘folje nën kontrollin e kundrornit’. Për më tepër shih Buxheli (2005).

frazës. Pra, kur kryefjala e fjalisë kryesore është e ndryshme nga ajo e fjalisë së nënrenditur, kryefjala e kësaj të fundit mund të shfaqet në pozicion parafoljor apo pasfoljor. Ky i fundit kushtëzoher nga mungesa e lidhëzës *që*. Lidhëza *që* zakonisht hiqet kur fjalia kryesore dhe ajo e varur kanë të njëjtin kryefjalë, si më poshtë:

- (7) a. *Lindita fillon të lexojë librin e historisë*
 b. *Dua të pi diçka të ftohë*

9.1. Struktura e fjalisë me folje në lidhore

Siq kemi thënë, fleksioni i lidhores ka shënjues të mënyrës, kohës dhe të vetës. Në vëgantit, shenjuesit e vetës dhe të kohës realizohen në format foljore, siç e dëshmojnë mbaresat në dy paradigmat në vijim:

- (8) *të lexoj* *të lexojmë*
të lexosh *të lexoni*
të lexojë *të lexojnë*
- (9) *të lexoj* *të lexoja*
të lexosh *të lexoje*
të lexojë *të lexonte*
të lexojmë *të lexonim*
të lexoni *të lexonit*
të lexojnë *të lexonim*

Në (8) vihet re dallimi mes vetave të njëjësit dhe të shumësít, ndërsa në (9) vëmë re dallimin mes kohës së tashme dhe së pakryerës.

Përkundrazi, mënyra realizohet me anë të pjesëzës së pandryshueshme *të*, që i paraprin foljes së shtjelluar. Kjo pjesëz mund të ndahet nga folja vetëm nga fjala mohuese *mos* dhe nga kilitikët, të vërtet elemente që mund të zënë vend mes pjesëzës modale *të* dhe foljes së shtjelluar.


- (10) a. *Lindita të mos flasë*
 b. *Lindita të më flasë*

Përbërës të tjerë si emërorë apo ndajfoljorë, përashtohen:

- (11) a. **të Lindita flasë*
 b. **të gjithmonë flasë*
- Ky është një tregues që dëshmon se pjesëza *të* është element i fleksionit (Infl) të lidhores. Në fakt *të*-ja është shënjues i mënyrës së foljes në lidhore. Por fakti që ajo mund të ndahet prej foljes nga pjesëza mohuese apo kilitikët, të bën të mendosh se ky element zë një pozicion të ndryshëm nga ai i foljes flektive.

Paraqitja e fjalisë me folje në lidhore duhet të marrë parasysh edhe elementin që realizon mënyrën e foljes. Struktura e kësaj fjalie mund të ketë kështu një pozicion sintakor të etiketuar MP (*Mood Phrase-Sintagmë Mënyrore*), që krijon vend edhe për pjesëzën *të*.

Pra, struktura e foljes lidhore do të paraqitet si më poshtë:



Në pozicionin kokë V° zë vend folja leksikore *lexo*. Duke u ngjitur drejt pozicionit T° (sig dëshmon shigjetë), folja merr morfemën e kohës *-n-* ndërsa në pozicionin Agr° do të marrë morfemën e përshtatjes *-im*, derisa të marrë formën *lexonim*. Por *lexonim* ende nuk është në mënyrën lidhore: forma e plotë e foljes duhet të përfshije edhe pjesëzën *të*, të vendosur në pozicionin M°.

Siq pamë më lart, fjalia me folje në lidhore mund të paraprihet nga komplementuesi *që*, i cili, po të jetë i shprehur, zë pozicionin Force° brenda strukturës së kësaj fjalie. Në këtë rast rendi i përbërësve brenda strukturës do të jetë SVO, ku kryefjala i paraprin foljes në lidhore.


Kur komplementuesi *që* është i shprehur, kryefjala zë pozicionin e specifikuesit të sintagmës MP:



Struktura (14b) është e ndërtuar keq, pasi në mungesë të komplementuesit, kryefjala *Lindita* ndodhet në një kontekst të tilë: në të cilin i shërohen tiparet rasore nga dy elemente njëkohësisht: fleksioni (Infl) i lidhores, që shënon rasën emërore, dhe folja kryesore *prinin*, që kërkon rasën kallëzore.

Kjo mundësi e dyfishtë e shënimt rasor e bën të pamundur realizimin e kryefjalës *Lindita* në pozicion parafoljor. Rrjedhimisht, duhet përjashtuar mundësia e imbetjes së kryefjalës në pozicionin e saj fillostar (në SpecVP), sepse atë e gjëjmë të shfaqur pas kundrinorit të drejtë.

Pozicioni i vetëm ku mund të realizohet kryefjala është ai i adjunktit në sintagmën follore VP, ndërkohë që një *pro plotësuese* do të zëre pozicionin SpecMP:



Kryefjala *Lindita* i shënohet rasa emërore nga e gjithë sintagma follore në konfigurimin Specifikues-Kokë të sintagmës MP ku realizohet formësimi i lidhores. Ndërsa kundrinori i drejtë *librat* e merr rasën kallëzore në brendësi të sintagmës follore VP.


9.2. Fjali të me folje në lidhore pa komplementues

Në ato raste kur komplementuesi *që* nuk është i shprehur, rendija e foljeve njëra pas tjetës bëhet e detyrueshme dhe rendi i përfshuar është VOS.

Kryefjala e fjalës me folje në lidhore nuk mund të zëre pozicionin parafoljor, por vetëm atë në fund të fjalës:

- (14) a. *Primin të lexonte të gjithë librat Lindita*
 b. **Primin Lindita të lexonte të gjithë librat*

Ka gjasa që në këto ndërtime niveli ForceP të mungojë tërësisht. Në një rast të tilë, folja kryesore përzgjedh drejtëpërdrejt sintagmën MP dhe për këtë arsyë përjashtohet mundësia e vendosjes së kryefjalës *Lindita* në pozicionin e specifikuesit të kësaj sintagme, pasi do të ndodhej nën drejtimin e foljes së fjalës kryesore *prinin*, ndërkohë që ajo është nën dominimin e foljes *lexonte* të fjalisë së varur.



9.3. Fraza kauzative

Siq pamë deri këtu, fjalia e nënrenditur me folje në lidhore mund ta ketë kryefjalën parafoljore, pra të realizohet në pozicionin Spec të sintagmës MP, ose pasfoljore, si adjunkt i sintagnës follore VP. Por, pavarësisht nga pozicioni në të cilin ndodhet, kryefjala e foljes në lidhore është gjithnjë në rasën emrëtre.

Përveç këtyre dy variantave të sipërpërmendura, hasim edhe një të tretë. Është fjalë për ndërtimet kauzative.

Në gjuhën shqipe folja kauzative *bëj* përzgjedh ndërtime në lidhore, të cilat mund ta kenë kryefjalë para apo pasfoljore:

- (16) a. *Gjykatësi bëri që dëshmiutari ta lexojë betimin*
- b. *Gjykatësi bëri ta lexojë betimin dëshmiutari*

Struktura në (16a) ka të njëjtën paraqitje si ajo e ilustruar në (13), ndërsa struktura në (16b) ka një paraqitje si ajo në (15).

Vëmendje të vegantë meriton ndërtimi i dhënës në frazën e mëposhtme:


- (17) *çdo trokijë e bënte Benin (që) të shihte orën*

Në strukturën (17), folja kauzative *bëj* përzgjedh një fjali të varur që e ka foljen në lidhore *të shihte*, kundrimorin e drejtë *orën* në kallëzore dhe kryefjalën, e cila në vend që të ketë tiparet e rasës emrëre *Beni*, shfaqet në kallëzore: *Benin*. Për më shumë, ky emër shfaqet në një pozicion më të lartë se komplementuesi *që*.

Nëse për foljen *bëj* kryefjala është shprehur me sintagnën *çdo trokijë*, folja *shoh* nuk ka kryefjalë të shprehur. Sidoqoftë, nuk mund të mos e shohim lidhjen mes sintagnës emrëre *Beni* dhe sintagnës follore *të shihte orën*, por shprehimisht kemi një folje (shoh) me dy emra në kallëzore (*orën*, *Benin*).

Është e qartë se kjo rasë kallëzore nuk shënohet nga folja në lidhore, sepse folja *të shihte* i shënon rasën kallëzore vetëm emrit *orën*. I vërtimi element që mund t'i shënojë rasën emrëre emrit *Ben* është folja kryesore *bëj*, por për këtë është e nevojshme që emri të zhvendoset

në pozicioni SpecMP drejt atij SpecForceP. Vërem këtu ai mund ta marrë rasën kallëzore drejtpërdrejt prej foljes kryesore:



9.4. Fraza me folje modale

Foljet modale, apo të ashtuquajturat gjysmëndihmëse, në gjuhën shqipe janë *mund* e *duhet*. *Mund*, e cila lidhet vetëm me folje në mënyrën lidhore, karakterizohet nga një paradigmë e dyfishtë.

Në të vërtetë, kjo folje ka një fleksion të plotë për mënyrën, kohëns dhe vëten dhe del në formë të ngurosur për të tria vërat e së tashmes dhe të së pakryerës dëftore.

Nëpërmjet shembullit (19a) sjellim trajtat e gjedhuara të foljes *mund*, ndërsa në (19b) jezet forma e ngurosur e saj:

- (19) a. *ju mundni të shkoni*
- b. *ju mund të shkoni*

Fraza modale karakterizohet nga aktivizimi i së njëjtës kryefjalë si përfoljen modale ashtu dhe përfoljen leksikore të fjalisë së varur. Aty ku përpigjeni të përfshijnë dy kryefjalë leksikore, përfjojmë fraza jogramatikore, si me trajtë foljore flektive, ashtu dhe me trajtën e ngurosur:

- (20) a. *ju mundni të bëjë diçka Shpresa
b. *ju mundni (që) Shpresa të bëjë diçka

- (21) a. *Beni mund të bëjë diçka Shpresa
b. *Beni mund (që) Shpresa të bëjë diçka

Pra, vetëm folja në lidhore mund t'i shënojë një rol tematik të jashtëm i një emri apo përenemi, i cili mund të dalë në krye apo në fund të një strukture, por nuk mund të realizohet kurrsesi mes dy foljesh:

- (22) a. Beni/ai mund ta bëjë
b. mund ta bëjë Beni/ai
c. *mund Beni/ai ta bëjë

Edhe atëherë kur kryefjala nuk është e shprehur, kategoria bosh *pro mund* të identifikohet nëpërmjet tipareve të përshtatjes së foljes në lidhore.

Ndërtimet modale, edhe pse formohen nga një folje kryesore dhe nga një fjalë e nënrenditur me folje në lidhore, nuk e pranojnë shprehjen e komplementuesit *që*.

- (23) *Beni mund që ta bëjë

Kjo do të thotë që, edhe pse përzgjedh një ndërtim lidhor ForceP, në pozicionin kokë Force° nuk mund të gjëjmë asnjëherë lidhëzën e nënrenditur, pra kemi të bëjmë me një pozicion bosh.

Sig e thamë më lart, forma e ngurosur e foljes *mund* nuk ka tipare të vëtes e as të kohës. Kjo do të thotë se struktura e ndërtimeve modale formohet vetëm nga një sintagnë foljore VP, pra nuk ka projektum të sintagnës fleksionale IP, siç ndodh në rastet e foljeve të shtjelluara.

Folja *mund* gjenerohet në VP dhe po aty mbetet, pasi nuk ka zhvendosje drejt pozicionit IP dhe, në mungesë të këtij të fundit, nuk mund të projektohet një pozicion më i lartë përfshirë kryefjalën. Për

rijedhojë, pozicioni i vetëm që mbetet për argumentin e jashtëm ndodhet brenda fjalisë me folje në lidhore. Kryefjala e vetme leksikore e përfshirë në strukturat modale e merr rasën emërore nga fleksioni i lidhores.

Kryefjala është gjithnjë e dallueshme falë shenjuesve të përshtatjes së foljes në lidhore. Interpretimi i foljes modale është i dyfishtë: mund të konsiderohet si një folje pavetore apo të ketë një kryefjalë të përbashkët me foljen në lidhore.

Në rastin e foljes modale me fleksion, projektohet edhe sintagma fleksionale IP, por duke qenë se nuk mund të ketë dy kryefjalë të dallueshme nga njëra-tjetra, atëherë duhet pranuar që foljes modale i referohet po ajo kryefjalë e foljes në lidhore.

Ky bashkëreferim përfshohet me një lidhje referenciale midis përbërësve të dyja fjalive: folja modale realizon shënjuesit tematikë të fjalisë së nënrenditur nëpërmjet pozicionit ForceP që është bosh. Në fjalinë e nënrenditur, fleksioni dhe pozicioni Force° kanë indeks të njëjtë, kështu që edhe folja modale me foljen në lidhore do të kenë indeks të njëjtë dhe, përfshirë, edhe kryefjalët do të kenë të njëjtën referencë.

E vetmja kryefjalë leksikore e pranueshit tematikë merr rasën emërore nga fleksioni i foljes në lidhore. Kjo kryefjalë leksikalizohet si adjunkt i sintagnës foljore VP dhe jo në pozicionin parafolor SpecMP.

Ka gjasa që pamundësia e pasjes së një kryefjale mes dy foljeve (*mund Mira të nise) të jetë pasojë e lëvizjes që kryen folja në lidhore në pozicion Force° që është bosh (lëvizje e nevojshme përbashkëreferencë).

Nëse zbatohet lëvizja e fleksionit Infl në Force°, atëherë nuk do të mund të kishim më paraqitjen Spec-kokë, aq e nevojshme përfshirë dëllimin e kryefjalës dhe përfshirë dëllimin e rasës emërore në brendësi të përbërësit MP. Për këtë arsy, kryefjala mbetet brenda sintagnës VP ose zhvendoset në krye të strukturës modale, në një pozicion Topic::.. Kështu, në skemën (24) është paraqitur struktura e një fjalie, kryefjala e së cilës ndodhet përballë një foljeje në lidhore dhe një foljeje të pashtjelluar. Duke qenë se kryefjalës i shënohet roli tematik nga folja

e shtjelluar *të nisë*, atëherë ajo mund të qëndrojë brenda sintagmës follore, si adjunkt i saj pa u zhvendosur drejt periferisë së majtë të fjalisë, siç e shohim ne skemën e mëposhtme.

Nga ana tjeter, kryefjala mund ta lërë pozicionin e saj filletar, për t'u zhvendosur drejt kreut të fjalisë në pozicionin Spec TopP.



FRAZA KUSHTORE

10.0. Mjetet lidhëse në frazat kushtore

Në këtë këre do të flasim për frazën me fjalë *të* nënrenditur kushtore, që në shqip paraprihet nga lidhëzat *po*, *sikur*, *në*, *nëse*, *në qoftë se*, *po që se*, *po të jetë se*. Disa nga këto janë në përdorje plotësuese, të tjerat jo. Që të gjithë i gjejmë të përdoren në krye të fjalisë kushtore. Le ta nisim analizën tonë me lidhëzën *po*. Mund të kombinohet vetëm me folje në mënyrën dëftore (1) apo në lidhore (2) dhe nuk ë lejon kryefjalët t'i paravendoset foljes (1c), e cila mund të realizohet vetëm në pozicion pasfoljor dhe mund t'i paraprijë (1a) apo të ndjekë kundrinorin e drejtë (1b):

- (1) a. *po gjitet punë Beni, Ana do të fillojë studimet*
- b. *po gjitet Beni punë, Ana do të fillojë studimet*
- c. **po Beni gjitet punë, Ana do të fillojë studimet*

- (2) a. *po tē mbyll sytē unē, le tē bējnē ɔ'tē duan*
 b. *po tē mbyll unē sytē, le tē bējnē ɔ'tē duan*
 c. **po unē tē mbyll sytē, le tē bējnē ɔ'tē duan*

Me lindhëzën *po* mund tē ndërtohen lokucionë lindhëzore kushtore *po qe se, po qe që, po tē jetë se dhe po tē jetë që*, tē cilat kombinohen me folje nē mënyrën dëftore dhe më rrallë nē kushtore. Këto lindhëza nuk ua kushtëzojnë rendim përbërësve, siç ndodh me elementin *po*, që vendos një lindhje tē caktuar me foljen dhe për më tepër, kërkon që kryefjala *fi* prapavendoset foljes. Përkundrazi, në ndërtimet me lokucionë kushtore *po qe se/që e po tē jetë se/që*, kryefjala del nē pozicionin e vet tē zakonshëm, pra, para foljes:

- (3) a. *po qe se Lindita e kapton gabimin, unë do ta fal*
 b. *po tē jetë se Lindita do tē vijë me ne, ma thuaj*

Le tē ndalojmë tanë tek lindhëza *sikur*. Kombinohet vetëm me folje nē mënyrën lindhore, por ndryshe nga elementi *po*, kjo lindhëz lejon edhe shfaqjen e kryefjalës nē pozicion parafoljor, siç déshmohet në shembullin (4a).

Mundësitet e tjera tē shfaqjes së kryefjalës paraqiten nē (4b), ku kryefjala vjen pas foljes, por i paraprin kundrinorit tē drejtë dhe nē (4c) ku i prin kryefjalës, e cila del nē pozicionin fundor të frazës:

- (4) a. *Sikur punëtori ta dinte atë rrrezik, do tē ishte larguar nga ai vend*
 b. *Sikur ta dinte punëtori atë rrrezik, do tē ishte larguar nga ai vend*
 c. *Sikur ta dinte atë rrrezik punëtori, do tē ishte larguar nga ai vend*

Le tē vijnë tanë tek lindhëza kushtore nē. Del me format foljore tē mënyrës dëshirore (5) apo tē mënyrës dëftore (6). Ashtu si lindhëza *po*, edhe ajo kërkon tē vendos një lindhje tē caktuar me foljen. Për këto arsyë kryefjala e fjalisë kushtore mund tē shfaqet vetëm nē pozicionin parafoljor, e ndjekur (5a) apo e paraprirë nga kundrinori i drejtë (5b).

- (5) a. *Në e pranofsi Iliri gabimin, ne do ta falim*
 b. *Në e pranofsi gabimin Iliri, ne do ta falim*
 c. **Në Iliri e pranofsi gabimin, ne do ta falim*

- (6) a. *Në e di, ma thuaj!*
 b. *Nuk e kuptova nē tallej apo fliste seriozisht*
- (7) a. *Nëse kjo skuadër e fiton kampionatin, trajneri nuk e jep dorëheqjen*
 b. *Nëse e fiton kjo skuadër kampionatin, trajneri nuk e jep dorëheqjen*
 c. *Nëse kampionatin e fiton kjo skuadër, trajneri nuk e jep dorëheqjen*

- (8) *Nëse Lindita, duke shëtitur, do ta takonte Mirën, më thuaj qoftë se. Kombinohet me foljet e mënyrës dëftore dhe kushtore.*
 (9) a. *Në qoftë se do tē shkoja me pushtime, nuk do tē më mbetej asnjë lek*
 b. *Në qoftë se Lindita nuk do tē vinte me mua, do tē niseshi vend*

Ky lokucion lindhëzor nuk kërkon ndonjë lidhje tē vegantë me foljen, prandaj kryefjala e fjalisë kushtore mund tē dalë lirishët edhe në pozicionin parafoljor, siç shihet në (9b).

10.1. Struktura e frazës kushtore

Sig e kemi parë, vendi i kryefjalës në fjalitë kushtore nuk është gjithnjë ai i zakonshmi, parafoljor. Gjatë përdorimit tē disa lindhëzave kushtore, kryefjala mund tē dalë edhe në pozicionë të tjera.
 Le tē shohim nga se varet kjo alternativë sintaksore, duke u nisur nga analiza e frazës që ka si mjet lindhës elementin *po*.

Veçoria kryesore e këtij elementi, siç pamë në shembujt (1-2), është lidhja e veçantë e tij me foljen, qka do të thotë se kryefjala e fjalisë kushtore nuk mund të dalë në pozicion parafoljor, por duhet ta ndjekë atë. Nëse kjo fjali ka në përbërjen e saj edhe një kundrino r t drejtë, atëherë rendi i përbërësve t saj do t jetë: Kallëzues-Kundrino-Kryefjalë dhe Kallëzues-Kryefjalë-Kundrino.

Kushtëzime t tilla hasim edhe në ndërtim t tjetra, si për shembull, në fjalitë pyetëse, ku kryefjala nuk mund t dalë në pozicionin e saj t zakonshëm, para foljes, por vërem mund ta ndjekë atë:

- (10) a. **kur Beni (e) lexoi librin?*
- b. *kur e lexoi Beni librin?*
- c. *kur e lexoi Beni librin?*

Pozicioni fundor i kryefjalës (10b) është pasojë e drejtëpërdrejtë e ngritisë së foljes nga pozicioni fleksional *Infl* drejt atij *Foc°*, një lëvizje e detyrueshme për strukturat pyerëse që kushtëzohet nga ajo çfarë Rizzi (1991) e përkufizon si parimi *Wh (Wh-Criterion)*.


Me ngritjen e foljes në pozicionin *Foc°* shpërbëhet edhe paraqitura Spec-Kokë mes kategorisë së fleksionit *Infl* dhe specifikuesit t tij, aq e nevojshme për përcaktimin e kryefjalës dhe shërimin e rasës emërore t saj brenda përbërësit IP. Pra, kryefjala nuk ngrihet në pozicionin e Specifikuesit, por mbetet në brendësi të sintagmës foliore VP.

Frazat kushtore që kanë në përbërje t tyre elementin *po* shfaqin deri diku t njëjtat kushtëzime: përshtatje e detyrueshme mes elementit kushtor dhe foljes.

- (11) a. *po gjeti punë Beni, Ana do t fillojë studimet*
- b. *po gjeti Beni punë, Ana do t fillojë studimet*
- c. **po Beni gjeti punë, Ana do t fillojë studimet*


Është e mundshme që edhe në fjalitë kushtore folja t ngrihet drejt një pozicioni më t lartë, lëvizje e cilë shpërbën paraqiten mes kokës *Infl* dhe kryefjalës në pozicionin e specifikuesit t kësaj sintagme, duke e detyruar kryefjalën t qëndrojë në brendësi të sintagmës foliore VP. Le t shohim më nga afér q vend zënë elementet përbërës t fjalisë kushtore. Duke qenë se lidhëza *po* i paraprin një fjalë kushtore, që ka në përbërjen e saj një folje të shtjelluar, tiparet e saj lindhen si me

pozicionin më t lartë, *Force*, ashtu dhe me pozicionin *Fin. Po-ja*, duke qenë një element i klasës së komplementuesve, gjenerohet në *Force°*, ndërsa folja, pasi ngrihet në pozicionin *Infl* për t kontrolluar tiparet e kohës, vetës dhe t numrit, zhvendoset drejt pozicionit *Fin°*, për t u vendosur pranë *po-së* e më pas ngrihet në mënyrë abstrakte drejt pozicionit *Force°* për t realizuar përshtatjen me tiparet e kategorisë *Force*. Si pasojë e kësaj lëvizjeje, prishet konfigurimi i përshtatjes mes kokës *Infl*, si shënues i rasës, dhe kryefjalës si specifikues. Kështu, kryefjala mbetet brenda sintagmës VP. Në rastin e shembullit (11a) kryefjala ndodhet në pozicionin e një adjunkti brenda sintagmës foliore VP. Kështu, struktura e frazës (11a) do t paraqitej si më poshtë, në (12).




Të vihet re se në (12) fjalia kushtore zë vend në t majtë t fjalisë kryesore. Por mund të kemi edhe rendin e përbysur, pra pjesa kryesore t'i paraprijë asaj t varur kushtore si në shembullin e mëposhtëm:


- (13) *Ana do t fillojë studimet, po gjeti punë Beni*
Në këtë rast fjalia kushtore, që ruan t njëjtën strukturë t brendshme si ajo e paraqitur në (12), do t zëre vend në t djathë t fjalisë kryesore:




përshtatjes mes foljes dhe kryefjalës, e cila mund t'i shtohet sintagmës follore VP, si në (16) ose të qëndrojë në pozicionin e saj fillestar, si në (17).




Te fraza (11b) kemi rend linear që tregon se kryefjala mbetet brenda sintagmës follore VP, në pozicionin e saj fillestar:



(16)




(17)



(18)

Kur elementi kushtor *po* përdoret me një folje në lidhore, kemi të njëtin derivim, me përjashtim të faktit se pjesëza *tē* e lidhore, pasi realizon kontrollin e tipareve të mënyrës M, zhvendoset dukshëm në pozicionin Fin°. Folja e shtjelluar do ta realizojë këtë zhvendosje vetëm në mënyrë abstrakte. Edhe në këtë rast shpërberëhet paraqitja e

Astu si elementi *po* sillët edhe lidhëza kushtore *në*, e cila kërkon detyrimisht përputhje me foljen. Struktura e frazave që kanë *në* përbërje këtë element, mund të paraqitet si në (12) e (15). Për sa i përket mjetit lidhës *sikur* pamë që ky nuk vendos asnjë kusht lidhur me foljen, pra kjo qëndron në pozicionin I° kurse kryefjala realizohet në SpecIP¹, dhe një frazë e tillë si në (4a) do të analizohet kështu:




Kur kryefjala vjen pas foljes dhe i paraprin kundrinorit të drejtë (4b), kemi një strukturë ku kryefjala mbetet brenda sintagmës follore VP:



Rendi sipërfaqësor Kallëzues-Kundrinor-Kryefjalë i paraqitur në (4c) është rezultat i shtimit të kryefjalës në VP:

(20)



Në të nijëtën mënyrë sillët lidhëza kushtore *nëse*; në ndërtimet me këtë lidhëz, kryefjala mund të dalë në pozicion parafoljor dhe të ketë një paraqitje si në (18), mund ta kenë kryefjalën në një pozicion parafoljor dhe t'i paraprijë kundrinorit të drejtë, si në (19); apo të kenë një kryefjale që vjen pas kundrinorit të drejtë si në (20).

Së fundi le të ndalojmë tek lokacionet lidhëzore të tipit *po qe se, po të jetë se, në qofë se*. Edhe në ato ndërtime që kanë si injete lidhëse këto lokacione lidhëzore, kryefjala mund të zërë pozicione të ndryshme lidhur me foljen, në varësi të shprehjes së elementeve topik, fokus.


Në varësi të pozicionit që zë në frazë, kryefjalën mund ta shohim të shfaqet brenda sintagmës follore, si adjunkt i saj, ose të zhvendoset drejt periferisë së majtë të frazës.

Lidhur me lokacionet lidhëzore, duhet thënë se është e vështirë t'i shohim ato si koka sintagnash, thënë ndryshtësi elemente X°, por ka gjasa të sillen si një sintagnë e tërë.

Duke qenë se nuk mund të mohohet natyra e tyre kushtore, dhe shërbëjnë për lidhjen e fjalive kushtore me pjesën tjeter në frazë,

¹ Për ta thjeshtuar analizën, po japim paraqitjen më të thjeshtë të foljes në lidhore, duke mbajtur kategorinë fleksionale IP, në vend të asaj më të ndërtuar MoodP.

atëherë i shohim ato në vendin e specifikuesit të sintagmës ForceP, si në shembullin e imposhtëm (21):



PASKAJORJA DHE NDËRTIMET ETJERA FOLJORËTË PASHTJELLUARA

11.0. Ndërtime të varura formash follore të pashtjelluara

Format follore të pashtjelluara në gjithën shqipë ndërrohen mbi bazën e pjesores, e cila e shoqëruar me formante si: *për*, *në*, *duke*, *me*, *një*, *pa etj.*, përfiton ndërtime të veçanta me vlerë paskajoreje, përcjellore, mohore etj. (*ardhur*: *për tē ardhur*, *duke ardhur*, *me tē ardhur*, *një tē ardhur*, *pa ardhur etj.*). Interes të vegantë paraqesin jo vetëm trajtë e shqipes standarde, por edhe ato të dialektit *gëg*¹, gjë që na shtyn t'i shohim ato në përgjasje me njëra-tjetrën.

¹ Shembijt që do të matrim në analizë, i përkasin variantit të gegëzishës veriperëndimore.

Këtu po ndalojmë në mënyrë të vëgantë tek të ashtuquajtura paskajore, të cilat nuk kanë shtrirje dhe vlerë të njëjtë përdorimi në dy variantet dialektore të shqipes.

Forma e toskërishtes (që shërben si normë në gjuhën standarde) *për+të+pjesore* (p.sh. *për të ardhur*), e cila është quajtur "formë analitike follore me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara"², ka një shtrirje më të gjëre por funksione më të kufizuara se forma homologe e saj në dialektin geg *me+pjesore* (p.sh. *me ardh*), e cila përmbrush të gjitha funksionet që kryen paskajorja në një sërtë gjuhësh të tjera.

11.1. Përqaqje ndërtimesh mes paskajoresh standarde dhe asaj gege

Për nga ana ndërtimore si paskajorja standarde ashtu dhe ajo gege kanë në përbërje të tyre formante me prejardhje paraçhalore, përkatesisht *për të* dhe *me*, të cilat sot i gjëjmë të çsemantizuara, siç ndodh edhe në gjuhë të tjera si anglishtja, gjermanishtja etj. Por le të ndalemë tek shtrirja e përdorimit të tyre.

Duke vënë përballë fraza të njëjta, mes të cilave këmbejmë herë paskajoren standarde dhe herë atë gege, vëmë re se në varësi të përzgjedhjes përfitojmë ose jo ndërtime gramatikore. Le t'u referohemi shembujve të mëposhtëm:

- (1) a. *Po shkoj në bibliotekë për të marrë një liber*
b. *Po shkoj n'bibliotek me marr nji liber*
c. *Po shkoj n'bibliotek per me marr nji liber*

Ndërtimet në (1) janë kryesisht fraza me kuptim qëllimor³ dhe të dy variantet, si ai standard (1a) dhe ai geg (1b-c), janë gramatikore. Por, po t'u referohemi si frazave argumentore (2a), ashtu dhe ndërtimeve me folje gjysmëndihmëse (2b, c) vëmë re se përdorimi i paskajoresh standarde sjell ndërtime jogamatikore:

- (2) a. **Mendoj për t'u nisur herët*
b. **Ai nuk duhet për të folur*
c. **Ata nuk mund për të ardhur nesër*

Shembujt e sjellë në (2) dëshmojnë pamundësinë e përdorimit të paskajoresh në ndërtimë të caktuara strukturore. Këtë mangësi, shqipja standarde e plotëson me përdorimin e formave të shqitelluara të lidhore:

- (3) a. *Mendoj të nisem herët*
b. *Ai nuk duhet të flasë*
c. *Ata nuk mund të vijnë nesër*

Nga ana tjetër, paskajorja gege, ashtu si gjegjësja e saj në shumë gjuhë të tjera, zë vendin e vet në struktura të tilla duke na dhërië ndërtimë gramatikore si më poshtë:

- (4) a. *Menoj m'u nis herët*
b. *Aj nuk duhet me fol*
c. *Ata nuk munen me ardh nesër*

Duhet përmendur se ndërtimi *me+pjesore* del edhe me trajtat e së shkuarës:

- (5) a. *Asht dashi mas me pas fol*
(Duhej të mos kishe folur)
- (6) a. *Po me ra shi, mas dil*
(Po të bjerë shi, mos dil)

- b. *Me pas ardh dje, ishim pa*
(Po të kishe ardhur dje, do të ishim parë)

11.2. Ndërtimë të tjera formash follore të pashtjelluara

Si në shqipen standarde, ashtu dhe në gëgërishtë, krahas paskajoresh, hasin edhe forma të tjera follore të pashtjelluara rrëth statusit të të cilave janë dhëni mendime të ndryshme.

² Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 2002, fq. 339.

³ Përveç ndërtimeve me funksion qëllimor, njihen dhe ndërtime me funksion përcaktor, krvefalor. krahasues eti. Për më tepër. shii: Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002.

Po të vështrojmë mënyrën e ndërtimit të tyre, shpeshherë gjiejmë në përbëje të tyre formante të shprehura kryesisht me parafjalë. Këto të fundit jo gjithnjë janë çsemantizuar plotësisht, si në rastin e parafjalës *pa*, e cila, përvëç rasteve kur paraprin një emër si në (7), edhe kur paraprin një pjesore foljeje, ruan kundërvënien kuptimore me parafjalën *me*.

- (7) a. *me shku(e) me pritesë*
(të shkosh me përtesë)
- b. *me shku(e) pa pritesë*
(të shkosh pa përtesë)

Në (7a) parafjala *me* del në ndërtimin foljor të paskajores *me shku(e)* dhe, së dyti, e lidhur me emrin *pritesë*. Në (7b), në vend të saj është përdorur parafjala *pa*, e cila krijon kundërvënien kuptimore me të parën.

Nuk mund të bëhet fjalë për një kundërvënje mirëfilli kuptimore mes ndërtimeve foljore të pashtjelluara me parafjalët *me* dhe *pa*, por sidoqoftë në disa struktura të veçanta ajo del e pakundërshtueshme si më poshtë :

- (8) a. *me t'ardh keq*
(për të ardhur keq)
- b. *pa t'ardh keq*
(pa të ardhur keq)

Ashu si në rastin e paskajores gege, edhe ndërtimi mohor ndëronton një kohë të shkuar si (9a) dhe mund të shoqërohet edhe nga parafjala *për*, prania e së cilës jo gjithnjë është e domosdoshme (9b):

- (9) a. *Pa pas la shpin, mas dil*
- b. *Per pa ken i madh, mir foli*

(Edhe pse nuk ishte i madh, mirë foli)

Krahas parafjalëve të sipërpërmendura, haset gjithashstu edhe përdorimi i parafjalëve *në* dhe *më* në disa ndërtime të veçanta foljore që jepin kuptimin e një procesi të papërfunduar:

- (10) a. *Në të zbardhur* të ditës
- b. *Në të dalë* të fshatit
- c. *Më të këpultur* e sipër

Në kontekste analoge me to mund të gjiejmë gjithashstu edhe përdorimin e parafjalëve *me* dhe *pa*, të cilat deri tanë i pamë të ndjekura nga një pjesore foljeje:

- (11) a. *Me të marrë vesh*, u nis
b. *Pa hequr keq*, s'fitohet

Përvëç parafjalëve, në kontekste të ngjashme gjiejmë edhe përdorimin e një formanti të shprehur me anë të nyjës së pashquar *një*, i cili, i përdorur në kontekste foliore, ndihmon në dhënien e kupimit të kryerjes së menjëhershshme të veprimit:

- (12) a. *Një të mbërritur*, ia filloi punës
b. *Nji t'ardhme*, kam me ia thanë
(Sapo të vijë, do t'ia them)

Po ashtu, nuk mund të lihet mënjanë rasti i përcjellores i formuar nga *duke + pjesore* (13a), apo i ndërtimeve me emra prejfoljorë asjanës, si në (13b):

- (13) a. *Është duke rënë telefonin*
b. *Pushoi së rënë telefonin*
- Të gjitha këto ndërtime që u përmendën më lart meritorinë një vëmendje të veçantë për sa i përket ndërtimit strukturor.
- Pjesët përbërëse të këtyre ndërtimeve, si pjesore foljeje, emër prejfoljor, parafjalë apo nyjë, shërbuinë si një e tërë, por natyrish kërkijnë një analizë të detajuar, ku secili formant të etiketohet brenda kategorisë së cilës i përket.
- Për këtë arsy, do ti referohemi analizës së strukturave me sintagmë komplementuese (CP) të zgjeruar, të cilën e kemi përdorur edhe në krerët paraardhës.


11.3. Analiza strukturore e formave follore të pashtjelluara

Si duhet paraqitur struktura e formave të pashtjelluara follore të analizuara deri më tanë? Siç e dijmë tashmë, folja zë disa pozicione në strukturën e frazës.

Konkretnisht, në skajin e djathë të saj, pra në pozicionin më të ulët V^o , zë vend forma bazë e foljes, ndërsa në të majtë shtrihen veçoritë e ndryshme që mbart ajo.

Në pozicionin I^o (fleksional) gjjejmë tiparet fleksionale, ndërsa në një pozicion më lart M^o (Mënyra) realizohet nyja $të$ e mënyrës lidhore :

- (14)
- $të marrësh$*




Duke qenë se pozicioni i elementit të lidhores $të$ është ai i kokës së sintagmës së mënyrës M^o si në (15), atëherë në një ndërtim të tillë si:

- (16)
- $me të marrë çantën doli$*

vendi i formantit *me* duhet të jetë në një pozicion më të lartë në strukturën e kësaj fraze. Siç e kemi parë tashmë, Rizzi (1995) propozon një strukturë mjaft të artikular për sistemin komplementues, ku mund të gjenë vend edhe këto elemente të analizës sonë.


Kështu, në të majtë të pozicionit MP projektohet një sintagmë, kokë e së cilës është Fin^o :



Siq thamë më lart, gegërishtja përdor trajtën *me + pjesore* për ndërtimin e paskajores:

- (18)
- Doli jasht me marr pak ajer*

Paraqita e kësaj strukturre do të ishte me foljen *marr* në pozicionin filletar V^o , pasi ajo nuk është e veshur me formantë të fleksionit dhe me elementin *me* në pozicionin *Fin^o*, si në (19):



Dimë gjithashtu se paskajoria gege mund t'i ketë të shprehura njëkohësisht dy formante *për* dhe *me* ku përdorimi i të parit është fakultativ, ndërsa i dyti është i domosdoshëm:

- (20)

- a. *Doli jasht per me marr pak ajer*
- b. *Doli jasht per *(me) marr pak ajer*
- c. *Doli jasht (per) me marr pak ajer*

Në (20a), shohim përdorimin e formantit *per*, veç atij *me* për ndërtimin e paskajores së foljes *marr*. Ndryshe nga gegërishtja, shqipja standarde e ndërtton paskajoren me komplementet *për+është+pjesore* (*për të marrë*).

Nga përqaja e kësaj trajtë follore me formën *gege per+me+pjesore* (p.sh. *per me marr*), vëmë ne se formanti *për/per* qoftë në paskajoren standard apo në atë gege nuk është i pajtueshëm me komplementesin *që*:

- (21)


- a. Doli jashtë **që pér të marrë* pak ajer
- b. Doli jasht **çì per me marr* pak ajer

Këto fraza janë jogramatikore për shkak të pranisë së dy elementeve që duket se mbartin të njëjtat vëgori strukturore, *që – pér*. Mëjanimi i njërit prej tyre, siç mund të vihet re dhe nga shembujt e sjellë më lart,


siguron gramatikalitetin e frazës. Kjo është një ndër treguesit që na shihyn të mendojmë se kemi të bëjmë me të njëjtën kategorji si në rastin e komplementuesit që dhe për formantin *për/per*, prandaj pozicioni i këtyre të fundit mund të jetë ai i Force^o, i projektuar në të djathë të sintagmës FinP.

Për analizën e këtyre strukturave duhet mbajtur parasysh se ato kanë formante të ndryshme (*të-me*) në përbëjen e tyre, prandaj edhe paraqitja struktureore nuk mund të jetë e njëjtë.

Kështu, në rastin e paskajoresh standardë, formanti *të* ndodhet në pozicionin kokë të sintagmës së mënyrës MP, si në (22):



Ndryshe nga varianti i paskajoresh standardë *për+ë+piesore*, që aktivizon pozicionin M^o për formantin *ë*, paskajorja geje *per+me+piesore*, aktivizon pozicionin Fin^o (23), për formatin *me*, ndërkohë që për të dy ndërtimet formanti *për/per* realizohet në pozicionin Force^o:



Për ndërtimin e formave të pashtjelluara në shqipe mund të shërbijnë edhe formante të tjera si p.sh. elementi *një*, i ndjekur nga foja në lidhore:


- (24) a. *Një të marrë çantën*, doli.
 b. *Nji t'marr*, çanten doli (geg.)
- Po ashtu, përdorim të gjërë ka formanti mohues *pa*, i cili përdoret rëndom si në shqipem standarde dhe në variantin geg:

- (25) a. *Pa marrë çantën mos dil*
 b. *Pa marr* çanten mos dil (geg.)

Interes të veçantë paraqesin edhe disa ndërtime me formante të tillë, si *pa/në/më+ë+piesore*:

- (26) a. *Pa hequr keq, s'fitohet*
 b. *Erdhi në të perënduarat* të diellit
 c. *Është më të këputur e sipër*

Duke parë marriëdhënien që ndërtojnë me pjesën tjeter foljore, mund të themi se këto formante realizohen në pozicionin Fin^o, siç dëshmohet në skemën e mëposhtme:



Nga kjo analizë dalim në përfundim që formantet *me dhe për të që* shërbjnë përkatesisht për formimin e paskajoresh geje dhe të shqipes standarde nuk zënë të njëjtin pozicion brenda kësaj strukture, pasi e para projektohet si kokë e sintagmës FinP, ndërsa e dyta, duke qenë në

përndarje plotësuese me komplementesin, zë vendin e këtij të fundit si kokë e sintagmës ForceP.

Elementi *rë* projektohet si kokë e sintagmës së mënyrës MP, ndërsa formante të tillë si: *pa, një, në, më*, i gjëjmë, ashtu si formantin *me*, të projektohen në Fin^o.

12

FRAZA RELATIVE

12.0. Mbi konceptimin e frazës relative

Në frazat relative fjalia e varur ndërtohet dhe shërben si modifikues, sqarues apo shtjellues i një fjale apo sintagme që del në krye të saj. Kjo e fundit rimerret nga fjalia relative me qëllim që të identifikohet, sakrësohet, shtjellohet, apo për dhënien e një informacioni shtesë rrëth kupimit që ajo mbart:

- (1) a. Vajza që hyri në klazë, quhet Ana
- b. Mali i Dajtit, i cili ndodhet në lindje të Tiranës, kishte gdhirë me dëborë
- c. Kush punon fiton

Frazat e paraqitura në (1) janë fraza me fjalë të varur relative. Ato shfaqin disa karakteristika të vecanta që i bëjnë të dallohen qartë nga llojet e tjera të frazave.

Fjalitë relative duhen parë të lidhura ngushtë me kuptimin leksikor dhe gramatikor të fjalëve apo të sintagmave të caktuara. Kështu, në frazat e mësipërme, fjalë *vajzë* dhe sintagma *mali i Dajtit* realizojnë lidhje të veçantë me fjalinë relative përkatëse, pavarësisht nga lloji të saj. Ajo jep një informacion të caktuar rreth kuptimit të fjalës me të cilën realizon këtë lidhje. Për sa i përket rendit, ajo duhet të ndjekë këtë sintagmë, të cilën po e emërtojmë *kökë relative*.¹

Mes fjalisë relative dhe kokës së saj duhet të realizohet procesi i relativizimit, qëka nënkupton procesin e modifikimit, sqarimit, shfjellimit të një sintagme, me anë të një fjalie që e njeh këtë sintagmë si pjesë të sajën.

Kjo do të thotë se ekziston një lidhje modifikimi e vërtetë vetëm nëse brenda fjalisë relative ekziston një element i caktuar, qoftë ky i shprehur ose jo, i cili mund të njësohet me fjalën apo sintagmën që relativizohet, në të kundërt nuk mund të bëhet fjalë përfraza relative. Në saj të veçorive strukturore që paraqesin, frazat relative ndahen në dy grupe të mëdha. Mund të quajmë: a) fraza relative ‘normale’ ato illoje frazash në të cilat dallohen qartë koka e fjalisë relative dhe mjeti i lidhjes që realizon lidhjen mes tyre (1a-b) dhe b) fraza relative ‘të lira’, ato illoje relativesh ku koka dhe mjeti i lidhjes janë shkrrirë në një kategori të vjetme (*kush*, 1c). Lloji i lidhjes kuptimore dhe strukturore që realizohet mes kokës dhe fjalisë relative kushtëzon ndarjen e relativeve normale në kufizueset dhe shtuese.

12.1. Dy aspekte themelore lidhur me studimin e frazave relative

Struktura e frazave relative paraqet karakteristika të veçanta, që e bëjnë të dallohet qartë nga llojet e tjera të frazave. Ashtu siç është vëmë tashmë në dukje, lidhja që realizohet mes fjalisë kryesore dhe

¹ Ky është një term teknik i përdorur gjérësisht në studimet gjenerative mbi frazat relative. Për studimin e fjalive përcaktore të shqipes, gjemjë të përdorur termin *paraprijës* por krahas tij janë përdorur edhe terma të tjerrë si *antecedent*, *korrelat* (Floqi 1962), *fjalë mbështetëse* (Totoni 2000), por këto nuk përpunohen plotësisht me termin *paraprijës* pasi përfshijnë një klasë më të gjertë fjalësh.

asaj të varur relative përfshin si mjetet e lidhjes, të cilat realizohen në mënyra të ndryshme (komplementues, përemra dhe ndajfolje lidhore), ashtu dhe fjalët apo sintagmat që shërbejnë si kokë relative. Këto e të tjera elemente që ndihmojnë në realizimin e frazave relative, prej kohësh, kanë zgjuar interesin e gjuhëtarëve, të cilët, shpeshherë, e kanë përqendruar vëmendjen sa tek njëri problem tek tjerrri, por në mënyrë të vecantë, studimi i relativeve është përballur me dy çështje kryesore:

1. *Lidhja*
2. *Modifikimi*.

12.1.1. Çështja e procesit të lidhjes

Ky aspekt ka të bëjë me lidhjen sintaksore që realizohet mes kokës së relatives dhe relativizimit të skajshëm, pra, pozicionit fillestar, argumentor të saj, në të cilin i është shënuar dhe roli tematik. Koka e relatives duket se kryen një rol të dyfishës në strukturën e frazës. Nga njëra anë, ajo përshtatet në rasë me foljen kallëzues të fjalisë kryesore, dhe kjo bëhet e qartë në gjuhët që kanë shenjues rase të dukshëm, siç është rasti i shqipes, rumaniшtes, gjermanishtes, polonishtes etj., gjuhë në të cilat vihet re përshtatja sipas treguesve të ndryshëm gramatikorë mes kokës së relatives dhe foljes kallëzues të fjalisë kryesore.

Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:

- (2) Çështja *për të cilën* po diskutojmë, nuk është aq e thjeshtë
Në (2), koka e fjalisë relative çështja rimerritet në këtë fjalë nga përemri lidhor i shoqëruar me parafjalën *për të cilën*). Ky i fundit u përgjigjet kërkessave të foljes kallëzues *po diskutojmë* me anë të shenjuesve të rasës kallëzore. Duke parë këtë lidhje që realizohet mes kokës relative dhe foljeve kallëzues të fjalive kryesore dne asaj të varur relative, shtrrohet pyetja: -Cila nga këto dy folje i ka shënuar rolin tematik kokës relative, pra, cili është pozicioni fillestar, argumentor në të cilin ajo është gjenuerar?

12.1.2. Çështja e procesit të modifikimit

Një aspekt i dytë mjaft i rëndësishëm është ai i modifikimit. Ndërkojë aspekti i lidhjes shtron problemin e përcaktimit të vendit të gjenerimit të kokës relative, aspekti i modifikimit kërkon të shpjegohet lidhja që realizohet mës kokës relative dhe tërë fjalisë relative që e modifikon atë.


Kështu, po t'i referohemi frazës (2), vëmë re se fjalia relative hyn në lidhje të veçantë me kokën relative *çështje*. Fjalia relative lind si modifikues i kësaj fiale. Pyetja që shtrohet ka të bëjë me mënyrën e realizimit të procesit të modifikimit.

Në lidhje me këtë çështje, studimet janë orvatur kryesisht të përcaktojnë llojin e kategorisë sintaksore të vetë fjalisë relative. Një ndihmës të veçantë ka sjellë analiza e konceptuar nga Kayne-i (1994, *Raising Analysis*), i cili propozon *ngritet e kokës relative*.

Sipas kësaj analize, koka e relatives lind brenda fjalisë relative dhe më pas lëviz duke u ngritur drejt periferisë së majtë të frazës. Determinanti që shihet i lidhur me kokën relative nuk e shoqëron atë në lëvizjet brenda frazës. Ai gjenerohet jashtë fjalisë relative dhe realizon përzgjedjen e kësaj të fundit.

Pra, determinanti është i jashtëm dhe nuk formon një përbërës me kokën relative, por kjo e fundit sillet si komplement i determinantit (Kayne 1994):

[DP D° CP]



Duke vjuar në hulinë e kësaj analize, do të përiqemi të sjellim analizën e frazave relative kufizuese të shqipes.

12.2. Fraza relative kufizuese

Me frazë relative kufizuese kuptojmë atë lloj fraze ku fjalia e varur ka si funksion të saj kryesor të individualizojet, të kufizojë nga tërësia e bashkësisë së fyrmorëve, sendeve apo dukurive që u referoheni, një fyrmor, send, dukuri, apo një lloj a grup brenda tyre i cili përfaqësohet, jejet nga koka relative, e cila zë vend në krye të kësaj fjalie.

Në këto fraza, koka relative nuk është një fjalë me kuptim të diferencuar, prandaj ndien nevojën e pranisë së fjalisë relative, e cila e përmbrush këtë funksion.

- (3) a. *Libri që lexova dje, më pëlqeu shumë*
- b. *Studentët që erdhën me vonesë, u larguan*

Në (3a) kemi të bëjmë me një frazë që përfshin brenda saj fjalinë relative, e cila i referohet fjalës *liber*. Ky i fundit shërben si kokë relative. Lidhja që realizohet mes tyre është një lidhje e fortë kuptimore, me anë të së cilës synonet individualizimi, vecimi nga e gjithë bashkësia e mundshme e librave.

Këtë funksion e kryen fjalia relative kufizuese. Jo të gjithë librat më pëlqyen, por vetëm libri *që lexova dje*. Koka relative në (3a-b) është shprehur me emër të përgjithshëm, por ajo mund të shprehet gjithashtu edhe me një emër të përvëcëm (4a), sintagmë (4b), përemër (4c), numëror (4-d):

- (4) a. Nuk je *Ana* që kam njohur vite më parë
- b. *Tifa dallëndyshesh* që mbërrin nga larg, deshmonin ardhjen e pranverës
- c. Pyet *ndonjë* që mund të takosh atje
- d. Dy që pashë unë, ishin ende aty

Ashtu si koka relative, edhe mjeti lidhës, i cili është një element i rëndësishëm i këtyre ndërtimeve, njeh mënyra të ndryshme të shprehur. Si i tillë shërben komplementuesi *që*, përdorimin e të cilit e

pamë më lart, por edhe njete të tjera, si përemri lidhor *i cilë/e cila* (5-a), ndajfolja lidhore (5c-d), të shoqëruar ose jo me parafjalë.

Për të parë konkretisht realizimin e tyre, le t'u referohemi shembujve të mëposhtëm:

- (5) a. Studentët *të cilët* nuk janë regjistruar, nuk mund ta jepin provimin
 - b. Çështja *për të cilën* po diskutojmë, na përket të gjithëve
 - c. Vendi *për/nga kur* ishin nisur, ndodhë shumë larg
 - d. Nuk u kujtohej ajo ditë *kur* qenë takuar për herë të parë
- Një element tjetër kyç i ndërtimeve relative është dhe komplementi, që ndodhet pranë (*ajo ditë* (5d)) apo i trupëzuar me kokën relative (*çështja* (5b), *vend-i* (5c)). Për rolin e tij si përzgjedhës i fjalës relative, do të ndalemri gjatë analizës së këtyre ndërtimeve.

12.3. Analizë e frazave relative kufizuese

Siq u theksua më lart, lidhja mes pjesëve përbërëse të frazave relative mund të realizohet me anë të komplementesit *që*, të përemrit lidhor *i cilë/e cila* apo të ndajfoljeve lidhore *kur, ku*.

Përdorimi i tyre është i kushtëzuar nga veçori të caktuara të frazave dhe, në të njëjtën kohë ndikon në formësimin dhe organizimin e tyre, duke i shndërruar në fraza me veçori strukturore të ndryshme nga njëra-tjetra.

12.3.1. Relativet kufizuese me mjet lidhës komplementuesin ‘*që*’

Studime dhe analiza te ndryshme i shohin relativet normale të ndara në dy grupe kryesore, në bazë të mjetit që realizon lidhjen mes tyre dhe paraprijësit: relativet *Wh-* (emërtim që zë fill nga fjaltë lidhëse *which, who, whom, what, where* të anglofikës) dhe relativet *-that* (me mjet lidhës komplementuesin *që*).

Lloji i mjetit të lidhjes që përdoret, pra komplementues apo përemr lidhor, kushtëzon dallime të rëndësishme strukturore jo vetëm mes relativave shituuese dhe kufizuese, por edhe brenda llojit të këtyre të fundit.

Përveç mjetit të lidhjes, një element i rëndësishëm i këtyre strukturave është dhe komplementi që përzgjedh fjalinë relative. Pozicioni i tij në lidhje me kokën relative në sintaksën e shfaqur, përbën një parametër jo pak të rëndësishëm për strukturën e relativeve.

Le të jetë ky pozicioni një ndër argumentet kyç të analizës së mëposhtme mbi relativet kufizuese që kanë në përbëjen e tyre komplementuesin *që*.

12.3.2. Determinanti i *prin kokës relative*

Ashtu siç është vënë në dukje më parë, shfaqja e determinantit si para, ashtu dhe pas fjalës, është një ndër parametrat që karakterizon gjuhën shqipe duke e bërë të dallueshme atë nga shumë gjuhë të tjera si ato latine, gjermanike etj.

Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:


(6) *Vlerëso çdo libër që lexon*

Për realizimin e lidhjes mes pjesëve të kësaj fraze shërben komplementuesi *që* dhe si kokë e relatives emri *liber*.

Në sintaksën e shfaqur, koka relative ndodhet në një pozicion joargumentor A', qëka do të thotë se vendi i shfaqjes nuk përkon me vendin e gjenerimit të saj në frazë. Kokës së fjalisë relative *liber* i shënohet roli tematik nga folja e fjalisë relative *lexoj*.

Duke përdorur terminologjinë e Chomsky-t (1993, 1995), mund të themi se për ndërtimin e frazës (6) janë zbatuar tri rregulla të rëndësishme: rregulla e bashkimit *Merge*, rregulla e përshtatjes *Agree* dhe rregulla e lëvizjes *Move*, krahas rregullës së ngritisë *Raising*, të propozuar nga Kayne-i (1994).

Zbatimi i këtyre rregullave përbën hapat e derivimit që qojnë në sintaksën e shfaqur të kësaj fraze, struktura e së cilës është paraqitur në skemën e mëposhtme:



Në (7) është paraqitur në skemë struktura e frazës (6), tek e cila vilen re qartë hapat e ndryshëm të derivimit. Fjalia relative ForceP, e cila përzgjidhet nga determinanti D° *çdo*, është shprehje e sistemit komplementues. Në të janë projektuar një sintagmë ForceP, pozicionin kokë të së cilës e zë komplementuesi *që*, dhe një sintagmë fleksionale IP, kokë e së cilës është fleksioni foljor.

Falë rregullës *Merge*, folja *lexo* është bashkuar me argumentin e saj të brendshëm *libër*, të cilit i ka shënuar rolin tematik. Nga bashkimi i tyre përfitohet sintagma follore *lexo libër*. Folja *lexo*-është e zhveshur nga fleksioni, për këtë arsyre ajo projekton sintagmën fleksionale, drejt së cilës ngrihet për të marrë shenjuesit e vetës, kohës, numrit etj. Fjala *libër* mbetet në pozicionin filletar, argumentor, në të djathë të foljes.

Si rezultat i procesit të relativizimit, kjo sintagmë emërore ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës dhe nga pozicioni i komplementit të sintagmës follore zë vend në pozicionin e specifikuesit të sintagmës ForceP, e cila është projekzioni më i lartë i sistemit komplementues. Pozicioni i komplementuesit *që* brenda këtij sistemi është ai i kokës së sintagmës Force, pozicion në të cilin gjenerohet dhe shfaqet njëkohësisht.

Në të majtë të sistemit komplementues është projektuar një sintagmë determinante, në pozicionin kokë të së cilës gjenerohet determinanti *çdo*, i cili përzgjedh tërë fjalinë relative. Pra, pavarësisht afarisë që ka

me emrin *libër* në rastin konkret (në sintaksën e shfaqur i gjyjmë pranë njëri-tjetrit), si dhe tipareve emërore që mbartin, ato nuk formojnë së bashku një përbërës.

Koka emërore, pranë determinantit, është në një pozicion joargumentor, ajo formon një përbërës vëtëm me foljen e fjalisë relative, e cila, siç thamë, i shënon rolin tematik. Si komplement i determinantit shërbën e tërë fjalia relative e marrë së bashku.

Koka relative mbetet pjesë e sistemit komplementues, si në pozicionin argumentor të saj, ashtu dhe pas zhvendosjes në të majtë të frazës. Këtë e dëshmojnë dy pozicionet e saj si komplement i sintagmës foliore VP, po ashtu edhe si specifikues i sintagmës ForceP, pas zhvendosjes së saj.

Në këtë frazë fjalia relative e njek fjalinë kryesore. Kjo do të thotë që sistemi komplementues, ForceP ndjek një sintagmë determinantë DP, e cila mban determinantin e jashtëm. Fjalia kryesore zë pozicionin më të lartë në frazë.

1.2.3.3. Determinanti ndjek kokën relative

Në ndër karakteristikat themelore të gjuhës shqipe ka të bëjë me mënyrat e saj të shprehjes, si analitike, ashtu dhe sintetike. Mënyrat e realizimit të determinantit janë shprehje e qartë e kësaj vëgorie që paraqet kjo gjuhë: prania e tij mund të jetë shprehje e formës analitike ose sintetike të fjalës.

Në shembullin e analizuar më sipër, pamë që fjala *liber* shqërohet nga një determinant i cili i paraprinte kësaj fjale: *çdo liber*.

Dimë që, krahas kësaj forme, shqipja njeq dhe forma të tjera të shprehjes së determinantit. Ai mund të vendoset para fjalës: *ky/një liber*, por edhe të trupëzohet me të: *libr-i*.

Determinanti i prapavendosur, edhe pse trupëzohet me fjalen që shërbën si kokë e relatives, nuk formon një përbërës me të, por me tërë fjalinë relative që përzgjidhet prej tij (Kayne 1994).


Për të parë mënyrën e realizimit të ndërtimitve të tillë, le t'i referohemi një fraze si kjo më poshtë, e cila mbart këto karakteristika:

(8) *Muzeu që vizitova më pëlqeu*

Në këtë frazë, si kokë e relatives shërbën emri *muze*, ndërsa si mjet lidhës komplementuesi *që*. Siç shihet, koka relative merrët pa pranimë e determinantit *-u*. Ai, edhe pse trupëzohet me këtë fjalë (*muze-u*), nuk i përket së njëjtës kategoritë emrit.

Koka relative është pjesë e një sintagma emërore, ndërsa determinanti është pjesë e sintagmës determinante. Madje, edhe vendi i gjenerimit të tyre është i ndryshëm.

Nëse determinanti gjenerohet jashtë sistemit komplementues të frazës, në një pozicion më të lartë se ai, koka relative gjenerohet si argument i foljes së fjalisë relative. Ajo lë pozicionin e saj filletar argumentor dhe vendoset në pozicionin e specifikuesit të sintagmës ForceP. Por këtu lind problemi i parametrit që shifra gjuhja shqipe, sepse paraqitja në skemë në këtë fazë derivimi nuk përkon me sintaksën e shfaqur ku determinantin e gjejmë të trupëzuar me fjalën. Le t'i referohemi skemës së mëposhtme:



DP dhe, në pozicionin kokë të saj D°, është gjeneruar determinanti *-u*, i cili përzgjedh fjalinë relative.

Koka relative *muze* ka lindur në pozicionin e saj argumentor si komplement i foljes së fjalisë relative *vizito-* dhe më pas, si rezultat i procesit të relativizimit, është ngritur në të majtë të sistemit komplementues.

Së pari, e tërë sintagma emërore NP, nën veprimin *Move*, nën pozicionin SpecForce₁, por, për shkak të një tipari të fortë morfollogjik, koka *muze* e kësaj sintagme, që ndodhet në pozicionin SpecForcP₁ lëviz përsëri për t'u ngritur në pozicionin D°, ku trupëzohet me determinantin.

Pasi kemi parë gjenerimin e kokës relative brenda sistemit komplementues si argument i brendshëm i foljes së fjalisë relative, kur flasin për zhvendosjen e saj, pra, ngritjen drëjt periferisë së majtë të frazës, duhet të mbajmë parasysh se materiali që ngritet nuk është vetëm koka N°, por e tërë sintagma emërore NP e cila vendoset në pozicionin e specifikuesit të sintagmës ForceP.

Në frazën (7) pamë që koka relative, pasi zhvendoset në pozicionin SpecForce, nuk kryen ndonjë lëvizje tjeter. Kjo shpjegohet me atë që determinanti *qdo*, i vendosur në pozicionin D°, është një fjalë më vete, e shkëputur nga koka relative, e cila, në këtë rast, mund të qëndrojë në një pozicion më poshtë tij dhe konkretisht në SpecForceP.

Përkundrazi, në frazën (8), determinanti *-u* në sintaksën e shfaqur, trupëzohet me fjalën, për këtë arsyë koka relative duhet të kryejë një lëvizje të re.

Kështu, koka emërore N° i nënshtronhet një rregulle të tretë *Move*, e cila vjen si rezultat i kërkesës së rregullës së përshtatjes *Agree*. Kontrolli dhe legjitimia i tipareve emërore të Kokës relative, nga determinanti kërkon që kjo të ngritet në të djathë të tij, ku mund të ushtrohet ky kontroll.

Pra, vëmë re që, nëse në gjuhë të tillë si ato latine dhe gjermanike, që u përmendën më sipër, determinanti mund të qëndrojë i vetëm në pozicionin kokë të sintagmës determinante, në shqipë dhe në ndonjë gjuhë tjeter, në këtë pozicion gjëjmë si determinant, ashtu dhe kokën relative. Pavarësisht kësaj, determinanti është i Jashtë i sistagmës *ForceP₁* qëndron në lidhje me fjalinë relative dhe e nërzpietësh atë si komplementin e saj.

Në skemën (9) janë paraqitur hapat e derivimit të frazës (8). Siç mund të vihet re, kemi të bëjmë me dy sintagma Force: ForceP₁ dhe ForceP₂, ku kjo e fundit ndodhet në një pozicion më të lartë se e para. Në të majtë të sintagmës ForceP₁ është projektuar sintagmë determinante

12.4. Fraza relative shtuese

Me fraza relative shtuese do tē kuptojmë ato lloje frazash qē krijojnë një lidhje tē dobët kuptimore me paraprijësim, duke dhënë një informacion shtesë rrëth tij. Paraprijësi në këto fraza ka një kuptim të përcaktuar qartë; frymori, objektet apo dukuritë qē ai shpreh janë tē dalluara qartë nga klasa ku bëjnë pjesë.

Për këtë arsy, ndryshe nga relativet kufizuese, tē cilat duhet tē shtjellojnë dhe tē vënë nē pah individualitetin e paraprijësit, tek relativet shtuese paraprijësi e gëzon nē vërvete këtë veti, kuptimi i tij është i individualizuar qartë.

Lidhjen me relativen shtuese paraprijësi e realizon me anë tē mjeteve lidhëse tē ndryshme, si: me përemrin lidhor i cili/e cila, ndajfoljet lidhore *ku, nga* dhe *kur* dhe me anë tē elementit qē.

(10) a. Shikimin e kthyen tē gjithë nga Arbeni, i cili rrinte nē këmbë pa folur

b. Ëndërronte tē kthehej sërisht nē vendlindjen e tij, ku kishte kahuar pjesën më tē bukur tē fëmijërisë

c. Dielli, që po fshihej pas malit, hidhë mbi re një pëlhurë tē kuqjërrimit

Ndërимet në (10) janë fraza me fjalë tē varura relative, pasi nē to dallojmë qartë një paraprijës dhe fjalinë e varur relative qē modifikon kuptimin e tij. Po ashtu dallojmë mjetet lidhëse, përkatesisht përemrin i cili/ e cila dhe ndajfoljen lidhore *ku* nē (10a-b) dhe elementin qē nē (10c), tē cilët ndihmojnë nē realizimin e lidhjes mës fjalive tē varura dhei fjalëve qē shërbijnë si paraprijës tē tij.

Të gjitha këto elemente ndihmojnë nē kryerjen e procesit tē relativizimit. Në këto fraza si paraprijës shërbijnë fjalët: *Arben, Dielli* dhe sintagma *vendlindja e tij*. Secila nga këto ka një kuptim të përcaktuar qartë, pra është e vetëmjaftueshme për nga pikëpamja semantikore.

Prania e fjalisë relative pas tij nuk është një nevojë e domosdoshme, pasi ajo na sjell një informacion shtesë mbi kuptimin qē mbart paraprijësi, për këtë arsy ato quhen fjalë relative shtuese.

Për këto karakteristika qē u përmendën më lart, mund tē themi se lidhja qē realizohet mes një fjalë relative shtuese dhe paraprijësit të saj është një lidhje e dobët kuptimore, ndryshe nga relativet kufizuese, që karakterizohen nga një lidhje e ngushtë dhe e fortë kuptimore.

12.5. Analiza e frazave me fjalë tē varur relative shtuese

Studimi i frazave relative shtuese është parë gjithnjë nē një këndvështrim krahasues lidhur me studimin e frazave relative kufizuese.

Çështjet themelore qē janë ngritur nē bazë tē këtij studimi janë tē lidhura ngushtë me reportin semantikor dhe strukturor që vendoset mes këtyre dy llojeve.

Dallimi semantikor, pra ai i formës logjike, pranohet thuajse nga tē gjithë dhe është i pakundërshtueshëm. Frazat relative shtuese shfaqin karakteristika të ndryshme nga ato kufizuese për sa i përkert formës logjike tē tyre. Problemi themelor që shtrohet ka tē bëjë me vëgoritë strukturore tē tyre:

-Ndërtime tē tila kanë strukturë tē njëjtë apo shfaqin tipare tē ndryshme strukturore?

Rezultatet e studimeve tē ndryshme nuk përputhen nē këtë pikë: një pjesë e mirë e tyre arrinë nē përfundimin qē frazat relative kufizuese dhei shtuese dallojnë prej njëra-tjetrës si nē formën logjike, ashtu dhe nē atë strukturore, ndërkohë që pjesa tjeter pranon vetëm dallimin nē formën logjike, duke mohuar dallimin strukturor.

Kujtojmë që Bianchi (1999), nē përgasjen që realizon mes strukturës së relativave kufizuese dhe atyre shtuese, e kundërshton propozimin e Kayne-it (1994). Sipas propozimit nē fjalë, tē dyja këto lloje relatives kanë strukturë tē njëjtë, por ndryshojnë vetëm nē formën logjike tē tyre.

Bianchi, duke u mbëshitetur kryesisht mbi mundësinë ose jo tē rindërtimit të kokës relativë brenda fjalisë relative, pohon që kjo është e mundur për relativet kufizuese, por jo për ato shtuese.

12.5.1. Relativet shtuese me përemra lidhorë

Përzgjedhja e mjetave të lidhjes kërkon vëmendjen e duhur, sepse shpeshherë përdorimi i komplementesit që në vend të përemrit lidhor *i cili* mund të krijojë dykuptimësi kuptimore si në shembujt në vijim:

- Takoi vajzën e një mikë, *të cilën* e njihet prej kohësh
- ?E lodhë shiu i asaj vjeshte që sapo kishte filluar
- E lodhë shiu i asaj vjeshte, *e cila* sapo kishte filluar

Në fraza relative shtuese hasim një përdorim më të gjierë të përemrit lidhor *i/vë cilia* në krahasim me elementin *që*. Le t'i referohemi frazës në vijim:

(12) *Po kërkoja këtë revistë, të cilën ma rekomanduan*

Fraza relative në (12) është e llojit shtues. Sintagma emërore *revistë* shërben si kokë relative, e cila realizon lidhjen me fjalinë relative me anë të përemrit lidhor *të cilën*.

Determinanti *këtë* është i jashtëm në lidhje me fjalinë relative dhe e përzgjedh atë si komplementin e saj.



Hapat e derivimit të kësaj fraze janë si më poshtë: folja *rekomando* është bashkuar me sintagmën emërore *revistë* dhe atë determinante *iz cilën* si rezultat i veprimit të irregullës së bashkimit *Merge*.

Në këtë bashkim *rekomando* *të cilën revistë* foja i shënon rolin tematik komplementit të saj.

Si rrijedhim i procesit të relativizimit, sintagma determinante *të cilën revistë* ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës në pozicionin SpecTop, nga ku sintagma emërore *revistë* ngrihet drejt pozicionit SpecForceP₁, si rezultat i tërheqjes së determinantit *këtë*, i cili është gjenieruar jashtë sistemit komplementues, si kokë e sintagnës determinante DP, që ndodhet në të djathë të këtij sistemi.

Sintagma follore *po kërkoja* është projektuar në periferinë e majtë të frazës.

Këta hapa derivimi të frazës janë paraqitur në skemën e mëposhtme:



Siq mund të vihet re në këtë skemë, hapat e derivimit që qojnë në sintaksën e shfaqur të kësaj fraze relative shtuese janë të njëjtë me ato të nje relativeje kufizuese, determinanti i së cilës i paraprin kokës relative.

Sintagma determinante *të cilën revistë* gjenerohet si argument i foljes së fjalisë relative dhe, më pas, duke i përgjigjur kërkuesave që shtron procesi i relativizimit, ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës.

Sintagma emërore *revistë* duhet t'i nënshtrohet një regulle të re, asaj *Agree*, e cila e zhvendos drejt pozicionit SpecForceP₁, për të realizuar kontrollin e tipareve nën efektin e determinantit *këtë*.

Në sintaksën e shfaqu të kësaj fraze, fjalia kryesore i paraprin sjalisë relative. Për të përfshuar rendin e kundërt, sintagma determinante DP

dhe ajo ForceP₁ do të zhvendoseshin në pozicionin e specifikuesit të sintagmës ForceP₂.

Determinanti që përzgjedh fjalinë relative mund të trupëzohet me kokën relative, sidoqoftë roli i tij në lidhje me fjalinë relative mbetur i pandryshueshëm: ai, gjithsesi, e përzgjedh këtë fjalë, me ndonjë ndryshim të pozicionit të kokës relative në sintaksën e shfaqur.

Nëpërmjet kësaj analize vëmë re që koka e relativeve shtuese, ashtu si dhe tek ato kufizuese, lind brenda sistemit komplementus CP/ForceP dhe më pas zhvendoset drejt periferisë së majtë të frazës. Dallimi qëndron tek mjeti lidhës.

Nëse komplementuesi *që* lind jashtë fjalisë relative si në (9), përemrit lidhor i *cili* i shënohet roli tematik nga folja e fjalisë relative së bashku me paraprijësin e kësaj fjalie në periferinë e djathë të frazës si në shembullin (13).

12.5.2. Relativet shtuese me ndajfolje lidhore

Ashtu si frazat relative kufizuese, edhe relativet shtuese mund të kenë si mjet lidhës një ndajfolje lidhore.

Për të parë se ç'vëgori strukturore paraqesin ato, po marrim në analizzë një prej këtyre ndërtimeve.

Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:

(14) *Fliste për Sarandën, ku ishte rritur*

Në (14) kemi të bëjmë me një frazë relative shtuese. Kokë relative *Sarandë* është një emër i përvëçëm, për këtë arsyё fjalia relative jep vetëm një informacion shtesë rrëth kuptimit të kësaj fjalë.


Për sa i përket sintaksës së shfaqur të frazës (14), dallimi i vetëm që e ndan atë nga një frazë relative kufizuese ka të bëjë me shkëputjen intonacionore që krijohet mes fjalisë relative dhe kokës së saj.

Ajo çfarë meriton të analizohet, është natyra strukturore dhe hapat e derivimit që çojnë në përfimin e kësaj strukturre, të cilët janë paraqitur në skemën e mëposhtme:

Nga një vështrim i përgjithshëm i kësaj diagrame, vëmë re që hapat e derivimit të strukturës së saj nuk janë të ndryshëm nga ai i një fraze

relative kufizuese apo i një shtueseje që e realizon lidhjen mës fjalive përbërëse me anë të komplementuesit *që*.

(15)



Për të studiuar më thellësish këtë strukturë, po e analojmë këtë frazë duke u nisur nga periferia e djathë e saj. Vëmë re që sintagma foliore VP përflohet si rezultat i zbatimit të rregullës Merge, në saj të së cilës realizohet bashkimi i kokës *rritis* të kësaj sintagme me komplementin e saj *Sarandë*, e cila shërben si kokë e fjalisë relative.

Komplementi konceptohet si një sintagmë parafalore, në bazë të marrëdhënieve që ndërtion me foljen *rriti*.

Si rrijedhim i procesit të relativizimit, koka relative *Sarandë* i nënshtronhet një rregulle *Move*, e cila e zhvendos atë drejt periferisë së majtë të frazës, pikërisht në SpecForceP. Në pozicionin kokë të kësaj sintagme Force° është gjeneruar elementi *ku*.

Determinanti *-n*, i gjeneruar jashë sistemit komplementus, në pozicionin kokë të sintagmës determinante DP, realizon tërheqjen e kokës relative në këtë pozicion si rezultat i një tipari të fortë

morfologjik, sipas të cilët determinanti i pasnjitet kokës relative *Sarandë-n*, siç e kemi parë edhe në rastin e relativeve kufizuese. Në skajin e periferisë së majtë të kësaj fraze, ndodhet sintagma fiksionale e fjalisë kryesore *fiste*, e cila ka si komplement të saj një sintagmë parafallore *për*, si komplement i së cilës shërben sintagma determinante DP.

Hapat e derivimit që paragjenin frazat e analizuara më lart na ndihmojnë të kuptojmë të përbashkëtat dhe dallimet që afrojnë dhe ndajnë frazat relative që kanë si mjet lidhës komplementuesin *që* (9), përemrin lidhor *ise cili/a* (13), apo një ndajfolje lidhore (15). Siç mund të vihet re nga analiza e këtyre frazave, vendi i gjenerimit të komplementuesit *që* përkon gjithnjë me vendin e tij në sintaksën e shfaqur. Kjo do të thotë se ai gjenerohet si kokë e sintagmës ForceP dhe nuk i nënshtronhet asnjë rregule që të mund ta zhvendosë atë brenda frazës.

Pra, ai shfaqet si një bashkim i jashtëm (*External Merge*) në përbërjen e asaj fraze, pjesë e së cilës është. E njëta dukuri vihat re edhe në ato fraza relative ku si mjet lidhës shërben një ndajfolje lidhore. Përkundrazi, përemri lidhor i *cili* është rezultat i një bashkimi të brendshëm (*Internal Merge*) në sintaksën e shfaqur të tij.

Ashtu siç pamë gjatë analizës së frazave relative, ku ky përemër shërben si mjet lidhës, ai gjithnjë i nënshtronhet një rregule *Move*, e cila e zhvendos atë drejt periferisë së majtë të frazës. Kjo ndodh si në rastet e shoqërimit të tij me parafjalë, ashtu dhe në ato ndërtimë ku ai del i vetëm.

Përemri i *cili* gjenerohet dhe zhvendoset në frazë së bashku me kokën relative. Përvèç faktit që ai zhvendoset në frazë, gjë që e bën të dallueshëm nga komplementuesi *që*, as vendi i tij në sintaksën e shfaqur nuk përkon me vendin që zë ky i fundit.

Pra në këtë këndvështrim, struktura e brendshme e relativeve *wh*-, pra e atyre që kanë si mjet lidhës një përemër lidhor, dallon dukshëm nga relativet *that*, pra nga relativet me komplementuesin *që*.

Kështu, arrimë në përfundimin që lloji i mjetit të lidhjes në frazat relative ndikon ndjeshëm në hapat e derivimit të këtyre ndërtimëve që gjindin drejt sintaksës së shfaqur të tyre.

Pavarësisht kësaj, koka relative shfaqet gjithnjë në këto ndërtime si një bashkim i brendshëm, pasi, pavarësisht mjetit të lidhjes, ajo medoemos gjenerohet si komplement i sintagmës foliore të sistemit komplementues dhe më pas ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës për të zënë vendin e saj të caktuar, në varësi të determinantit me të cilin bashkëndan tiparet emërore. Ky i fundit, ashtu si komplementuesi, shfaqet gjithnjë si një bashkim i jashtëm, pasi vendi i gjenerimit të tij përkon me atë të sintaksës së shfaqur.

Determinanti gjenerohet jashtë sistemit komplementues, duke e marrrë këtë të fundit si komplementin e vet. Ai realizon tërheqjen e kokës relative drejt pozicionit të lartë të tij në frazë, por pa iu nënshtruar asnjë lloj rregullë që mund ta zhvendosë atë.

12.6. Frazat relative të lira

12.6.1. Determinanti dhe kokë relative

Në grupin e gjierë të frazave relative të shqipes bëjnë pjesë edhe relativet e lira, të cilat grupohen me të parat si rezultat i procesit të relativizimit, shprehje e të cilat janë, por dallojnë prej tyre si pasoje e disa karakteristikave të veçanta që paraqesin nga ana strukturore. Si frazat relative normale², ashtu dhe ato të lira përfiohen si rezultat i procesit të relativizimit, pra i modifikimit të një fjalë apo sintagme. Le t'u referohemi ndërtimëve të mëposhtme:

- (16) a. *Merr ç'të duash*
 - b. *Mori ato pak gjëra që gjeti*
 - c. *Nuk dinte (se) ç'kërkonte*
- Në (16), vetëm fraza e parë (16a) është një relative e lirë, ndërsa (16-b-c) nuk janë të tilla.
- Në (16b) paraprijësi i shprehur me sintagmën *ato pak gjëra* shfjellohet më tej nga fjalja relative *që gjeti*.

² Po përdorim këtë term për të gjitha frazat relative që kanë në përbëtjen e tyre paraprijës (*Vajza që takova quhet Ana*), prё t'i dalluar nga relativet pa paraprijës (*Bëj ç'të duash*).

Në (16c) fjalia e varur shërbën si komplement i kokës së sintagmës komplementuese, ndërsa e para është e tëra një sintagmë komplementuese CP, e cila gjenerohet poshtë një sintagmë determinante. Po ashtu, elementi pyetës ζ' shfaq tipare të ndryshme për secilën prej frazave ku realizohet.

Në (16c) ai nuk mund të shpërbëhet në dy elemente të ndryshme sic mund të ndodhë në (16a), ku elementi pyetës ζ' është i interpretueshëm në një kokë relative dhe një komplementues si më poshtë:

(17) Merr *atë që (ζ')* të duash

Në këtë frazë, koka relative e shprehur me përemrin *atë* e realizon lidhjen me pjesën tjeter të fjalisë relative me anë të komplementuesit ζ' , pra kemi të bëjmë me një frazë të mirëfilltë relative që e ka të shprehur paraprjësim.

Ashtr si në relativet normale, edhe në ato të lira, koka relative gjenerohet brenda fjalisë relative ku i shënohet dhe roli tematik nga folja e kësaj fjalie.

Në sintaksën e shfaqur të fjalisë (16a), koka relative ζ' ndodhet në një pozicion joargumentor, që është rezultat i veprimit të rregullës *Move dua*, e cila e merr si komplement të saj.

Si rezultat i procesit të relativizimit, koka relative ζ' ngrihet drejt periferisë së majtë të frazës.

12.6.2. Koka relative XP apo X⁰

Në frazat relativat normale, pamë që koka relative i përket kategorisë XP dhe se pozicioni i saj në skemë është ai i specifikuesit. Duke qenë se në fjalinë relative të lirë përemrat pyetës e humbasin tiparin pyetës Wh- (pra nuk shërbejnë për ndërtimin e një fjalie pyetëse) dhe, duke parë rolin e tyre brenda kësaj fjalie, ata mund të interpretohen vetëm si kategori X⁰, pra si koka sintagnash.

Ky interpretim mund të shihet i lidhur ngushtë me statusin e kokës së relativave të lira na ndihmognë të kuptojmë që në thelb ato kanë tipare të përbashkëta të rendësishme me frazat relative normale. Por, nga ana

Në të mirë të kësaj teze mund të sillët edhe një argument tjeter po aq i rendësishëm, i cili e sheh lidhjen e këtij përemri me fjalë të tjera që e shoqërojnë atë si më poshtë:

- (18) a. *Gfarë libri bleve?*
- b. *Kë vajzë takove?*
- c. *Cilën këngë këndove?*
- d. *Ç' e mirë të solli?*

Fjalitë e mësپerme janë pyetëse dhe vërem si të tilla mund të interpretohen, falë pranisë së përemrave pyetës: *gfarë, kë, cilën dhe ζ' .* Vëmë re që secili prej tyre është i shoqëruar nga një fjalë apo sintagnë, gjë që dëshmon sërisht përkatesinë e këtij elementi në kategorinë XP.

Përkundrazi, kur ato janë pjesë përbërëse të frazave relative dhe konkretishët kokë e saj, nuk mund të shoqërohen nga fjalë të tjera, sepse kjo do të çonte në shndërrimin e tyre në fraza relative normale, pra me paraprjësi si në ndërtimet e miëposhtme:

- (19) a. *Merr ζ ' ti duash*
- b. *Merr ζ ' libër ti duash*

Fraza (19a) është një frazë relative e lirë. Në (19b) kemi të bëjmë me një frazë relative normale, pasi elementit ζ' i është shtuar një fjalë e cila ndikon në ndryshimin e statusut të këtij elementi, duke e shndërruar nga një kategori X⁰ (ζ') në kategorinë XP (ζ ' libër).

Në këto kushte mund të pohojmë që relativet e lira dallohen nga llojet e tjera të relativave jo vëtëm për sa i përket vendit të gjenerimit të determinantit, por edhe llojtit të kategorisë së kokës relative.

Nësë tek relativet normale ajo i përket kategorisë XP, koka e relativave të lira është një kategori X⁰.

12.7. Analizë e frazave relative të lira

tjetër, hapat e derivimit që çojnë në përfitim e tyre shfaqin ndryshime po aq të rëndësishme. Për të parë konkretnisht qfarë i karakterizon frazat relative të lira, po ndalojmë në analizën e disa ndërtimave të caktuara që janë shprehje e këtyre veçorive.

12.7.1. Ndërtime pa parafjalë


Koka e relativeve të lira mund të jetë e shoqëruar ose jo me parafjalë. Kjo e fundit zë një vend jo të papërfillshëm në marrëdhëniet që ndërtun me pjesët e tjera të frazës, prandaj prania ose jo e saj në krye të relativave meriton një vëmendje të veçantë.

Le t'i referohemi frazës së mëposhtme:


(20) *Kush punon fiton*

Ndërtimi i mësipërm është një frazë relative e lirë, e cila ka si kokë relative përemrin pyetës *kush*, që ndodhet në një pozicion joargumentor, pasi është zhvendosur nga pozicioni i tij filletar drejt një pozicioni tjetër në frazë. Ai lind në një pozicion që është ai i specifikuesit të sintagmës foljore, e cila ka si kokë të saj foljen e fjalisë kryesore.

Si pasojë e procesit të relativizimit, koka lë pozicionin e saj filletar për t'u ngritur në një pozicion më të lartë, që është ai i pozicionit kokë të sintagmës determinante.



Kjo është një frazë relative e lirë, ku si kokë e fjalisë relative shërben elementi ζ' . Ashtu si në relativet normale edhe në ato të lira, koka relative gjendet në një pozicion joargumentor si rezultat i zhvendosjes së saj në frazë. Struktura e kësaj fraze paraqitet në skemën që vijon:



Siq vihet re në këtë skemë, koka relative lind si komplement i sintagmës foljore në periferinë e ditarhtë të frazës *fajë* veprimit të rregullës *Merge*, e cila realizon bashkimin e foljes *them* dhe të përemrit ζ' . Si rezultat i procesit të relativizimit, mbi kokën relative ζ' , vepron regulla *Move*, e cila e zhvendos atë drejt periferisë së majtë të frazës, në pozicionin kokë D° të sintagmës determinante DP.

Folja *them*, gjithashtu, ngrihet në pozicionin kokë të sintagmës flaksionale ku i shënohet dhe flaksioni. Folja *bëj*, e cila shërben si kokë e sintagmës flaksionale IP₂, merr si komplement të saj të gjithë sistemin komplementues ForceP.

12.7.2. Ndërtime me parafjalë

Siq u tha më lart, koka relative shpeshherë mund të dalë e shoqëruar nga një parafjalë si në frazën e sjellë më poshtë:

(22) *Bëj ç'të kanë thënë*


(24) Eja *me* kë të duash

Këtu kemi të bëjmë me një frazë relative të lirë, e cila ka si kokë të fjalisë relative përemrin *kë*. Ajo çfarë paraqet interes të veçantë në këtë ndërtim, është prania e parafjalës *me*, e cila ndjek fjalinë kryesore dhe paraprin fjalinë e varur të kësaj fraze.

Është bërë e qartë tashmë që pozicioni i gjenerimit të kokës relative nuk përkon me atë të sintaksës së shfaqur. Ajo lind si komplement i foljes së fjalisë relative dhe më pas zhvendoset në një pozicion më të lartë në frazë.

Problemi që ngrihet këtu është i lidhur me vendin e gjenerimit të parafjalës *me*. A përkon Ky me vendin që zë kjo parafjalë në sintaksën e shfaqur?

Për të parë zbhëthimin e strukturës së kësaj fraze, le t'i referohemi skemës së mëposhtme:



Nga kjo skemë kuptojmë që pozicioni filletar i kokës relative *kë* përkon me pozicionin e komplementit të foljes *do*, pra asaj i shënohet roli tematik nga kjo folje.

Si rrijedhim i procesit të relativizimit, ajo lë pozicionin e saj filletar për t'u ngritur drejt periferisë së majtë të frazës, pikërisht në

(26) pozicionin kokë D° të sintagmës determinante DP.

Siq mund të vihat re në skemë, parafjala *me*, që në sintaksën e shfaqur paraprin fjalinë relative, nuk ka kryer asnjë zhvendosje brenda kësaj fraze, pra vendi i gjenerimit të saj si komplement i foljes së fjalisë kryesore *eja*, përkon me vendin e saj në sintaksën e shfaqur.

Pra, parafjala në ndërtim të tillë nuk i përket fjalisë relative, ajo nuk gjenerohet brenda kësaj fjalie, por e merr atë si komplement të saj. Duke iu referuar ndërtimeve me parafjalë, Kayne-i (2005) pohon që mbi parafjalën nuk vepron rregulla *Merge*, që realizon bashkimin e komplementit të saj me vetë parafjalën. Madje, parafjala gjenerohet jashtë sintagmës foliore, në rastin tonë *të duash kë*, duke shërbyer si kokë e saj.

Pra, edhe pse në sintaksën e shfaqur disa lloje ndërtimesh mund të shfaqin ngjashmëri të dukshme (si ato në 16), mënyra e derivimit të tyre është e ndryshme.

Nëse në frazën e mësipërmë pamë që parafjala, falë zbatimit të rregullës *Merge*, bashkohet me foljen e fjalisë kryesore dhe merr fjalinë relative si komplement të saj, në frazat ftiluese ajo e ndryshon vendin e gjenerimit të saj.

Nga analiza e frazave relative të lira të shqipes arrijmë në përfundimin që, nëse llojet e relativeve normale kanë të njëjtin strukturë dhe njohin të njëjtë hapa derivimi, relativet e lira shfaqin një dallim jo të vogel në lidhje me të parat, edhe pse në thelb mbetet po e njëjta strukturë: një sintagnë determinante që merr si komplement të saj fjalinë relative.

Dallimi i vetëm qëndron në hapat e derivimit të këtyre frazave. Nëse tek frazat relative normale determinanti lind si kokë e sintagmës determinante, pra vendi i gjenerimit të tij përkon me atë të sintaksës së shfaqur, tek relativet e lira ai ngrihet në këtë pozicion falë veprimit të rregullës *Move*, pra vendi i gjenerimit të tij nuk përkon me atë të sintaksës së shfaqur.

Po të përdorim të njëjtën terminologji të Chomsky-t lidhur me determinantin tek frazat relative, do të shpreheshim se tek relativet normale kemi të bëjmë me një bashkim të jashtëm (*External Merge*), ndërkohë që tek frazat relative të lira kemi të bëjmë me një bashkim të

(27) Sipas qëndrimit të këtij përfundimit, këtë frazë nuk mund të

paraprin fjalinë relative, nuk ka kryer zhvendosje brenda kësaj fraze, pra vendi i gjenerimit të saj si komplement i foljes së fjalisë kryesore *eja*, përkon me vendin e saj në sintaksën e shfaqur.

Pra, parafjala në ndërtim të tillë nuk i përket fjalisë relative, ajo nuk gjenerohet brenda kësaj fjalie, por e merr atë si komplement të saj.

Duke iu referuar ndërtimeve me parafjalë, Kayne-i (2005) pohon që mbi parafjalën nuk vepron rregulla *Merge*, që realizon bashkimin e komplementit të saj me vetë parafjalën. Madje, parafjala gjenerohet jashtë sintagmës foliore, në rastin tonë *të duash kë*, duke shërbyer si kokë e saj.

Pra, edhe pse në sintaksën e shfaqur disa lloje ndërtimesh mund të shfaqin ngjashmëri të dukshme (si ato në 16), mënyra e derivimit të tyre është e ndryshme.

Nëse në frazën e mësipërmë pamë që parafjala, falë zbatimit të rregullës *Merge*, bashkohet me foljen e fjalisë kryesore dhe merr fjalinë relative si komplement të saj, në frazat ftiluese ajo e ndryshon vendin e gjenerimit të saj.

Nga analiza e frazave relative të lira të shqipes arrijmë në përfundimin që, nëse llojet e relativeve normale kanë të njëjtin strukturë dhe njohin të njëjtë hapa derivimi, relativet e lira shfaqin një dallim jo të vogel në lidhje me të parat, edhe pse në thelb mbetet po e njëjta strukturë: një sintagnë determinante që merr si komplement të saj fjalinë relative.

Dallimi i vetëm qëndron në hapat e derivimit të këtyre frazave. Nëse tek frazat relative normale determinanti lind si kokë e sintagmës determinante, pra vendi i gjenerimit të tij përkon me atë të sintaksës së shfaqur, tek relativet e lira ai ngrihet në këtë pozicion falë veprimit të rregullës *Move*, pra vendi i gjenerimit të tij nuk përkon me atë të sintaksës së shfaqur.

Po të përdorim të njëjtën terminologji të Chomsky-t lidhur me determinantin tek frazat relative, do të shpreheshim se tek relativet normale kemi të bëjmë me një bashkim të jashtëm (*External Merge*), ndërkohë që tek frazat relative të lira kemi të bëjmë me një bashkim të

(28) Sipas qëndrimit të këtij përfundimit, këtë frazë nuk mund të

paraprin fjalinë relative, nuk ka kryer zhvendosje brenda kësaj fraze, pra vendi i gjenerimit të saj si komplement i foljes së fjalisë kryesore *eja*, përkon me vendin e saj në sintaksën e shfaqur.

Pra, parafjala në ndërtim të tillë nuk i përket fjalisë relative, ajo nuk gjenerohet brenda kësaj fjalie, por e merr atë si komplement të saj.

Duke iu referuar ndërtimeve me parafjalë, Kayne-i (2005) pohon që mbi parafjalën nuk vepron rregulla *Merge*, që realizon bashkimin e komplementit të saj me vetë parafjalën. Madje, parafjala gjenerohet jashtë sintagmës foliore, në rastin tonë *të duash kë*, duke shërbyer si kokë e saj.

Pra, edhe pse në sintaksën e shfaqur disa lloje ndërtimesh mund të shfaqin ngjashmëri të dukshme (si ato në 16), mënyra e derivimit të tyre është e ndryshme.

Nëse në frazën e mësipërmë pamë që parafjala, falë zbatimit të rregullës *Merge*, bashkohet me foljen e fjalisë kryesore dhe merr fjalinë relative si komplement të saj, në frazat ftiluese ajo e ndryshon vendin e gjenerimit të saj.

Nga analiza e frazave relative të lira të shqipes arrijmë në përfundimin që, nëse llojet e relativeve normale kanë të njëjtin strukturë dhe njohin të njëjtë hapa derivimi, relativet e lira shfaqin një dallim jo të vogel në lidhje me të parat, edhe pse në thelb mbetet po e njëjta strukturë: një sintagnë determinante që merr si komplement të saj fjalinë relative.

Dallimi i vetëm qëndron në hapat e derivimit të këtyre frazave. Nëse tek frazat relative normale determinanti lind si kokë e sintagmës determinante, pra vendi i gjenerimit të tij përkon me atë të sintaksës së shfaqur, tek relativet e lira ai ngrihet në këtë pozicion falë veprimit të rregullës *Move*, pra vendi i gjenerimit të tij nuk përkon me atë të sintaksës së shfaqur.

Po të përdorim të njëjtën terminologji të Chomsky-t lidhur me determinantin tek frazat relative, do të shpreheshim se tek relativet normale kemi të bëjmë me një bashkim të jashtëm (*External Merge*), ndërkohë që tek frazat relative të lira kemi të bëjmë me një bashkim të

brendshëm (*Internal Merge*), që realizohet pas veprimit të irregullës *Move*, e cila e zhvendos determinantin drejt periferisë së majtë të frazës. Ky fakt përbën dallimin më të rëndëssishëm që ndan frazat relative të lira nga ato normale.

13


STRUKTURA SINTAKSORE E SINTAGMAVE DHE FRAZAVE ME BASHKËRENĐITJE

13.0. Nënrenditje përkundër bashkërenđitje

Në kërët e mëparshëm kemi analizuar disa lloje frazash me nënrenditje (me fjalë me folje në mënyrën lidhore, kushiorët, relativet), pra struktura që varen nga një fjalë kryesore, si për shembull në (1):

- (1) a. *Beni tha se Agimi kishte takuar Besën*
b. *Ata primtin që ai të thoshte një fjalë*
c. *Dëgjoja fjalë që nuk më pëlqyen*
d. *Nuk dihet nëse Besa do të vijë apo jo*

Fjalët e nënarenditura në (1) lidhen me ato kryesore nëpërmjet komplementuesve (*se, që, nëse*) roli i të cilëve është pikërisht të lidhin së bashku këto pjesë fjalish. Në paraqitjen sintaksore, fjalia e nënrenditur (e projektuar si ForceP) realizohet si komplement i kokës V° i fjalisë kryessore, siç mund të vihat re në (2):



Ndryshe nga fjalitë e nënrenditura, që hyjnë në një lidhje varësie me kryesoret, fjalitë bashkërenditëse lidhen mes tyre në mënyrë të tillë që secila të ruajë pavarësinë e vet, pra të mos ketë marrëdhënie varësie mes tyre.

Bashkërenditura, veg së tjerash¹, realizohet nëpërmjet lidhëzave bashkërenditëse: shtruese (*e, dhe, edhe, ej.*); *Bëne ftohië dhe binte vazhdimisht shi; veçuese (ose, apo, a, etj.)*; *Po thërrasin apo më bëjmë veshët mua; kundërshtuese (po, por, kurse ndërsa, etj.)*; *Bëri të fliste, por u step në çast; përmbyllëse (ndaj, prandaj, pa, etj.)*; *Duhet shumë punë, pa të të besojnë*.

13.1. Bashkërenditura e sintagmave

Ndryshe nga nënrenditura që vë në raporte varësie dy a më shumë fjalë, bashkërenditura mund të bashkojë të gjitha llojet e sintagmave (NP, DP, AP, PP, VP, IP, CP), siç na dëshmojnë shembujt e mëposhtëm:

- [NP djem] dhe [NP vajza]
- [DP ata djem] edhe [DP ato vajza]

Në këtë skemë, dy sintagmat që bashkërenditen do të zënë përkatësisht pozicionin e Specifikuesit dhe atë të Komplementit në këtë projektim, dhe pikërisht pse i përkasin të njëjtë lloj sintagme do të paraqiten me të njëjtën etiketë XP, që mund të zëvendësohet me

¹ Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Krujë XXIV, Tiranë 1997.

- Aj është [AP i bukur] dhe [AP i zgjuar]
 - Çelësat janë [PP mbi bankë] ose [PP në çantë]
 - Beni ka [vp ngjënë drekë] dhe [vp ka shikuar televizorin]
 - [IP Beni lexon librin] kurse [IP Artani dëgjon muzikë]
 - Nuk di [CP kusht i ka blerë librat] dhe [CP Kush i ka lexuar]
- Po ashtu, bashkërenditura mund të vërtë së bashku më shumë se dy sintagma:
- (4) *babi, nami, motra dhe vëllai*


Sidoqoftë, edhe bashkërenditura ka kufizimet e veta. Kështu mund të bashkërenditen vetëm sintagma që i përkasin të njëjtë lloj, por jo kur ato u përkasin illojeve të ndryshme si në (5):

- (5) a. * [NP djem] dhe [DP ato vajza]
- b. * [Beni [vp bëri dashin] dhe [AP i bukur]]


Siq mund të vijet re nga shembujt e mësipërm, lidhëza është një element thelbësor për bashkimin e sintagmave, lidhja e të cilave formon një përibërës të vetëm.

13.2. Struktura e sintagmave të bashkërenditura


Për paraqitjen sintaksore të sintagmave të bashkërenditura, do t'i referohemi skemës X'. Së pari, le të themi se pozicionin kokë Coord të kësaj sintagme e zë lidhëza bashkërenditëse. Koka Coord projekton sintagmën bashkërenditëse CoordP (*Coordination Phrase*):




secilën prej sintagmave në (3). Kështu, struktura e paraqitur në (7), p.sh. i përkon frazës (3a), ku bashkërenditen dy sintagma emërore NP:



Në ato raste kur kemi bashkërenditjen e më shumë se dy sintagmave, pozicioni i komplementit të kokës Coord° që ndodhet më në të majtë të periferisë së frazës, do të zihet nga një sintagnë tjeter CoordP:




Shembulli në (3b) ku gjiejmë të bashkërenditura dy sintagna determinante DP, do të ketë këtë strukturë:




Për paraqitjen e një strukture ku bashkërenditen dy sintagma parafjalore apo mbiemërore, do të kishim të njëjtën skenë si në (9), me ndryshimin e etiketës DP përkatësisht në PP e AP. Deri këtu


paraqitëm strukturën e sintagmave duke i analizuar ato të izoluara, më vete, por për të parë lidhjen dhe vendin e tyre në report me përbërtës të tjerë në frazë, tanj e tutje do t'i analizojmë ato në një Kontekst më të gjërë. Le t'i referohemi bashkërenditjes së dy mbiemrave, si në shembullin (3c), paraqitja e të cilëve jepet në (10):




Struktura në (3d), ku jepet bashkërenditja e dy sintagmave parafjalore, është e njëjtë me atë në (10), me dallimin e vetëm që në projektimin CoordP, pozicioni i specifikuesit dhe ai i komplementit tashmë janë zënë nga sintagnat parafjalore PP, në vend të atyre mbiemrëve AP. Bashkërenditja e dy sintagmave foliore VP mund të jepet si në (11).



Bashkërendita e dy frazave si ajo në (3f) do të ketë strukturen e mëposhtme:




Siq mund të vërehet nga struktura e paraqitur në skemën (12), në thelb kemi të bëjmë me një sintagmë koka e së cilës Coord° mban lidhëzën që bashkon fjalitë, ndërkohë që këto të fundit paraqiten si sintagma fleksionale IP, njëra në pozicionin e specifikuesit dhe tjetra në atë të komplementit të kësaj sintagme. Bashkërendita mes dy a më shumë sintagnave komplementuese CP, realizohet në të njëjtën mënyrë:



Siq e kemi parë, sintagmat bashkërenditëse mund të zënjë pozicione të ndryshme në brendësi të frazës. Në ato raste kur këto dy sintagma kanë funksion kryefjalor, si në frazën e mëposhtme:


(14) *Beni dhe Besa shikojnë televizorin*

sintagma CoordP ndodhet në pozicionin e kundririt e posicjonin e fleksionale SpecIP:



Kur bashkërenditen dy përbërës që kryejnë funksionin e kundririt të drejtë, atëherë sintagma CoordP ndodhet në pozicionin e komplementit të kokës V°. Pra, struktura e një fraze si ajo në (15) do të ketë paraqitjen e mëposhtme:

(16) *Beni lexoi librin dhe gazeten*



Le t'i rikthehem frazës me fjalitë bashkërenditura, struktura e së cilës është paraqitur në skemën e mësipërme (12):

- (18) Beni lexon librin, kurse Artani dëgjon muzikë

Këtu kemi të bëjmë me fjal që bashkërenditen dhe hyjnë në marrëdhëniet kundërshtore me njëra-tjetrën. Nëse do të ndryshonim marrëdhënien që vendoset mes fjalive të kësaj fraze, nga kundershtuese në shtuese, veçuese apo përmbyllëse², kjo nuk do të ndikonte në strukturën e frazës.

Duke shkuar më tej, në marrëdhënien që vendoset mes fjalive, siç u përmend më sipër, mund ta ndryshojmë lidhjen ndërmjet tyre nga lidhje me bashkërenditje në lidhje me nëmrenditje (kohore, shkakore, rrijedhimore, lejore³ etj.)

(19) Beni lexon librin *sa herë që / sepse / prandaj / ndonëse* Artani dëgjon muzikë.

Pavarësisht nga lidhjet (bashkërenditje apo nënrenditje) dhe nga marrëdhëniet (shtuese, kundërshtuese, kohore apo shkakore etj.) që vendosen mes këtyre fjalive, mund të themi që frazat (18) dhe (19), paraqesin të njëjtat tipare strukturore.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Abney, S. (1987), *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*, Ph. D. Thesis, MIT.
- Altinari, F. (2010), *Selman Riza dhe çështja e paskajoresh*, Identiteti gjuhësore dhe kulturore, Studime Shqiptare 15, Shkodër.
- Belluscio, G.-Rokaj, Sh (2011), *Fjalor krahues i termave të gjuhësisë*, Tiranë: Arbëria.
- Bianchi, V. (1999), *Consequences of Antisymmetry: Headed Relative Clauses*, Mouton de Gruyter, Berlin.
- Bloomfield, L. (1933), *Language*, New York: Henry Holt.
- Buxheli, L. (2005), *Rreh caktimit të rasës emirotore në shqipen e sotme*, Studime Filologjike 1: 65-91
- Buxheli, L. (2008), *Caktimi rasor në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Borer, H. (1981), *Parametric variation in clitic constructions*, MIT Press, Cambridge, MA.
- Chomsky, N. (1957), *Syntactic Structures*, Mouton, The Hague.
- Chomsky, N. (1980), *On Binding*, Linguistic Inquiry 11: 1-46.
- Chomsky, N. (1981), *Lectures on Government and Binding*, Foris, Dordrecht.
- Chomsky, N. (1986), *Knowledge of Language*, Praeger, New York.
- Chomsky, N. (1993), *A minimalist program for linguistic theory*, në K.J. Hale and S.J. Keyser (eds.), *The View from Building 20*, MIT Press, Cambridge, MA.
- Chomsky, N. (1995), *The Minimalist Program*, MIT Press, Cambridge, MA.
- Chomsky, N. (1999), *Derivation by Phase*, MIT Occasional Paper 18, MIT Press, Cambridge, MA.
- Cook, V.J. (1991), "The poverty-of-the-stimulus argument and multi-competence", Second Language Research 7/2: 103-117.
- Cook, V.J.- M. Nweson. (1996), *Chomsky's Universal Grammar: An Introduction*, Blackwell, Oxford.

² Për më tepër shih: Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë 1997.

³ Po aty.

- Cinque, G. (2001), *Restructuring and the order of aspectual and root modal heads*, në G. Cinque and G. Salvi (eds) Current Studies in Italian Syntax, Amsterdam: North Holland, fq. 137-155.
- Cinque, G. (2002), *Functional Structure in DP and IP: The Cartography of Syntactic Structures*, Volume 1, Oxford: Oxford University Press.
- Cipo, K. (1952), Sintaksa, Tiranë
- Çeliku, M. (1999), *Statusi sintakso i formave të pastrijelluara dhe i ndërtimeve të formuara me to*, Studime Filologjike 3/4, Tiranë.
- Çeliku, M. (2006), *Format e pastrijelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Dhima, Th. (2005), *Gjuha shqipe. Sintaksa*, Tiranë. SHBLU.
- Domi, M. (1970), *Mbi një tip strukturor të fjalive të varurra dhe mbi disa përgjithësimë të lidhura me të*, Studime Filologjike 4, Tiranë.
- Domi, M. (1964), *Gramatika e gjuhës shqipe, rjesa e dytë*, Sintaksa, Tiranë.
- Donati, C. (2002), *Sintassi elementare*, Roma: Carocci.
- Ermonds, J.E. (1976), *A Transformational Approach to English Syntax*, Academic Press, New York.
- Ernst, T. (2001), *The Syntax of Adjunct*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Floqi, S. (1967), *Disa tipe semantiko-strukture të periudhës me fjalë të varur me lidhje korrelative*, Studime Filologjike 3, Tiranë.
- Graffi, G. (1994), Sintassi, Bologna: il Mulino.
- Graffi, G. (2008), *Che cos'è la grammatica generativa*, Roma: Carocci.
- Greenberg, J.H. (1966), *Some universals of grammar with particular reference to the order of meaningful elements*, në J.H Greenberg (ed.) *Universals of Language*, MIT Press, Cambridge, MA.
- Giusti, G. (1997). *The categorial status of determiners. The New comparative Syntax*. Haegeman, L. (ed.), 95-124. Longman, London.
- Giusti, G. (2002). *The functional structure of noun phrases: A bare phrase structure approach*. Functional Structure in DP and IP: The Cartography of Syntactic Structures, Vol. 1, G. Cinque (Ed.), 54–90. Oxford: OUP.
- Guasti, M.T. (2002), *Language Acquisition : The Growth of Grammar*. Cambridge, MA : MIT Press.
- Haegeman, L. (1994), *Introduction to Government & Binding Theory*, Oxford : Blackwell, second edition.
- Halle, M - Maranz, A. (1994), *Some key features of distributed morphology*, A. Carnie, H. Harley, T. Bures, (eds) *Papers on Phonology and Morphology*, MIT Working Papers in Linguistics, 21 fq. 275-288.

Harbert, W. (1995), *Binding Theory, control and 'pro'*, Webelhuth (1995b) 177-240.

Hornstein, N. (2001), *Move! A minimalist theory of Construal*, Oxford: Blackwell.

Jaeggli, O. (1982), *Topics in Romance syntax*, Foris, Dordrecht.

Kayne, R.S. (1975), *French Syntax*, MIT Press, Cambridge, MA.

Kayne, R.S. (1994), *The Antisymmetry of Syntax*, MIT Press, Cambridge, MA.

Kayne, R.S. (2000), *Parameters and Universals*, Oxford: Oxford University Press.

Koleci, F. (2010), *Çështja e paskajores dhe e naërtimëve të tjera fjalore të pastrijelluara*, Identitetë gjuhësore dhe kulturore, Studime Shqiptare 15, Shkodër.

Koleci, F. (2010), *Analisi delle frasi relative appositive della lingua albanese*, Quaderni del Dipartimento di Linguistica, 20, Università degli Studi di Firenze, Unipress.

Koleci, F. (2010), *Frazat relative të lira të shqipes*, Scritti in onore di Eric P. Hamp, Università della Calabria, Centro Editoriale e Librario.

Larson, R. (1988), *On the double object constructions*, Linguistic Inquiry 19/3: 335-391.

Lasnik, H. (1992), *Case and expletives: Notes toward a parametric account*, Linguistic Inquiry 23, 381-405.

Lasnik, H. (1995e), *Case and expletives revisited*, Linguistic Inquiry 26, 615-633.

Lasnik, H. (1999), *Minimalist analysis*, Oxford: Blackwell.

Longobardi, G. (1992), *Proper Names and the Theory of N-movement in Syntax and Logical Form*, dorëshkrim, Universiteti i Venecias.

Manzini, M.R.-Savoia L.M. (2008), *Morfosintassi*, Alessandria: Edizioni dell'Orso.

Manzini, M. R-Savoia L.M. (2007), *A unification of morphology and syntax*, Routledge, Canada.

Manzini, M.R – A. Roussou. (2000), *A minimalist approach to A-movement and control*, Lingua 110, 409-447

Maranz, A. (1984), *On the nature og grammatical relations*, Cambridge, MA: MIT Press.

Mernushaj, R. (2004), *Hyjje në gjuhësi*, Tiranë: Dituria.

Mernushaj, R. (2008), *Gjukësia Gjenerative*, Tiranë: Shblu.

Moro, A. (1997), *The Raising of Predicates: Predicative Noun Phrases and the Theory of Clause Structure*, Cambridge University Press, Cambridge

- Nunes, J. (1995), *Bare X'-Theory and structures formed by movement*, Linguistic Inquiry 29, 160-168.
- Pěrnáška, R. (1984), *Českje tē baskképershtajes ndërmjet trajtës së shkurtër të përemrit veror dhékundrines*, SF/4.
- Pollock, J. - Y. (1989), *Verb movement, UG and the structure of IP*, Linguistic Inquiry 18: 85-111.
- Prifti, S. (1972), *Klasiifikimi i fjalive të varura*, Studime Filologjike 2, Tiranë.
- Radford, A. (1997), *Syntax: a Minimalist Introduction*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Rrokaj, Sh. - Turano, G. *A proposito del sintagma nominale albanese. Il caso di un dimostrativo seguito da un DP definito*. Lingua e Stile Anno XXXV, nr. 1.
- Rrokaj, Sh. - Turano, G. (1998), *Strategia del Causativo in Albanese*, Studii Italiani di Linguistica Teorica e Applicata, 3, fq. 551-565.
- Rota, J. (1942), *Sintaksa e gjithës shqipë*, Shkodër.
- Rivas, A.M. (1977), *A theory of clitics*, MIT Press, Cambridge, MA.
- Rizzi, L. (1991), *Residual Verb Second and the Wh-Criterion, Technical Reports in Formal and Computational Linguistics* 2, Université de Genève.
- Rizzi, L. (1995), *The Fine Structure of the Left Periphery*, dorëshkrim, Université de Genève.
- Skinner, B.F. (1957), *Verbal Behaviour*, Appleton Century Crofts, New York.
- Riza, S. (2009), *Vepra V*, Prishtinë.
- Savoia, L.M - Manzini, M.R. (2003), *Pjesoria dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës*, Studime Filologjike, 3-4, fq. 93-138.
- Sportiche, D. (1992), *Clinic constructions*, dorëshkrim, UCLA.
- Tesnière, L. (1959), *Éléments de syntaxe structurale*, Paris, Klincksieck.
- Totoni, M. (2000), *Fraza me nënrenditje*, SHBLU, Tiranë.
- Turano, G. (1995), *Dipendenze sintattiche in albanese*, Padova: Unipress.
- Turano, G. (1999), *Il costrutto pa+participio nella varietà Arbëreshe di S. Nicola dell'Alto* (KR), në M. Mandala (ed). Studii in onore di L. Marlekaj, Bari: Adriatica, fq. 564-578.
- Turano, G. (2001), *Albanian noun phrase domain*, Quaderni del Dipartimento di Linguistica, Serie Albanistica 3, Università della Calabria.
- Turano, G. (2002), *On Modifiers preceded by the article in Albanian DPs*. University of Venice Working Papers in Linguistics, 12 fq. 169-215.